Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (97). MAJ 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

BLOGER

- **Ç'kemi asaj Dibre!**
- **Familja, toka, atdheu!**
- **Ditari i një vajze: "Mëjr"**

FAQE 17

VENDIMI

Ndryshon ligji, pritet zgjidhja e Bulqizës

FAQE 7

ARSIM

Festohet përvjetori i shkollës shqipe në Trebisht, Homesh

FAQE 9,10,11

BOTIME

Kurora e dytë e Lurës

Nga **RAMIZ LUSHAJ** - FAQE 18-19

Pa **Rrugën e Arbërit** Dibra mbetet e izoluar

Nga Tryeza e Rrumbullakët e zhvilluar në librarinë Tirana Times me 7 Maj në Tiranë. Foto: Afrim Karoshi

Nga data 5 maj deri me 9 maj, nga Peshkopia në Tiranë e Vlorë, u zhvilluan një serë veprimtarishë me synim promovimin e çështjes së Rrugës së Arbërit. Këto takime publike e mediatike patën si qëllim sensibilizimin edhe një herë të shoqërisë shqiptare për nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërtimit në një kohë sa më të shpejt dhe me standarde europiane të Rrugës së Arbërit.

Dibra, pavarësisht pozicionit të saj gjeografik, larg metropolit dhe e ndarë në dysh, ka akoma energji që premtojnë për të ardhmen.

Peticioni, i cili deri tani është nënshkruar nga afro 7000 njerëz online dhe në letër, nuk duhet shikuar si një nismë një-vjeçare, por si një etapë e re në përpjekjet e intelektualëve dibranë, të cilët për afro 20 vjet, po theksojnë se ndërtimi i Rrugës së Arbërit do të mundësojë fillimin e rimëkëmbjes ekonomike të Dibrës. Pavarësisht dorëzimit zyrtar të peticionit, këmbëngulja e intelektualëve do të jetë deri në ndërtimin e metrit të fundit të rrugës, me cilësi dhe me standarde.

(Lexoni në faqet 2-3)

Interviste me shkrimtarin Agron Tufa

Dibra më bëri ta njoh shumë shpejt ligësinë njerëzore, vogëlsinë dhe fanatizmin absurd

Tematika e realet e Dibrës në veprën time janë të pafundme; shpesh ato nuk bien trashë në sy, po gjithë bota dibrane është e kamufluar pas matricës letrare. Dhe natyrisht, bota e një njeriu formësohet aty ku ai ka mbërritur adoleshencën. Unë jam rritur e kam kaluar moshën mbi njëzet vjeç në Dibër. E prapë, vetë tingëllimi i fjalës "Dibër" gjithmonë më emocionon. Por e kam për vete dhe s'duroj dot ta lavdërojnë njerëzit banalë, as ta shajnë s'duroj dot.

Dibra është realisht një zonë provinciale, pavarësisht potencialit të saj të rrallë bujqësor, blegtoral e frutikultural, sikundërse është edhe një zonë e pasur me minerale nga kromi deri tek gjipsi, pa folur për resurset turistike. Por këto margaritarë të Dibrës janë rraposur në baltë, pa Rrugën e Arbrit, e cila rrugë do të thotë Treg, Dinamizëm teknologjik, Turizëm, Kulturë, Zhvillim, rrjedhimisht - Mirëqenie. Atëherë do ta shohim nëse është apo jo Dibra zonë provinciale. Provincialiteti ekziston vetëm se në mendje, jo në hapësirat potenciale të Dibrës.

Sa ka ndikuar Dibra në krijimtarinë e tij letrare? Kur mendoi se do të bëhej shkrimtar dhe kur e shkroi poezinë e parë? Cilat janë pasojat e diktaturës? Dibra është provincë apo qendra e Shqipërisë? A duhet të jemi krenarë që jemi dibranë? Çfarë është Universiteti i Dibrës? Çdo të thotë Rruga e Arbërit për Dibrën? Këto dhe shumë pyetje të tjera në një intervistë me gazetaren Sashenka Ndreka, ekskluzivisht për gazetën "Rruga e Arbërit" dhe faqen sociale në FB "Peshkopi,Dibër,Albania".

- LEXONI NË FAQET 4-5

cyan magenta yellow black 1

Nga data 5 maj deri me 9 maj, nga Peshkopia në Tiranë e Vlorë, u zhvilluan një serë veprimtarishë me synim promovimin e çështjes së Rrugës së Arbërit. Këto takime publike e mediatike patën si qëllim sensibilizimin edhe një herë të shoqërisë shqiptare për nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërtimit në një kohë sa më të shpejt dhe me standarde europiane të Rrugës së Arbërit.

Pa **Rrugën e Arbërit**
Dibra mbetet e izoluar

Nga data 5 maj deri me 9 maj, nga Peshkopia në Tiranë e Vlorë, u zhvilluan një serë veprimtarishë me synim promovimin e çështjes së Rrugës së Arbërit. Këto takime publike e mediatike patën si qëllim sensibilizimin edhe një herë të shoqërisë shqiptare për nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërtimit në një kohë sa më të shpejt dhe me standarde europiane të Rrugës së Arbërit.

Paneli i takimit të hapur në Peshkopi. Foto: Ramazan Tema

TAKIMI NË PESHKOPI: DIBRA PA RRUGËN E ARBËRIT MBETET E IZOLUAR

Veprimtaria e parë u zhvillua në Qendrën e Edukimit dhe Kulturës në Peshkopi, më 5 maj 2014, ora 11. Në këtë takim, përvec grupit përfaqësues të peticioni onlinë për Rrugën e Arbërit, Gëzim Alpion, Erisa Saraçi dhe Bujar Karoshi, merrnin pjesë edhe përfaqësues të pushtetit lokal të Peshkopisë, Dibrës së Madhe dhe Prefekturës, si dhe drejtues shoqatash dhe organizatash joqeveritare.

Në fjalën e tij, Dr Gëzim Alpion bëri një panoramë të peticionin online të nisur që në mars të vitit të kaluar, si dhe dha disa sqarime lidhur me natyrën jopolitike të peticionit, firmat e mbledhura online dhe në letër si dhe nevojën për domosdoshmërinë e unifikimit dhe mbledhjes së mendimit lidhur me cështjen, me qëllim që shoqëria civile, së bashku, te ndikojë sa të mundet në mënyrë që rruga e arbërit të fillojë sa më shpejt.Alpion theksoi se peticioni përfaqëson një fazë të re në përpjekjet e intelektualëve dibranë për këtë projekt.

Ndërsa znj.Erisa Saraçi foli për përvojën e saj në këtë iniciative dhe rolin që kanë luajtur dhe luajnë rinia dhe gratë në këtë lëvizje qytetare.

Hysen Uka bëri një pasqyrë gati 20-vjeçare të përpjekjeve të shoqërisë civile në këtë drejtim, si dhe ngriti shqetësimin e një koordinimi praktik të shoqërisë civile në këtë proces. Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe z. Ruzhdi Lata e vuri theksin në rëndësinë e ndërtimit të rrugës dhe ndikimin që do të ketë ajo në komunitetin e Dibrës së Madhe. Gjithashtu, ai ritheksoi rolin përcaktues të qeverisë shqiptare në këtë drejtim.

Kryetari i bashkisë së Peshkopisë, z. Ilir Krosi foli për nevojën e bashkimit lidhur me këtë cështje si dhe përpjekjet e bëra vazhdimisht në këtë drejtim për finalizimin e saj. Prefektura përfaqësohej në këtë takim nga znj. Donika Hyseni, Sekretare e Prefekturës.

Diskutantë të ndryshem që morën fjalën e rikthyen debatin në nevojën e një bashkimi pa dallime politike dhe nevojën e lobimit të gjithë sa bashku për ti bindur përfaqësuesit tanë në pushtetin qendror se investimet në rrugën e Arbërit janë thelbësore për tu realizuar, duke bërë të mundur që Dibra të dalë nga izolimi.

Delegacioni i intelektualëve dibranë u prit në një takim edhe nga Prefekti i Qarkut të Dibrës, z. Melaim Damzi, me të cilin u shkëmbyen mendime jo vetëm për atë që është bërë deri më tani, por edhe rolin që duhet të luajnë të zgjedhurit dhe organizatat joqeveritare në një finalizim me sukses të ndertimit të Rrugës së Arbërit

MAQELLARË, TAKIM ME GJIMNAZISTË

Një takim në gjimnazhin e Maqellarës ishte krejt në një atmosferë miqësore.Disa nga nxënësit e kësaj shkolle, në ditën ndërkombëtare të tokës, kishin bërë të mundur që të mblidhnin firmat e më shumë se 600 qytetarëve për peticionin për Rrugën e Arbërit.Mësuesja Zamira Gjeleshi dhe nxënësit e saj të angazhuar i bënë shumë pyetje Gëzim Alpion në lidhje me peticionin, por edhe me cështje të tjera që kanë të bëjnë me shkollën, edukimin, Nënë Terezën, etj.Takimi në shkollën e Maqellarës ishte një gjest simbolik që tregon se Dibra, pavarësisht pozicionit të saj gjeografik, larg metriopolit dhe endarë në dysh, ka akoma energji që premtojnë për të ardhmen.

Me gjimnazistët e Maqellarës

KRYETARI I KUVENDIT: PREMTIMET E BËRA PËR RRUGËT NUK JANË MBAJTUR SIÇ DUHET NË TË SHKUARËN.

Më 6 maj 2014, në orë 11:00, Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, priti në një takim zyrtar grupin lobues për Rrugën e Arbërit: Dr Gëzim Alpion, znj Erisa Saraçi dhe z. Bujar Karoshi. Në takim, pas prezantimit shkurtimisht të ecurisë së projektit të Rrugës së Arbërit nga delegacioni i intelektualëve dibranë, z. Meta i siguroi ata per perkrahjen e tyre te plote si Kryetar i Kuvendit dhe të institucionit që ai përfaqëson. z. Meta përmendi përpjekjet që po bën qeveria për të gjetur fonde dhe sugjeroi se më shumë detaje për anën financiare të projektit mund të mësojnë nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës.

Ndër të tjera Dr Alpion tha: "Ne kemi ardhur të shprehim edhe një shqetësim që ndanë me ne qytetarët e Peshkopisë më 5 maj, shqetësim të cilin e ndajmë edhe ne si intelektualë. Dibranët janë të mendimit se Dibra është lënë pas dore jo vetëm në 23 vitet e fundit po gjatë gjithë historisë 100 vjeçare të shtetit shqiptar. Dibra vazhdon ta vuajë copëtimin e Shqipërisë më 1913 më shumë se çdo zonë tjetër. Gjithashtu kemi vënë re se në takimet me përfaqësues të pushtetit lokal në Peshkopi (Kryetari Bashkisë dhe Prefekti i Qarkut të Dibrës) si dhe nga përfaqësuesit e pushtetit lokal në Dibër të Madhe, që erdhën qëllimisht në Peshkopi për të ndjekur aktivitetin tonë, mesazhi që morëm prej tyre është se për Rrugën e Arbërit dibranët paraqesin një front të bashkuar pavarësisht nga animet politike."

Z. Meta përmendi që është i vetdijshëm që premtimet e bëra për rrugët nuk janë mbajtur siç duhet në të shkuarën. Ai u interesua veçanërisht se sa vetë e kanë nënshkruar peticionin dhe numri mbi 6000 nënshkrime iu duk mbështetje e mirë.

Në takim, z. Karoshi paraqiti historikun e Rrugës së Arbërit dhe shprehu kërkesën që ky

---

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (97). 1 - 31 Maj 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: S.Mëziu, D.Rama, H.Përnezha, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Arkivi i gazetës është pa pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Agron TUFA
Sashenka NDREKA
Rexhep TORTE
Xhafer MARTINI
Bardhyl MARKU
Ramiz LUSHAJ
Hysen LIKDISHA
Dashmir ZAÇE
Ilmi DERVISHI
Agim GJINI
Kadri DAUTI
Bashkim LLESHI
Sali BUSHI
Mevlud BUCI
Destan RAMA
Xhelal ROÇI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

aktualitet

Dibra, pavarësisht pozicionit të saj gjeografik, larg metropolit dhe e ndarë në dysh, ka akoma energji që premtojnë për të ardhmen.

Nga Tryeza e Rrumbullakët e zhvilluar në librarinë Tirana Times me 7 Maj në Tiranë. Foto: Afrim Karoshi

projekt të ndiqet rigorozisht në mënyrë që ai të zbatohet pa patur devijime dëmtuese për prespektivën e rrugës, siç ka patur deri tani.

Znj. Saraçi theksoi rolin e grave në lobimin për Rrugën e Arbërit dhe kërkesën e të rinjve që ndërtimi i kësaj rruge të mos shtyhet më, pasi e ardhmja e tyre lidhet ngushtë me zhvillimin infrastrukturor të Dibrës.

Duke vlerësuar natyrën në të cilën është hartuar dhe drejtuar peticioni që në fillim, z. Meta theksoi rolin e rëndësishëm që shoqëria civile mund dhe duhet të luajë në Shqipëri.

Z. Meta në fund i inkurajoi pjesëtarët e grupit të lobimit të jenë në kontakt me të dhe institucionin e Kuvendit për ecurinë e peticionit.

Pas përfundimit të takimit me z. Meta, po më 6 Maj 2014 në orën 14:00, delegacioni i intelektualëve dibranë u prit nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, z. Edmond Haxhinasto.

PRESIDENTI NISHANI: KENI GJITHË MBËSHTETJEN, SI QYTETAR DHE SI PRESIDENT!

Më 7 maj 2014 në orën 11:00, ishte Presidenti i Republikës ShTZ Bujar Nishani që priti në një takim zyrtar grupin lobues për Rrugën e Arbërit.Në takim, pas prezantimit shkurtimisht të ecurisë së projektit të Rrugës së Arbërit nga delegacioni i intelektualëve dibranë, Presidenti vlerësoi nismën e tyre për të lobuar nëpërmjet peticionit për ndërtimin e Rrugës së Arbërit dhe për zhvillimin e zonës së Dibrës.

"Rruga e Arbërit nuk ka asgjë më pak se sa ajo që sot mban emrin 'Rruga e Kombit' për nga rëndësia kombëtare, duke qenë se sjell më pranë nesh shqiptarët e Maqedonisë. Kjo rrugë duhet të ndërtohet dhe këtu nuk duhet të shtrohet më çështja e fizibilitetit. Është apo jo fizibël Rruga e Arbërit, rëndësia e kësaj vepre nuk duhet të matet me aspektin ekonomik të saj. Kjo vepër ka vlera simbolike jo vetëm për zonën e Dibrës por sjell pranë njëra-tjetrës disa zona në Ballkan. Unë rradhën e fundit në Peshkopi shkova me helikopter, pasi kur je president e ke këtë mundësi, megjithatë po qe se do të ishte ndërtuar Rruga e Arbërit do të kisha kënaqësi të udhëtoja me makinë. Duke udhëtuar me helikoter e kupton më shumë se sa e shkurtër është distanca nga Tirana në Dibër. Unë në rolin tim ju siguroj se mbështetja ime nuk do të mungojë dhe se në çdo rast që të kem mundësi do të shprehem në favor të ndërtimit të saj. Ju keni bërë shumë mirë që keni bërë peticionin si shoqëri civile dhe më ka bërë përshtypje gjuha me të cilën ju keni hartuar kërkesën tuaj që nga letra e parë që më dërguat Gëzim. Kur kam qenë në pozitën e ministrit, e kam ndjerë që ne na duhet ndihma e shoqërisë civile dhe unë ju përgëzoj për inicitiavën pasi kështu veprojmë më mirë në shërbim të vendit",- tha z. Nishani

Grupi i intelektualëve dibranë e njohu Presidentin me mesazhet që morën nga takimi i Peshkopisë, me një panoramë të historikut të deritanishëm të rolit të shoqërisë civile në këtë proces si dhe nevojën që shprehin dibranët, sidomos të rinjtë, që ndërtimi i kësaj rruge të mos shtyhet më, pasi e ardhmja e tyre lidhet ngushtë me zhvillimin infrastrukturor të Dibrës.

"Jam unë që ju falenderoj juve për këtë nismë intelektuale, jo-politike dhe mendoj se duhet të ketë më shumë të tilla në Shqipëri. Ju e dini se zbatimi i projekteve të tillë i kalon kompetecat e Presidentit dhe i takon ekzekutivit të reagojë.Gjithsesi, unë ju garantoj mbështetjen time si qytetar në rradhë të parë dhe sigurisht edhe si President i vendit."- u shpreh z. Nishani.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT: SË BASHKU PËR DIBRËN

Më datë 7 maj, në librarinë Tirana Times u organizua një tryezë e rrumbullakët për Dibrën, me temën kryesore, çështjen e Rrugës së Arbërit.

Kjo tryezë e rrumbullakët u organizua një vit pas nisjes së peticionit online për Rrugën e Arbërit, inicuar nga Dr. Gëzim Alpion, profesor në Universitetin e Birmingamit në Britani.Në grupin organizues ishin edhe znj. Erisa Saraçi e cila është njëra nga drejtueset e medias sociale "PeshkopiDiberAlbania", me qendër problematikën e Dibrës, z Hysen Uka, si njëri nga nismëtaret e parë të shoqërisë civile për sensibilizimin e rrugës së Arbërit si dhe z. Bujar Karoshi, aktivist dhe redaktor i gazetës Rruga e Arbërit.

Në tryeze ishin të ftuar gjithë deputetët e Dibrës, përfaqësues të pushtetit lokal dhe qendror si dhe drejtues të shoqatave dibrane në Tiranë dhe jo vetëm. Në tryezë morën pjesë deputetët e Dibrës z. Ulsi Manja, z. Sherefedin Shehu, z. Bedri Hoxha, z. Roland Keta si dhe deputeti i Tiranës me origjinë nga Dibra, z. Rakip Suli.

Morën pjesë në këtë veprimtari, gjithashtu, znj. Mira Pirdeni, z. Saimir Shatku, z.Bujar Kapexhiu, drejtues të Bashkësisë Dibrane, si dhe z. Shpëtim Cami, Bashkim Lleshi dhe Demir Osmani nga shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibrane, si dhe znj. Yllka Causholli, drejtuese e nje komisioni Ad-Hoc nga shoqatat joqeveritare për rrugën e Arbërit. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre në këtë prezantim edhe tre ish-ambasadorë dibrane, z. Sulejman Tomcini, z. Bashkim Pitarka, z. Faruk Borova si dhe aktivistë të shoqërisë civile z. Kastriot Frashëri dhe z. Arjan Lame, si dhe përfaqësues të mediave, z. Anxhelo Xhaçkën dhe z. Valmir Gashi

Kjo veprimtari ishte në kuadrin e dorëzimit zyrtar të peticionit Kryeministrit të Shqipërisë. Në lidhje me këtë, grupi iniciator i peticionit zhvilloi disa takime zyrtare, mes të cilëve me Presidentin e Republikës z. Bujar Nishani, Kryetarin e Kuvendit z. Ilir Meta si dhe

"Peticioni, i cili deri tani është nënshkruar nga afro 7000 njerëz online dhe në letër, nuk duhet shikuar si një nismë një-vjeçare, por si një etapë e re në përpjekjet e intelektualëve dibranë, të cilët për afro 20 vjet, po theksojnë se ndërtimi i Rrugës së Arbërit do të mundësojë fillimin e rimëkëmbjes ekonomike të Dibrës. Pavarësisht dorëzimit zyrtar të peticionit, këmbëngulja e intelektualëve do të jetë deri në ndërtimin e metrit të fundit të rrugës, me cilësi dhe me standarde".

Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës z. Edmond Haxhinasto.

Nga organizatorët u krijua një panorame e peticionit online, si një risi e teknologjisë dhe ndikimi i saj në jetën sociale e politike. Sipas Dr. Gëzim Alpion, ky peticion deri tani është nënshkruar nga mbi 6000 njerëz online dhe në letër dhe nuk duhet shikuar si një nismë një-vjeçare, por si një etapë e re në përpjekjet e intelektualëve dibranë, të cilët për afro 20 vjet, po theksojnë se ndërtimi i Rrugës së Arbërit do të mundësojë fillimin e rimëkëmbjes ekonomike të Dibrës. Gjithashtu ai theksoi se peticioni do të mbetet deri në fund një peticion jo politik dhe është shumë e rëndësishme që kjo çështje të mos politizohet.

Vlen të theksohet se kjo tryezë e rrumbullakët u përqendrua vetëm në çështjen e Rrugës së Arbërit dhe peticionin për të.Ky aktivitet ishte një rast shumë i mirë për të shkëmbyer mendime se si kjo vepër e rëndësishme të përfundojë sa më shpejt dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Të gjithë pjesëmarrësit shprehën mendime se si mund të finalizohej me sukses nisma si dhe çfarë mund të bëjë secili individualisht dhe të gjithë së bashku për Rrugën e Arbërit, e cila jo vetëm do ta nxjerrë Dibrën nga izolimi, por do të shërbejë si një nga arteriet kryesore të vendit në infrastrukturë.

Deputetët e pranishëm shprehën angazhimin e tyre publik, që megjithë vështirësitë financiare që ka vendi, ky projekt të finalizohet me sukses.

* * *

Në mëngjesin e datës 7 maj, Dr. Gëzim Alpion ishte i ftuar televizionin Ora News në emisionin "Morning Express" me gazetaren Eva Idrizllar. Aty u fol jo vetëm për peticionin dhe rëndësinë e Rrugës së Arbërit, por edhe për botimet dhe librin e ri që po shkruan Dr. Alpion mbi Nënë Terezën. Ndërsa në mbrëmjen e datës 7 maj, në emisioni Tonight të gazetares së njohur Ilva Tare u realizua një debat televiziv me temën "Rrugëtimi i Rrugës së Arbërit". Ndërsa më date 8 dhe 9 maj, Dr. Gëzim Alpion zhvilloi një leksione në Akademine e Filmit "Marubi" dhe në Universitetin e Vlorës'Ismail Qemali', ku pavarësisht tematikave të leksioneve, u foli të pranishmëve edhe për Rrugën e Arbërit, si një arterie kombëtare që nuk është e vlefshme vetëm për Dibrën, por për të gjithë Shqipërinë dhe u bëri thirrje që ta nënshkruajnë peticionin.

ORGANIZATORËT: PETICIONIN IA DORËZOJMË VETËM KRYEMINISTRIT

"Që nga largimi ynë nga Shqipëria më 11 Maj, një numër i madh intelektualësh shqiptarë dhe të huaja si dhe ente të ndryshme mediatike na kanë kontaktuar për të mësuar se përse peticioni nuk iu dorëzua Kryeministrit kur ishim në Tiranë", thotë Dr.Gëzim Alpion për gazetën "Rruga e Arbërit". "Ne kemi vazhduar komunikimin me Zyrën e Kryeministrit dhe së shpejti, do të bëjmë një njoftim publik lidhur me fazën në të cilën është dialogu ynë. Në përgjigjet tona ne kemi theksuar se, pavarësisht nga mesazhet jo të qarta nga Zyra e Kryeministrit në lidhje me kërkesën tonë për një takim zyrtar, ne nuk jemi në dijeni dhe as nuk jemi prononcuar në asnjë rast se z. Edi Rama ka refuzuar të na presë.

"Kjo është arsyja që ne e kemi vazhduar komunikimin me Zyrën e Kryeministrit dhe, së shpejti, do të bëjmë një njoftim publik të rëndësishëm në lidhje me fazën në të cilën është dialogu ynë me z. Rama," tha Alpion. "Ashtu si deri tani, ne gjithmonë do të vazhdojmë të distancohemi nga çdo ent mediatik që përpiqet t'i japë nota politike peticionit tonë tërësisht jo-politik".

"Peticioni, i cili deri tani është nënshkruar nga afro 7000 njerëz online dhe në letër, nuk duhet shikuar si një nismë një-vjeçare, por si një etapë e re në përpjekjet e intelektualëve dibranë, të cilët për afro 20 vjet, po theksojnë se ndërtimi i Rrugës së Arbërit do të mundësojë fillimin e rimëkëmbjes ekonomike të Dibrës", theksoi Alpion në një prononcim disa orë para se gazeta të shkonte për botim, duke ritheksuar vendosmërinë e shfaqur që në fillim, që "pavarësisht dorëzimit zyrtar të peticionit, këmbëngulja e intelektualëve do të jetë deri në ndërtimin e metrit të fundit të rrugës, me cilësi dhe me standarde".

Shënim: Për arsye të materialit shumë të gjatë, redaksia ka menduar që gjithë debati i zhvilluar në Peshkopi dhe Tiranë lidhur me propozimet dhe idetë për rolin që mund të luajë shoqëria civile, të zgjedhurit vendorë dhe deputetët në këtë proces, do të botohet në numrat e ardhshëm.

Rruga e Arbërit nr. 97

Intervistë me shkrimtarin Agron Tufa: Sa ka ndikuar Dibra në krijimtarinë e tij letrare? Kur mendoi se do të bëhej shkrimtar dhe kur e shkroi poezinë e parë? Cilat janë pasojat e diktaturës? Dibra është provincë apo qendra e Shqipërisë? A duhet të jemi krenarë që jemi dibranë? Çfarë është Universiteti i Dibrës? Çdo të thotë Rruga e Arbërit për Dibrën? Këto dhe shumë pyetje të tjera ekskluzivisht për gazetën "Rruga e Arbërit" dhe faqen sociale në FB "Peshkopi,Dibër,Albania".

Dibra më bëri ta njoh shumë shpejt ligësinë

Intervistoi: **Sashenka NDREKA**

- Ju jeni i njohur si shkrimtar, por shpesh shfaqeni edhe si publicist në median qendrore. Kur e kuptuat që tëshkruarit ishte profesioni që donit të bënit?

- Unë nuk jam një publicist, por një shkrimtar gjerësisht i njohur, që kam shkruar deri më tash 14 libra dhe kam fituar shumë çmime Kombëtare e Ndërkombëtare. Publicist jam vetëm atëherë, kur dua të shfaq nervin tim social, ose pse jo, thjesht për honorare, kur më kërkojnë redaksitë. Shkrimtar kam dashur të bëhem që në klasë të katërt, fillore dhe këtë e shpalla një pasdite dimri në fshatin e lindjes, Sohodoll, kur im atë marangoz, po më mësonte të zdrugoj ca dërrasa, me gjasën se do të trashëgoja zanatin e tij. Nga një radio e vogël me bateri jepej radiodramatizimi i romanit "Djaloshi zezak" të shkrimtarit amerikan Richard Rayt, të cilin e kisha lexuar vetëm disa muaj më parë. Im atë e pa që s'e kisha mendjen dhe më tha: "Ke ndërmend me mësu, apo më lodh kot? Çfarë don të bëhesh, e ke mendu?" I thashë: "dua të bëhem shkrimtar!". Për çudi, im atë qeshi me të madhe: "Ha-ha-ha", sa u thye më dysh. Ai qeshte shumë rrallë. "Pse po qesh?", e pyeta. "Po, pra po! Shkrimtar! Ha-ha-ha...! Don me u bá si atë Gjergj Fishta... Po dije, se pisk do ta kesh punën. Shkrimtarët i dënon partia!" Unë e kundërshtova: "Nuk është e vërtetë, thashë: po Dritëro Agolli? Po Ismail Kadare?". Ai po montontonte dy pjesë të zdruguara që i kishte shënuar me një laps plumbi - njërën "m" dhe tjetrën "f" (më vonë kuptova se këto shkronja shenjonin"mashkull" dhe "femër" për pjesët e montuara që hynin njëra në tjetrën). Doja të më përgjigjet, dhe m'u përgjigj, pasi mbaroi punën e përqendruar, bashkë fërshëllimën e një kënge me çifteli, që unë e njihja, që ishte "kënga e Mahmut Dacit". Pra, si mbaroi fërshëllimën, m'u kthye e më tha: "ata nuk i dënon Partia, se ata i këndojnë Partisë... Ti, edhe po i këndove Partisë, nuk të zë besë kush, se je biri i një"reaksionari", more vesh?". Në fakt mora vesh, por jo aty, dhe jo menjëherë... vite më vonë, pak nga pak...

- Në veprat tuaja, veçanërisht në 4 romanet e vlerësuara lart nga kritika ("Dueli", "Fabula rasa", "Mërkuna e zezë", "Tenxhere") është e pranishme gjithmonë bota e fëmijës, personazhi-fëmijë, e sidomos adoleshenti, përherë në marrëdhënie me babain (Atin, në një kuptim metaforik). Cila është fëmijëria e shkrimtarit Agron Tufa dhe ku e ka origjinën kjo fëmijëri dhe adoleshencë që shtegton nga vepra në vepër? A mund të në jepni një rrëfim ekskluziv, paksa më të zgjeruar se zakonisht?

- Po provoj, disi.. por kjo pyetja juaj është e denjë për t'ju përgjigjur me një libër-ese të zhanrit të memuaristikës...

Të gjithëve na ka rastisur, të paktën njëherë në jetë, të kemi mbajtur në duar një balonë... Balonë, jo balonë - tollumbace mbase - nuk qëndron këtu problemi... I rëndësishëm është parimi i thjeshtë i fillit që mban fëmija ndër duar dhe ngjitja e balonës lart e më lart, mbi çati, mbi kurorat e pemëve, aq sa nga mahnitja e një ngjitjeje të tillë, përhumbesh dhe filli që mban balonën të del duarsh. Balona humbet në shtegtimin e rrymave të ajërta, diku ngec dhe fëmijën e mundon fati i panjohur i saj, përzier me njëfarë keqardhjeje, që nuk diti ta mbajë siç duket të shtrënguar fillin në duart tij të pasigurta.

Pak a shumë kështu ndodh me një të rritur kur rreket të gjejë fillin e humbur të balonës së fëmijërisë, e cila ka pluskuar tok me ëndrrat në eter. Ne provojmë t'u qasemi kujtimeve fëmijnore dhe rrekja jonë është një trajektore konfuze, e cila vjen duke u kthjelluar , në fillim me pamje të zbehta, mandej figura, zëra... derisa ato fitojnë qartësi, peshë e ndoshta edhe ngjyrë. Të rindërtosh fillin e identitetit tënd nëpër gjësende të humbura, të bëra fir, duke riprodhuar shijen dhe aromat e harruara, ashtu siç bënte Marsel Prusti në serinë e romaneve "Në kërkim të kohës së humbur", duke riprodhuar rastësisht nëpërmjet biskotave "madëlen" dhe një filxhani çaji, tërë sagën e harruar të fëmijërisë së platitur në përditshmërinë e zhurmshme! Kush ai substrat, ajo alkimi që e mban të pazhbëshme topografinë e kujtimeve tona? Kush ajo ngjarje që është ngulitur në mënyrën më të pashqitshme në kujtesën e parë? Është një, apo një formacion i shkapërdarë nëpër konturet e mjegullta? Po mundohem ta sjell një pamje të largët, që i ka mbijetuar kohës me pigmentin e saj të veçantë.

Gjithçka zuri fill një ditë nga pyetja e një gazetarjeje mbi fëmijërinë, në një intervistë të dhënë jo shumë kohë më parë.

Me këtë përvojë mbase ndikoj tek lexuesi i kësaj faqjeje, që në mënyrë analoge t'i "përfshij" edhe ata me fillin e largët të kujtimeve të tyre. E nëse kjo përpjekje nuk del aq e suksesshme, sa e mendoj unë, le të shpresojmë së paku mbi dobinë e kujtimeve tona miturake, duke u përpjekur të shquajmë figurën e përlargët të fëmijës që na vdiret prej sysh.

Në mituri kam përshtypjen se dy janë konceptet që organizojnë një farë përfytyrimi mbi botën: hierarkia dhe topografia. Topografia fillon me oborrin e shtëpisë dhe shtrihet në përputhje me zgjatimin e syrit. Njëherë e pyeta vëllain tim më të madh se unë (sepse ai ishte në gjendje të më shpjegonte çdo gjë), se si lind dielli. Ai më tregoi me gisht majën e një vargmali të Korabit në lindje, ku dalloheshin si vizatime në hi trajtat e shtëpive të fshatrave në shpatinë. "I sheh shtëpitë e atij fshati afër majës? Çdo mëngjes, akoma pa larë sytë, Hima (një djalë halle që e kishte shtëpinë në atë fshat) e merr diellin dhe e ngjitën me një palë shkallë të gjata në qiell. Pastaj, dielli, pasi kalon tërë qiellin, shkon prapë të flejë aty ku Hima e merr prapë çdo mëngjes". Në sytë e mi Hima u bë njeri i rëndësishëm. "Po nëse Hima nuk zgjohet dhe fle gjumë gjithë ditën, ne mbetemi pa diell!?", pyeta i tronditur. "Jo, Hima nuk fle, se atë punë ka". M'u duk e çuditshme. "Dielli ka krevat atje, pas asaj majës?" "Po, ai fle atje dhe i mbyll sytë. Është si një top, që i mbyll qepallat dhe fle", tha gjithë siguri im vëlla. Pastaj si duket bëra një pyetje të sikletshme, sepse vëllai filloi të brente thonjtë: "Po kur Hima vjen në shtëpinë tonë dhe nuk zgjohet atje, ku fle dielli, kush e ngre diellin në qiell?". "Kjo është një pyetje budalle!", tha i inatosur im vëlla. "Jo, nuk është pyetje budalle!", ngula këmbë. "Po mirë...", tha im vëlla "a nuk e ke vënë re, se Hima vjen tek ne vetëm në kohë me shi? Dhe kur koha është me shi, nuk bie diell. Kjo do të thotë, se dielli është shumë i lodhur për atë ditë dhe dëshiron të flejë". Nuk isha i sigurt. Andaj i thashë: "prit të të shtyp majën e hundës". "Pse?", tha ai. "Të shoh a rren a s'rren. Po dolën ata pikërrizat e bardha, ti rren!". Vëllai nuk pranoi dhe unë vendosa të pyes vetë Himën. Por Hima nuk erdhi gjithë verën, sepse gjatë gjithë verës nuk ra shi. Kur ka rënë shiu i parë, edhe unë duhet të kem harruar... Sepse shiu sillte në përroin përbri shtëpisë sonë përfytyrime të tjera, bashkë me zhaurimën e jehonave ndër vesh - një "auuuuauuu" e patësosur.

Njerëzit e pushtetit të Dibrës të fëmijërisë sime kanë bërë çmos që të më shkatërrojnë, të më shtypin, të më pengojnë... Kush është vendlindja? Janë njerëzit! Malet, kodrat, fushat e lumejtë, nuk pengojnë kënd, përkundrazi, janë të vetmet gjëra bujare të vendlindjes që s'kishin ndonjë inat me mua, përkundrazi....

TAKIMI ME BABAIN

Ngjita shkallët dhe në një nga dhomat e katit të dytë, midis policëve, gjeta tim atë. Qe ulur në njërin nga sepetet e nusërisë së nënës sime dhe iu afrova afër gjunjëve. Pashë fytyrën e tij, mustaqet, kësulën, duart e lidhura me hekura dhe sidomos sytë e tij të ngulur në fytyrën time. Në tavan, midis trarëve poshtë çatisë, nën hatulla, rrëmonin policët. I ngriti duart e lidhura dhe më përkëdheli flokët. "Ç'kemi, shoku Agron?", - më pyeti me nënqeshje. "Unë di kush je ti!", i thashë. "Pa hë, na e thuaj", tha ai. "Ti je baba!", thashë, duke e prekur me gishtin tregues në gjoks. "Jo more... po si e gjete?", pyeti ai me një shprehje serioze. "Babë, pse t'i kanë lidhur duart?" - e pyeta. "Po bëjmë një lojë, Agron", më tha, kësaj radhe tek veshi. "A të t'i ç'lidhi?" thashë, dhe u përpoqa të gjeja vendin ku ishin lidhur ato duar të mëdha. "Jo, jo, se pastaj e humb lojën!

Ndërsa përposh derdheshin rrëmbyeshëm valët e turbullta ngjyrë dherash dhe mua më dukej se ishte një lum prej groshe të zier. Dikush i mistertë, një hy i pashpjegueshëm, shumë më lart se majëmali ku jetonte Hima, e kurdiste këtë spektakël legjendar. Ai, sigurisht, ishte një njeri i Plotfuqishëm, enigmatik e çudibërës, që vinte ca kazanë të stërmëdhenj me fasule... e ja, tash, si i derdh njëri pas tjetrit, për t'ua dërguar të shuajnë urinë, atyre që punojnë në fusha...

Hierarkia është pranishme brenda shtëpisë; janë njerëzit e familjes nga varet ekzistenca jote, ndër ta, më e rëndësishmja, nëna. Pastaj rreth teje dallon persona të tjerë, të cilëve, me kohë, u vesh domethënie mitologjike: Gjyshi, gjyshja, vëllezërit dhe motrat më të rritura. Hierarkia fillon të qartësohet me rolet që zënë ata në botën shtëpiake, me shpjegimet që të japin dhe me edukimin e përvojave të para. Nga gjithë kjo hierarki familjare, flitej vazhdimisht për një person të tretë, të rëndësishëm, që nuk ndodhej aty. Ishte fjala për tim atë, për të cilin flisnin me të pëshpëritura, ndërsa gjyshja fshinte sytë me cep të shamisë. Emrin e tij ma kishin mësuar me këmbëngulje që ta mbaja mend dhe t'i përgjigjesha gjithkujt kur të më pyesnin: "i kujt je ti?". Ndjeja kurreshtje dhe mister për tim atë që nuk e njihja. Konceptet e atësisë, përkatësisë etj, etj, asokohe nuk ekzistonin tek unë. Në hierarkinë familjare përpiqesha të gjej vendin e zbrazët të tij, diku midis gjyshit, gjyshes e nënës. Për herë të parë u ndesha me të kur isha rreth 3 vjeç, në një situatë të çuditshme. Një paradite pranvere erdhën policët. Na nxorën përjashtë, në bahçe, të gjithëve. Në fakt këtë e bënë me mirësjellje dhe në përgjithësi i admirova uniformat e tyre të reja, kapelat, këpucët e lustruara që shkëlqenin. Doja t'i prekja, por gjyshja më tërhoqi fort pas vetes. Fytyrat familjarëve të rritur ishin të ngrysura e të shqetësuara, aspak të mahnitura. Midis tyre ishte një njeri i zakonshëm, shtatgjatë, me kësulë të bardhë në kokë dhe me duar të lidhura. Derisa shtëpia u zbraz, ai nuk m'i kishte ndarë sytë dhe këtë e kuptova kur ndesha vështrimin e tij, që qeshte nën mustaqe. Por unë nuk e dija kush ishte dhe më pëlqente të shikoja policët. I frymëzuar prej pamjes së tyre vrapova tek gjyshja, i kapa cepin e përparëses dhe i thashë më zë të lartë: "Kur të rritem dua të bëhem polic!". U zhgënjeva nga mospërfillja e saj e thatë, ndërsa vëllai i madh, prapa shpinës së saj, më kërcënoi me gisht. Burrin shtatlartë me kësulë, mustaqe e duar të lidhura nuk e lanë t'i takonte njerëzit e familjes sime. Nëna më pëshpëriste në vesh dhe mundohej të kallzonte me gisht në drejtim të tij, derisa ia doli të drejtojë ku duhet vëmendjen time: "Shihe mirë atë burrin... ai është yt atë!" Atëherë u kujtova për vështrimin e tij dhe qeshjen nën mustaqe.

Mandej pashë, se si policët hynë në shtëpinë tonë dykatëshe, si humbën nën hyrjen e harkuar të portës me qemer dhe si ngjitën shkallët në katin e dytë. Tek dera qëndronte serioz, solemn, pa shprehje njëri nga policët. Arrita t'u shkëputem duarve të nënës sime dhe u turra drejt hyrjes së shtëpisë sonë, por u ndala në prag, para këmbëve të policit. E pashë nga poshtë fytyrën e tij të drunjtë dhe hyra. Nuk më ndaloi. Ngjita shkallët dhe në një nga dhomat e katit të dytë, midis policëve, gjeta tim atë. Qe ulur në njërin nga sepetet e nusërisë së nënës sime dhe iu afrova afër gjunjëve. Pashë fytyrën e tij, mustaqet, kësulën, duart e lidhura me hekura dhe sidomos sytë e tij të ngulur në fytyrën time. Në tavan, midis trarëve poshtë çatisë, nën hatulla, rrëmonin policët. I ngriti duart e lidhura dhe më përkëdheli flokët. "Ç'kemi, shoku Agron?", - më pyeti me nënqeshje. "Unë di kush je ti!", i thashë. "Pa hë, na e thuaj", tha ai. "Ti je baba!", thashë, duke e prekur me gishtin tregues në gjoks. "Jo more... po si e gjete?", pyeti ai me një shprehje serioze. "Babë, pse t'i kanë lidhur duart?" - e pyeta. "Po bëjmë një lojë, Agron", më tha, kësaj rradhe tek veshi. "A të t'i ç'lidhi?" thashë, dhe u përpoqa të gjeja vendin ku ishin lidhur ato duar të mëdha. "Jo, jo, se pastaj e humb lojën! Nëse policët e gjejnë çfarë kam fshehur atje, nën çati, unë e humb lojën", tha im atë. "Po pastaj, kur do ta nisësh lojën tjetër?", pyeta prapë. "Pas dhjetë vjetësh", më tha tek veshi tjetër. "Po bukë, si do të hash tani, me duar të lidhura?". "Ia zgjidhim duart", tha kësaj here njëri nga policët që rrinte në të majtë, përbri tim eti. Aq shumë u përkul të ma thoshte këtë, sa streha e kapeles së tij më preku ballin. Ndërkaq, një zë i fortë polici nga hatullat nën çati tha: "i gjetëm!". Pas pak pashë t'i hidhte njërën pas tjetrës 2 pushkë, një teneqe fishekë dhe një revole, të cilat i priti virtuozisht njëri nga policët. Pasi i grumbulluan, policët hapën një mushama të zezë dhe i mbështollën. "Ato ishin tonat? Pse s'më the mua ku t'i fshihje! Di vende të fshehta unë...!", i thashë tim eti me qortim e krenari. Shpërfillshëm më përkëdheli për herë të dytë flokët me pëllëmbët e pranguara. "Po pse ua tregove!", i pëshpërita me zë të ulët e konspirativ. "Nuk ua tregova! Ishte lojë, mor bir, të thashë... ata i gjetën". Heshtje. Dëgjohej zhurma e mushamasë që paketonte arsenalin e vogël të armëve. "Të më kishe pyetur mua", thashë për herë të dytë mjaft i mërzitur: "di një vend të fshehtë që nuk e di askush, përveç motrës...". Nuk pata më kohë t'i tregoja tim eti se ku gjendej vendi i fshehtë, sepse skuadra e policëve e vuri para. Ai më puthi kokën nxitimthi dhe u lëshuan shkallëve thuajse me vrap, aq sa mezi arrita t'i shquaj kur ata po dilnin nga dera e avllisë. Kur shkova në fund të rrugicës, te kroi, ku kish qëndruar Gazi i Degës, gjeta veçse një re të dendur pluhuri, që linte prapa makina në largim.

- Po poezinë tuaj të parë, kur e keni shkruar? Për çfarë ishte dhe çfarë ju frymëzoi ta shkruanit?

- Kam shkruar që pas klasës së tetë, por kryesisht gjëra zbavitëse, për të qeshur me shokët. Ndërsa seriozisht, poezinë e parë e fill pastaj të tjerat, i kam shkruar rreth moshës 17 vjeç, kur kisha rënë në dashuri platonike me një gjimnaziste të Peshkopisë, për më tepër, në formën më të pashpresë, pa ia bërë të ditur asaj, d.m.th., pa përgjigje.

- Sa ka ndikuar vendi ku jeni rritur në krijimet tuaja?

- Nuk mendoj se ka ndikuar vendi ku jam rritur. Është një klishé kjo. Madje mund të them me tërë sinqeritetin tim një të vërtetë të padiskutueshme, që s'guxon të ma kundërshtojë kush: vendlindja, Dibra, më saktë - njerëzit e pushtetit të asaj Dibre të fëmijërisë sime - kanë bërë çmos që të më shkatërrojnë, të më shtypin, të më pengojënë dhe, me sa kanë patur mundësi, janë përpjekur që këtë ta bëjnë sa hapur, aq dhe tinëzisht. Sepse kush është vendlindja? Janë njerëzit! Sigurisht, nuk janë malet, kodrat, fushat e lumejtë, as shiu e bora, pra s'janë peisazhi e dukuritë e natyrës. Ato dihet, nuk pengojnë kënd, përkundrazi, janë të vetmet gjëra bujare të vendlindjes që s'kishin ndonjë inat me mua, përkundrazi.... Pra mbetet që njerëzit, sepse ata e kanë patur të ardhmen time në dorë. Dhe sa e kishin, nuk lanë mjet e mënyrë pa më penguar.Nëse duhet t'i jem ndokujt mirënjohës, duhet t'i jem vetes sime, këmbënguljes sime për të shpikur një realitet shumë më të bukur e më fisnik, se vulgaritetet e shkollës dhe jetës në komunizëm me luftën idote të klasave, biografitë e gjithë çmenduritë që nuk i rrëfen dot pena.

intervistë

Filiali i Universitetit në Dibër është në vazhdën e shakave të tejzgjatura e absurde që prodhojnë shoqëritë e keqvendosura. Ky lloj universiteti ka lidhje më "Universitetin e Dibrës", që përmend Emery, aq sa kanë lidhje kioskat tona me Harwardin e Oxfordin.

njerëzore, vogëlsinë dhe fanatizmin absurd

Nëse me ndihmon vendlindja në krijimtarinë time, ja, pikërisht këtu më ndihmon: ajo më bëri ta njoh shumë shpejt ligësinë njerëzore, vogëlsinë dhe fanatizmin absurd. Njerëzit janë hipokritë të neveritshëm, bash në ato raste kur i dorëzohen një ngazëllimi prej viçi dhe mburren me vlerat e Dibrës, ndërkaq na e paraqesin Dibrën sikur ajo paskësh qenë parajsa vetë! Nuk është aspak ashtu: pse ta gënjejmë veten? Po nuk kemi kujtesë peshku dhe e dimë çfarë mizerabliteti ka qenë ajo jetë fillim e mbarim! Mua në vend të studimeve të larta, sekretari i Partisë së Kooperativës më premtonte të më fuste në burg! Ku është pra kontributi i vendlindjes këtu? Apo që të shitemi "patriotë" - një mall skarco, që ka veçse vlerë fallco.

Po të mos jesh i zoti të ndjekësh ëndrrën tënde, të fitosh kulturën që do, vendlindja të lë në gjendje natyrore: kungull në arë!

- Ju keni shkruar për Dibrën, por a ka qenë Dibra një ndihmesë për karrierën tuaj si shkrimtar në aspektin tematik, apo e anasjellta qëndron më shumë?

- Shiko, të themi një gjë thelbësore: nuk është në dorën e njeriut ku duhet të lindë ai, por të Zotit. Po të ishte në dorën time, nuk do të desha të kisha lindur as në Dibër, as në Shqipëri, e po ashtu, do të ndryshoja dhe kohën historike të lindjes. Çfarë të të jepte Dibra e shkretë në kohën dhe kontekstin socio-historik të brezit tim? Të gjithë e dimë, se bëhej fjalë për mbijetesë. Se kishte shumë pak shpresë dhe shumë marrëzi. Brezi, shokët e mi, të gjithë jemi rritur me sakrifica, me privime të mëdha, me mungesa, si gjithë shoqria jonë në komunizëm. Dibra komuniste s'kishte çfarë të të jepte, apo jo? Torturë? Atë e kishe gratis. T'i harrojmë konceptet e përdala si "histori", "kulturë", "edukatë", etj, etj. Sigurisht që Dibra i ka patur, por të gjitha t'i servirnin në një mënyrë të shpifur përmes prizmit ideologjik komunist. Por cila ideologji mund të përcillet e saktë nga kokëqypat e kokëtrashët partiakë të formatit lokal. Im atë, ose shokët e tim eti kishin në memorien e tyre të rinisë një Dibër "tjetër", ndërsa Dibra "jonë" ishte shumë e varfër shpirtërisht dhe fizikisht. Marrëdhëniet e mia me Dibrën janë ato të një idealisti, i cili përpiqet që të marrë e mbledhë prej saj gjërat më të vyera, për t'ia kthyer dhjetëfish më të bukura, përmes artit, i cili të bën të përjetshëm. Kuptohet, tematika e realet e Dibrës në veprën time janë të pafundme; shpesh ato nuk bien trashë në sy, po gjithë bota dibrane është e kamufluar pas matricës letrare. Dhe natyrisht, bota e një njeriu formësohet aty ku ai ka mbërritur adoleshencën. Unë jam rritur e kam kaluar moshën mbi njëzet vjeç në Dibër. E prapë, vetë tingëllimi i fjalës "Dibër" gjithmonë më emocionon. Por e kam për vete dhe s'duroj dot ta lavdërojnë njerëzit banalë, as ta shajnë s'duroj dot.

- Prej gati 20 vitesh qeverite shqiptare kane premtuar Rrugën e Arbrit, ndërtimi i së cilës mund të "ndryshonte" pikëpamjen se Dibra është një zonë në provincë të Shqipërisë. Çfarë mendoni ju për këtë? A do ishte ndërtimi i Rrugës një hap edhe në emancipimin e Dibrës?

- Duhet ta pranojmë një fakt: Dibrën nuk e kanë dashur asnjëherë pushtet. Dibrën e kanë shfrytëzuar, ia kanë mohur kontributin që ka dhënë për Kombin. Elitat e Dibrës, ushtarët, vullnetarët e saj kanë qenë të parët që janë rreshtuar në çdo rrezik. Varret e dibranëve i gjen të shpërndara nëpër gjitha tokat shqiptare. E anasjellta - jo! Është një histori i gjatë mosmirënjohje. Por për këtë e kemi fajin vetë. Paria e Dibrës, si dje, si sot, rreshtohet më shumë si mercenare pushtetesh për interesat e veta. Kështu dhe me Rrugën e Arbrit. Pa këtë Rrugë, Dibra do të mbetet vendi provincial më i izoluar i Shqipërisë, siç edhe është në fakt.

Si zgjidhet kjo? Ka dy mënyra.

E para, Dibra ka në Parlamentit shqiptar çdo legjislaturë nga 6 deputetë. Plus një pjesë tjetër që është në Tiranë dhe i përket origjinës dibrane. Sipas llogarive bëhen nja 13 deputetë. A ka ndodhur që ata të bashkohen njëherë për të vendosur zhbllokimin e Dibrës? Se, po të kishin dashur, e bënin; Dibra do t'i mbështeste me shpirt, pa dallim ngjyrash politike. 13 deputetë (zëre dhe 6) do ta mbanin peng Parlamentin, derisa të zgjidhej çështja e fondeve për Rrugën e Arbrit, sipas standardeve. Atëherë, pse pranojnë të turpërohen këta deputetë, që zgjidhen me votën e vëllezërve

Tematika e realet e Dibrës në veprën time janë të pafundme; shpesh ato nuk bien trashë në sy, po gjithë bota dibrane është e kamufluar pas matricës letrare. Dhe natyrisht, bota e një njeriu formësohet aty ku ai ka mbërritur adoleshencën. Unë jam rritur e kam kaluar moshën mbi njëzet vjeç në Dibër. E prapë, vetë tingëllimi i fjalës "Dibër" gjithmonë më emocionon. Por e kam për vete dhe s'duroj dot ta lavdërojnë njerëzit banalë, as ta shajnë s'duroj dot.

të tyre, për premtimin e pambajtur të Rrugës së Arbrit? A janë kësioj këta deputetë përfaqësues të vullnetit dibran? Unë them se jo dhe se pjekuria jonë, do të kishte qenë refuzimi kategorik për të dalë në votime!

Mënyra e dytë, është të gjendet një formë jashtë politikës dhe premtimeve hipokrite dhe të organizohet një punë vullnetare me mbledhje fondesh nga popullata deri në diasporë, duke parë edhe forma të ndryshme kombinimi e bashkëpunimi me shtetin si garant, bankat, firmat apo fondacione ndërkombëtare, në bazë të legjislacionit tonë. A është e mundur? Nuk ka gjë të pamundur, nëse bashkohemi sinqerisht për një çështje që na prek të gjithë. Kjo do të ishte dhe pjekuria jonë si vetëdije kolektive.

Dibra është realisht një zonë provinciale, pavarësisht potencialit të saj të rrallë bujqësor, blegtoral e frutikultural, sikundërse është edhe një zonë e pasur me minerale nga kromi deri tek gjipsi, pa folur për resurset turistike. Por këto margaritarë të Dibrës janë rraposur në baltë, pa Rrugën e Arbrit, e cila rrugë do të thotë Treg, Dinamizëm teknologjik, Turizëm, Kulturë, Zhvillim, rrjedhimisht - Mirëqenie.

Atëherë do ta shohim nëse është apo jo Dibra zonë provinciale. Provincialiteti ekziston vetëmse në mendje, jo në hapësirat potenciale të Dibrës. Të mos harrojmë një fakt gjeografik: Fusha e Dibrës në pellgun e Drinit të Zi dhe Fusha e Korçës janë dy simotra nga pjelloret në Shqipëri, të dyja me një sipërfaqe 850 km 2. Dhe ky "hambar", që ka thyer rekorde ndërkombëtare bujqësore na qenka provincial? Pikërisht një mendje që e thotë këtë, po, ajo është menjëmend provinciale.

- Disa dibranë, mes të cilëve edhe studiues, duke u mbështetur në disa kujtime te Julian Emery, i cili ka kaluar disa ditë në Dibër dhe i ka krahasuar ato që mësoi atje, sidomos për politikën, më shumë se sa ai kishte mësuar në Oksford, madje edhe duke deklaruar se "Dibra është një universitet më vete", atëherë kur Dibra nuk e kishte.Tani që Dibra e ka një filial Universiteti, a është Dibra një universitet?

- Ja pra, se çfarë paradoksi! Julian Emery (thënien e të cilit e përmendin shpesh me mburrje prej kaposhi ish-sekretarët e partisë, duke mos ia përmendur emrin, për ta lënë këtë si vlerësim të kohës së tyre "të artë" komuniste), pra Julian Emery - i referohej një Dibre tjetër... Një Dibre para kolerës, një etnosi me një tjetër higjenë mendore, të paprekur nga perversionët që ndodhën më vonë. Komunizmi e griu atë fisnikëri shekullore që kishte mbrojtur brez pas brezi natyrën e dibranit, drejtpeshimin e tij mendor dhe konstruktin e tij etik. Por humbja e këtyre cilësive, masakrat që gjatë luftës së dytë botërore e deri në vitin 1948, mandej burgimet politike, internimet, lufta e klasave, varfëria ekstreme dhe nënshtrimi më anë të urisë, e privoi Dibrën sa nga tradita e begatë, aq dhe nga elitat e saj intelektuale e fetare. Filloi një histori tjetër, me një Dibër të aleienuar, duke zëvendësuar mençurinë proverbiale të Dibrës, që përmend Emery, me një frikë dhe servilizëm të pështirë për partinë, Sigurimin dhe pushtetin "popullor". Ndërkaq filiali i Universiteti në Dibër është në vazhdën e shakave të tejzgjatura e absurde që prodhojnë shoqëritë e keqvendosura. Ky lloj univesiteti ka lidhje më "Univesitetin e Dibrës", që përmend Emery, aq sa kanë lidhje kioskat tona me Harëardin e Oxfordin. Kjo më nxit të ndërmend edhe diçka tjetër: në antikitet, për shembull, ka pasur shumë shkolla filozofike, që njihen nga filozofia bashkëkohore si tradita thelbësore të mendimit. Për shembull, "sholla e Miletit", "shkolla Joniane", shkolla Eleate", "shkolla e Aleksandrisë" apo "shkolla e Pergamit"; të gjitha këto shkolla me filozofët që përfaqësonin, nuk ishin në kuptimin e sotëm "Universitete, Filiale, Institute, Fakultete", etj, etj, por thjesht, tradita mendimi, që përcilleshin e konsolidoheshin ndër përvoja kuvendimesh. E tillë ka qenë dhe "shkolla", apo "Universiteti" i Dibrës, pasi vinte si një traditë e pandërprerë ndër shekuj e mendjemprehtësisë së kuvendimit të burrave nëpër odat tona, me kthjelltësinë e gjykimit, figurshmërinë, alegorinë - që përbën edhe etikën e mendjes së hollë, që nuk vret, por zgjidh dilemat. Një kuptim të tillë ka patur "Universiteti" i mendjes dibrane, por, siç e dimë, zor se përtërihet më ajo "atlantidë", të cilën e zhbëri komunizmi. Tani kanë mbetur mburrjet e njerëzve defiçentë në emër të ca vlerave legjendare, që ata as nuk i kuptojnë, as nuk i praktikojnë.

Filiali i sotëm i Universitetit në Dibër, është "fastfudizimi" bashkëkohor i një gjysmëdijeje, nga gjysmëmësues që i vënë e i heqin pushtete politike, nga çerekstudentë të bazuar fort nga pagesa nën dorë, copy paste, dhe ndërhyrjet me mik. Gjithësej - një keqkuptim tragjikomik i raporteve me dijen, që dëmton ndonjë pedagog që e ka mision serioz punë e përgatitjen e tij dhe, sigurisht, tek-tuk, ndonjë student që shpreson deri diku. Ç'lidhje ka pra kjo formë e përçudshme dijeje me mendjemprehtësinë tradicionale të "Universitetit" të Dibrës? Në këtë mënyrë, ajo sentenca që thotë, se "mendja lindi në Shkodër, bujti një natë në Mirditë dhe ngrehu konak në Dibër", i bie, që nëse deri më tash nuk ka vdekur, me siguri tani ajo është në grahmat e fundit...

- Ndërkohë mbani pozicionin e Drejtorit në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. Është ky thjesht një pozicion zyrtar, apo ju lidh diçka më shumë me këtë detyrë? Cila ka qenë ngjarja që ju ka goditur më shumë gjatë studimeve në këtë fushë?

- Është një Institut i pavarur në veprimtarinë e tij, i krijuar nga Parlamenti shqiptar, në analogji me një rrjet institutesh të Kujtesave Kombëtare mbi Diktaturat, që veprojnë në vendet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore. Më zgjodhën Drejtor një senat pleqsh akademikë e profesorë, që kanë vuajtur shumë me familjet e tyre gjatë regjimit komunist.

E pranova këtë post si mision qytetar, pasi isha marrë disa vite me radhë në mënyrë individuale, duke botuar një kolanë të memuaristikës së burgjeve komuniste me emra intelektualësh e shkrimtarësh shumë të njohur, të cilët kaluan një jetë të tërë në burgje e kampe internimi. Janë të shumta ngjarjet "goditëse". Ata ndodhin çdo ditë në punën tonë me arkivat sekrete. Ajo që të shkurajon, është përmasa e lemerishme e krimit dhe niveli i rëndë ku e kishte zhytur komunizmi, organet e dhunës së diktaturës dhe Sigurimit të shtetit - krejt shoqërinë shqiptare: shkalla e mjetet e terrorit, sasia e panumërt e spiunëve (në raportin 4 me 1, ku në çdo 4 qytetarë, njëri është spiun). Më kanë bërë përshtypje listat e zeza dhe pushkatimet pa gjyq.

Por mbi të gjitha, dokumentacioni i pasur i dosjeve, që nuk shndërrohen në studime, për të ndryshuar perceptimi mbi historinë që kemi kaluar pas luftës së dytë botërore. Historianët tanë të linjës zyrtare, trashëgimtarë të shkencës komuniste - nga Kristo Frashëri, Paskal Milo, Pëllumb Xhufi apo Xhelal Gjeçovi - i kanë pasur e vazhdojnë t'i kenë arkivat plot, por kurrë nuk morën mundimin t'i nxirrnin këto të vërteta për publikun. Si duket, e kanë ndarë mendjen deri në vdekje të mbrojnë me çdo kusht gënjeshtrën. E kjo është një gjakftohtësi kriminale. E neveritshme!

-Kohët e fundit ju kemi parë të jeni aktivë edhe në mediat sociale (Facebook). Si e shikoni rolin e këtij mediumi në profesionin tuaj?

- Është mjet i dobishëm nëse e përdor ti FB-në e jo ai ty... e kam fjalën për varësitë e sëmura. Unë hedh ndonjë përkthim, a krijim, ndonjë lajm komunikim të shpejtë pune dhe aq. Përpiqem të rri sa më pak. Në fakt, për profesionin tim, dihet më e mira: të kesh kohë, dhe t'i fikësh të gjitha pajisjet me ekrane, me përjashtim të laptopit të punës...

- Ju jeni një nga përdoruesit më korrektë të gegnishtes në të shkruar. Mendoni se gegnishtja po venitet nga mospërdorimi letrar, apo përkundrazi, ka filluar të rigjallërohet?

- Qëkurse studentët e Letërsisë ankohen se "nuk kuptojnë Fishtën, Mjedën apo Camajn", kjo do të thotë se katastrofa ka ndodhur: vendimi politik i Kongresit të Drejtshkrimit për ta bazuar Standardin Kombëtar Letrar mbi dialektin toskë, shënoi përjashtimin e mbi 3/4 të folësve që gjuhë të tamblit kanë variantet gegnishte. Tani kemi prekur alienimin e plotë të "generation Pepsi-Cola" me repertorin 400 vjeçar të shqipes, nga gjeneza deri sot. Por vetë komunikimi i hapur i metropoleve të botës shqiptare sot, po sjell një situatë tjetër komunikimi të bartësve të gjuhës, ndryshe sa ka qenë në izolimin komunist. Kush shkruan në gegnisht (e cila sot është më ndryshe, jo si në kohën e Fishtës), përbën një akt rezistence kulturore. Me kohë e mëdekada (një a dy) dhe folësi do ta vendosë vetë tendencën e re. Por me kohë, jo sërish me vendime politike...!

Ajo që ju e quani dibranisht kemi kuptuar që ka të bëjë jo thjesht me dialektin si formë zbutëse e fjalëve, por edhe me filozofinë e të shprehurit.

- Në jetën e përditshme flisni dibrançe?

- Po. Madje edhe ime shoqe, që është nga Skrapari! Unë i adhuroj dialektet. Flas shpesh dialektin tonë dhe vë shpesh në siklet, ndonjërin që mundohet të "fshehë gjurmët" e gjuhës, çka don me thënë, prejardhjes.

- Nëse vendlindja ju ka frymëzuar në fillimet tuaja, po sot ku e gjeni frymëzimin për të shkruar?

- Si do që të jetë tema, Dibra është një e dhënë shqisore, ndërdijore, shpirtërore. Prej saj nuk shqitesh, nuk abstragon dot. Ajo është shkrirë në plazmën e supersticionit tonë, ka lëndën e ëndrrave, utopive naive djaloshare dhe mençurinë sentenciale të pleqve. Vendlindja mbetet në sfond, e hapur apo e fshehtë, se ajo më ka formësuar që në zanafillë tipologjinë e imazheve: ato krijojnë dhe shumëfishojnë botëra sipas modelit zanafillor të ngjizur në vendlindje.

- Keni ndonjë lajm ekskluziv për planet tuaja për të ndarë me ne?

- E dini, unë jam shumë punëtor, kam shumë oreks për punë, por mjerisht nuk kam kohë e vetja më duket njeriu më i zënë me punë në univers. Kam në dorë një roman, ndoshta më të rëndësishmin e karrierës sime deri tash, dhe niset nga Dibra për të prekur shumë kohëra e disa kontinente. Kam të sigurt një vëllim të ri poetik, të shtatin në radhë...

- Çfarë do iu thoshit të rinjve dibranë që aspirojnë të ndjekin hapat tuaj?

- Të lexojnë: Lexoni, lexoni, lexoni! Ky (dhuntia e krijimit letrar) nuk është zanat, por *një e dhënë*. Nuk është profesion që mësohet, por është *dërgesë* "nga Lart". Sapo ta keni nuhatur e të keni krijuar bindje se *e keni* këtë, vihuni menjëherë punës, mos humbni kohën kot: lexoni, lexoni, lexoni. Për të shkruar, mos u merakosni: nuk do të jeni *ju* që shkruani: ju vetëm do të mbushni fletët... dikton Tjetërkush...

Dibra është realisht një zonë provinciale, pavarësisht potencialit të saj të rrallë bujqësor, blegtoral e frutikultural, sikundërse është edhe një zonë e pasur me minerale nga kromi deri tek gjipsi, pa folur për resurset turistike. Por këto margaritarë të Dibrës janë rraposur në baltë, pa Rrugën e Arbrit, e cila do të thotë Treg, Dinamizëm teknologjik, Turizëm, Kulturë, Zhvillim, rrjedhimisht - Mirëqenie. Atëherë do ta shohim nëse është apo jo Dibra zonë provinciale. Provincialiteti ekziston vetëm në mendje, jo në hapësirat potenciale të Dibrës.

Nëpërmjet këtij financimi synohet zgjidhja përfundimtare e furnizimit me ujë të pijshëm të zonës, si dhe sigurimi i një shërbimi të qëndrueshëm dhe financiarisht të përballueshëm për konsumatorët. Afati i zbatimit të punimeve është 18 muaj.

Marrëveshje për furnizimin me ujë të Peshkopisë me Unicredit Bank Austria

Prefekti i qarkut Dibër, z. Melaim Damzi falenderoi qeverinë austriake për këtë donacion dhe u shpreh se: "Kjo është një nismë për Dibrën dhe besoj se nuk do të jetë as e para dhe as e fundit, e cila do të vazhdojë të tërheqë projekte të tjera njëra pas tjetrës. Falenderoj edhe njëherë të gjithë pjesëmarrësit, faleminderit për ndihmën".

Në mjediset e Ministrisë së Financave më 19 maj 2014, u nënshkrua marrëveshja e Kredisë së Eksportit që do të sigurojë financimin e projektit të furnizimit me ujë të qytetit të Peshkopisë, me një vlerë prej 4 milionë euro.

Pala shqiptare merr përsipër kostot lokale, kurse projekti do të dorëzohet nga austriakët krejtësisht i përfunduar, ndërtuar dhe gati për tu implementuar, ose ndryshe me "çelësa në dorë".

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes, morrën pjesë Ministri i Financave, z.Shkëlqim Cani, ambasadori i Republikës së Austrisë në Tiranës, z. Thomas Schnöll, zëvendësministri i Transportit dhe Infrastrukturës, z.Ylli Manjani, z. Gerd Rode, senior manager i UniCredit Bank Austria dhe prefekti i Qarkut Dibër, Melaim Damzi.

Ministri i Financave z.Shkëlqim Cani u shpreh pas nënshkrimit se marrëveshja e Kredisë së Eksportit, që u nënshkrua me Unicredit Bank Austria, mbështetet në Marrëveshjen e dytë të Bashkëpunimit financiar ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Austrisë, nëpërmjet së cilës Qeveria Austriake vë në dispozicion të Qeverisë Shqiptare kredi të buta për financimin e projekteve prioritare për zhvillimin e vendit.

Kjo marrëveshje përkon një ditë para vizitës në Tiranë të presidentit të Austrisë, Heinz Fischer, nga ky parashikohet të zhvillohet Forumi Ekonomik mes dy vendeve.

Ndërsa ambasadori austriak në Tiranë, z. Thomas Schnöll u shpreh pas ceremonisë se: "Më lejoni të shpreh lumturinë time të madhe që bisedimet dhe negociatat me Ministrinë e Financave prodhuan një rezultat të kënaqshëm sot, duke firmosur marrëveshjen e kredisë së butë për financimin e Projektit të Furnizimit me ujë të Peshkopisë. Shpreh mirënjohjen time për mbarëvajtjen e negociatave dhe vendim-marrjes lidhur me këtë projekt dhe falenderoj Ministritë Shqipëtare të përfshira në këtë transaksion".

Përfaqësuesi i UniCredit Bank Austria, z. Gerd Rose, u shpreh: "Së pari më lejoni t'ju shpreh gëzimin tim për arritjen e përfundimit të kësaj kontrate në ditën e sotme. Furnizimi me ujë është një nga elementet më kryesorë në zhvillimin tonë dhe të Shqipërisë, përsa i përket kredive të buta, por dhe për Agjencinë e Zhvillimit Austriak (ADA – Austrian Development Agency). Projekti i furnizimit me ujë në komunitetin tuaj është shumë i rëndësishëm edhe në kuptimin e një projekti të qëndrueshëm, e ne gjithnjë përpiqemi që të implementojmë projekte të qëndrueshme në periudhën afat-gjatë. Unë mendoj se kjo është e rëndësishme për vendin dhe ne përpiqemi gjithmonë që të jemi në linjë me standardet europiane, pasi ne duam të mbështesim vendin tuaj në rrugën drejt Bashkimit Europian. Falenderoj të gjithë pjesëmarrësit, Bankën Austria UniCredit, si dhe uroj e falenderoj dhe njëherë Ministrin".

Prefekti i qarkut Dibër, z. Melaim Damzi falenderoi qeverinë austriake për këtë donacion dhe u shpreh se: "Kjo është një nismë për Dibrën dhe besoj se nuk do të jetë as e para dhe as e fundit, e cila do të vazhdojë të tërheqë projekte të tjera njëra pas tjetrës. Falenderoj edhe njëherë të gjithë pjesëmarrësit, faleminderit për ndihmën".

Në periudhën 2003-2008 janë kryer rehabilitime të pjesshme në rrjetin shpërdarës të ujësjellësit të qytetit të Peshkopisë. Nëpërmjet këtij financimi synohet zgjidhja përfundimtare e furnizimit me ujë të pijshëm të zonës, si dhe sigurimi i një shërbimi të qëndrueshëm dhe financiarisht të përballueshëm për konsumatorët. Afati i zbatimit të punimeve është 18 muaj. *(Rr.A)*

Ambasadorët e BE përuruan projektin ndërkufitar për dy Dibrat

Shtigjet turistike për këmbësorë që sjellin zhvillim

Më datë 13 maj 2014 gjashtë ambasadorë të shteteve të BE-së të udhëhequr nga Aivo Orav me seli në Shkup, vunë gurëthemelin për ndërtimin e shtigjeve turistike në fshatin Banisht ku ndodhet edhe Banja e Banishtit.

Në këtë përurim mori pjesë edhe Ruzhdi Lata, kryetar i komunës Dibër e Madhe, përfaqësues të OJQ-ve dhe të ftuar tjerë. Ky projekt përfshin ndërtimin e shtigjeve turistike për këmbësorë në dy anët e kufirit në Maqedoni dhe Shqipëri me nga 17 kilometra në secilën anë të kufirit.

Ky projekt ka për qëllim të zhvillojë turizmin malor dhe fushor, duke u ndihmuar banorëve të dy anëve të kufirit zhvillim më të shpejtë dhe të mira financiare. Njëherit kjo është dëshmi se kemi ardhur këtu që tu përkrahim në rrugën për në Evropë.BE pret që shtetet e Ballkanit Perëndimor ti plotësojnë kushtet për tu integruar në BE, sepse këto shtete kanë nevojë të jenë pjesë e BE-së. Me këto projekte Maqedonia dhe Shqipëria faktikisht mbështeten për një zhvillim sa më të shpejtë. Maqedonia dhe Shqipëria po punojnë shumë për tu integruar ne BE, dhe shpresoj se së shpejti kjo edhe do të ndodhë", tha Ambasadori Orev.

Ruzhdi Lata, kryetari i komunës Dibër e Madhe, tha se, "Ky projekt do të mundësojë zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Para disa dekadave as dhe që mund ta kthenim kokën kah ana tjetër e kufirit. Banorët e kësaj zone i përjetuan tmerret e sistemit të kaluar, ndërsa tani mburren me praninë e ambasadorëve të BE që kanë ardhur për vizitë në Dibër dhe rrethinë. Ne e duam Evropën për dy shkaqe. E para sepse ajo garanton një jetë më të mirë, dhe e dyta sepse ajo njëkohësisht garanton edhe një siguri të plotë. Dibra ka resurse të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit dhe prania e jonë sot këtu tregon se banorët e këtushëm dëshirojnë të jenë në BE," tha Lata.

Ruzhdi Lata, kryetari i komunës Dibër e Madhe, tha se, "Ky projekt do të mundësojë zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Para disa dekadave as që mund ta kthenim kokën kah ana tjetër e kufirit.

Euroambasadori Orav dhe Lata vunë gurëthemelin e ndërtimit të këtyre shtigjeve turistike për këmbësorë.

Ky projekt ndërkufitar do të kushtojë 132 mijë euro. Prej tyre BE do të financojë 112 mijë euro ndërsa pjesën tjetër do ta financojë Ministria e Transporteve dhe Lidhjeve.

Rexhep TORTE

vendimi

Ky projektligj është rezultat i një pune të bërë gjatë këtyre muajve nga Drejtoria e Minierave së bashku me strukturat e tjera, por mbi të gjitha edhe një eksperiencë e krijuar gjatë këtyre muajve për të parë problematikat kryesore në këtë sektor.

Gjiknuri: Ndryshimet në ligjin minerar, forcojnë rregullin dhe zgjidhin gangrenën e Bulqizës

Ndryshon ligji për sektorin minerar. Opinioni i qeverisë shqiptare është se shfrytëzimi i pasurive natyrore përmes industrive nxjerrëse nuk ka dhënë impaktin e duhur në ekonominë e vendit për shkak të politikave jotransparente në dhënien e lejeve të shfrytëzimit nga ana e shtetit dhe shkallës së lartë të informalitetit. Krahas rritjes së kontrollit, për të luftuar kaosin e krijuar në miniera, ministri i Energjisë Damian Gjiknuri prezantoi dje për grupet e interesit draftin e projektligjit të ri që po përgatitet për minierat, ku u shpreh se qeveria.

"Sektori minerar do të trajtohet me përparësi, pasi është një sektor që ka vuajtur nga fenomenet ilegale, ku ka ende subjekte të palicensuara që vazhdojnë të punojnë. Këto subjekte do të ndalohen me ligj", tha ai.

Gjiknuri u shpreh se me ligjin e ri do të përcaktohen qartë zonat minerare për dhënien e lejeve të shfrytëzimit të minierave, si dhe do të ketë edhe rregullime për nënkontraktorët.

"S'mund të ketë më një ekspert apo inxhinier me 20 apo 30 leje". Ligji i ri, tha ai, parashikon disa kërkesa për personel të kualifikuar teknik gjatë kohëzgjatjes së lejes minerare.

Sipas tij, do të mbyllen minierat e vjetra të braktisura. "Subjektet duhet të marrin masa, s'mund të ketë më galeri në Bulqizë", shtoi ai.

NDRYSHIMET E PROPOZUARA

Ndryshimet e propozuara në projektligj synojnë të saktësojnë konceptin e servitutit ligjor në pronën fqinje me zonën minerare, duke përcaktuar se servituti ligjor i detyrueshëm është i aplikueshëm vetëm për të drejtën e kalimit në sipërfaqen në pronën fqinje me zonën minerare. Referuar parashikimit aktual, mjaft zotërues të lejeve minerare, në kundërshtim të hapur me planin e investimeve, pas përfitimit të lejeve minerare, kanë kërkuar servitutin e detyrueshëm mbi galeritë nëntokësore të hapura apo të zotëruara nga subjekte të tjera minerare.

Kjo situatë sjell një mungesë kontrolli të veprimtarisë së këtyre subjekteve, të cilat shpesh si rezultat i aksesit që kanë në galeritë e subjekteve të tjera, mund të cënojnë rregullat e sigurimit teknik apo shfrytëzojnë edhe zona për të cilat nuk janë licensuar, por që i përkasin zotëruesit të galerisë nëntokësore.

Nga verifikimi i situatës aktuale rezulton se mjaft aktivitete të veprimtarisë minerare duke përfshirë edhe shfrytëzimin, janë dhënë me nënkontraktim tek subjekte të tjera. Sa më sipër, në funksion të qëllimit të kontrollit e respektimit të kushteve të sigurisë teknike, del si nevojë formalizimi i kësaj situate të krijuar ndër vite e në këtë kuptim propozohet që të përfshihet si parashikim në ligj, e drejta e nënkontraktimit dhe kushtet kryesore të miratimit të saj.

Ndryshime të tjera kanë të bëjë me përfshirjen në kushtet e revokimit të lejeve minerare, edhe të kushtit kur leja ka mbivendosje me një leje minerare të dhënë më parë. (Shqiptarja.com)

FJALA E MINISTRIT TË ENERGJISË DHE INDUSTRISË Z. DAMIAN GJIKNURI NË TAKIMIN E MBAJTUR ME GRUPET E INTERESIT, KU U DISKUTUA RRETH NDRYSHIMEVE NË LIGJIN MINERAR

Qëllimi i këtij takimi është që të shkëmbejmë disa ide në lidhje me projektligjin e ri, me amendimet që po i bëjmë ligjit të sektorit minerar. Është një sektor shumë i rëndësishëm për ekonominë shqiptare, por nuk kemi pse ta fshehim faktin se ky sektor ka qenë problematik për mënyrën si u fragmentua dhe si u zhvillua. Pavarësisht faktit se potencialet kanë qenë të mëdha, nuk mund ta fshehim se ka patur politika që do t'i quaja të gabuara, shpesh herë nisur edhe nga interesa të vogla, që e fragmentuan këtë sektor dhe e bënë që të jetë më i vështirë për t'u kontrolluar. Bënë që sektori gjithashtu të ishte shpesh herë burim evazioni fiskal e mbi të gjitha nuk siguron një rritje të qëndrueshme të tij karshi investimeve serioze. Përveç shumë pak koncesionarëve, që kanë marrë përsipër zona të mëdha por që edhe ata mund të kenë pasur problemet e tyre, në disa raste lejet minerare janë kthyer si ato ngastrat e tokës të cilat secili i zë dhe i shfrytëzon sipas mënyrës së tij e shteti shpesh ka humbur dhe kontrollin.

Që me ardhjen e qeverisë së re, në muajt e parë ka nisur puna për të vënë nën kontroll më të plotë këtë sektor. Kemi realizuar një pjesë të veprimtarisë, që them se ka ndikuar në forcimin e disiplinës, por nuk jemi plotësisht të kënaqur. Kemi revokuar leje të cilat mbeteshin atje, nuk paguanin as detyrimet ndaj shtetit. Kemi ushtruar kontrolle për sigurinë e jetës së minatorëve, sepse ka qenë një problem shumë i madh dhe po vazhdojmë edhe me shpalljen e garave të reja në sektorin minerar. Ne jemi të vetëdijshëm se është një sektor që ka potencial dhe shumë njerëz të ardhurat e tyre ekonomike dhe shpresat i mbajnë tek ky sektor.

Ky projektligj është rezultat i një pune të bërë gjatë këtyre muajve nga Drejtoria e Minierave së bashku me strukturat e tjera, por mbi të gjitha edhe një eksperiencë e krijuar gjatë këtyre muajve për të parë problematikat kryesore në këtë sektor, nisur edhe nga komunikimet e vazhdueshme me të gjithë aktorët e interesuar, siç jeni ju të gjithë këtu, për të adresuar ato çështje që janë më të mprehta. Kuptohet ky projekt ka nevojë për përmirësime, nuk është gjëja më e mirë e mundshme. Nuk pretendoj se gjërat këtu janë perfekte dhe pikërisht ky komunikim i vlen konsultimeve për të dhënë mendime në lidhje më këtë draft që ka paraqitur Ministria, i cili nuk është draft final, por që mendojmë do të adresojmë disa çështje të nevojshme.

Unë, këtu mund të përmend disa pika që kanë nevojë të nënvizohen, siç janë rregullimi i disa përkufizimeve në ligjin e sektorit minerar, pra përkufizime që i vlejnë zbatimit më të mirë të ligjit.

Ndryshimet e mundshme të sipërfaqeve të zonave minerare. Një proces i cili ka notuar në zonën gri mes ligjit dhe mungesës së ligjit e që tanimë duhet të normohet pasi ka qenë një fenomen jo i rregulluar e që shpeshherë ka qenë edhe pre e abuzimeve.

Parashikohet gjithashtu përcaktimi i zonave minerare të cilat do të licensohen për aktivitet minerar, kërkim - zbulim dhe shfrytëzimi. Ndryshim i zërit kadastral për sipërfaqe të licensuara të aktivitetit minerar. Kemi një ndërhyrje që ka të bëjë me garancitë financiare për investimet. Ky amendim parashikon çlirimin e subjekteve nga pagesa e garancisë pas përfundimit të periudhës së investimit.

Parashikohet saktësimi i karrierave minerare për qëllime publike, pra për ato vepra publike që kanë nevojë. Nuk kanë pse të mbeten peng veprat publike për shkak të lojërave që bëhen me leje minerare për gurore apo shfrytëzime të tjera të komunave apo të interesave të vogla, që shpeshherë janë kthyer si një taksë gjobvënie për shumë investime të mëdha publike.

Drafti bën futjen e konceptit të rehabilitimit progresiv të mjedisit. Kuptohet që aktiviteti minerar ka pasojat e tij në mjedis po shpeshherë ka ndodhur në Shqipëri që mjedisi është anashkaluar fare dhe është parë vetëm aspekti i shfrytëzimit minerar. Ka patur një problem të madh me minierat e braktisura, me minierat e vjetra, që kanë mbaruar punë dhe janë kthyer në një burim rreziku për jetë njerëzish dhe që realisht është një fenomen që kjo qeveri po e adreson. Për herë të pare, unë kam edhe kënaqësinë ta them për ata që nuk e dinë, ne këtë vit kemi alokuar fonde dhe po fillojmë një pjesë të mbylljes së minierave të vjetra, të braktisura, që deri vitet e kaluara merrnin jetë njerëzish dhe që për vite të tëra askush nuk vuri dorë. Qeveria shqiptare ka alokuar një fond dhe po punohet që të fillojë procesi i mbylljes së këtyre minierave.

Janë futur disa kërkesa për personelin e kualifikuar teknik gjatë kohëzgjatjes së lejes. Dihet ai fenomeni që ndodh tashmë, mbase edhe për mungesë kapacitetesh teknike, por shpeshherë vëmë re që një ekspert është në 20-30 leje. Kjo nuk është normale dhe duhet të rishikohet hapësira ligjore. Nuk e di nëse e realizojmë plotësisht me këtë ligj, por duhet parë, sepse s'mund të jetë vetëm një inxhinier që mban përsipër 10-15 leje. Është një fenomen shumë shqetësues, që patjetër e pëson cilësia, e pëson standardi dhe kjo gjë është e pafalshme.

Kemi bërë disa rregullime në lidhje me nënkontraktorët, me transferimin e licencave dhe elementë të tjerë që edhe këto kanë qenë problem, kanë qenë gjëra të parregulluara me ligj, dhe që besoj është rasti që meqenëse po bëjmë ndryshimet e ligjit tek kjo pjesë të sanksionohet.

Është përcaktuar edhe një çështje tjetër që është delicate dhe shumë e rëndësishme në lidhje me fenomenet e servituteteve nëntokësore. Po them se një pjesë e gangrenës së Bulqizës lidhet me këtë fenomen, me vendime gjykatash të cilat kanë dhënë detyrime për servitut, por njëkohësisht janë kthyer edhe si hapësira për të abuzuar, ku asnjë nuk mban më përgjegjësi e që më pas rrisin rrezikshmërinë në atë zonë. Kjo ka nevojë për një rregullim tepër të fortë dhe unë them që propozimi ynë është që ky servitut nëntokësorë të ndalohet. Do t'i lëmë kohë subjekteve të marrin masat për tu përshtatur, por nuk mund të ketë në galeri situata siç ka ndodhur në Bulqizë ku me vendime gjykatash kanë arritur të marrin servitute dhe janë kthyer në një fenomen jashtëzakonisht problematik për zonën.

Këto janë disa nga ndryshimet. Më të detajuara do t'i paraqesë drejtoria përkatëse, por unë mendoj se është një fillim i mirë edhe për të hapur dialogun mes nesh, për të dëgjuar sugjerimet tuaja. Është krejt normal procesi i komunikimit me aktorët e interesuar pasi qeveria shqiptare, sektorin minerar e sheh me shumë përparësi. Sektori minerar ka vuajtur si shumë sektorë të tjerë edhe nga fenomenet ilegale. Shpeshherë ne problemet i kemi me mungesën e kontrollit

> Interesi për minierat është i lartë, kompani serioze kanë ardhur nga shumë vende të botës, por duan siguri në investim, mbi të gjitha duan një transparencë se çfarë bëhet me lejet, kush i ka, të mos jenë pre e veprimeve nganjëherë arbitrare, apo fenomeneve të tjera që dalin që lejet janë me mbivendosje apo probleme të tilla si këto.

mbi territorin, çka ka bërë që fatkeqësisht subjekte të palicencuara fare të vazhdojnë të punojnë, dhe kjo kthehet një barrë për ato subjekte të cilat janë të licensuara dhe me të drejtë kërkojnë nga shteti aplikimin e ligjit dhe ndalimin e këtij aktiviteti. Por, kjo automatikisht sjell gjithashtu humbje dhe mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit, sepse këto aktivitete ilegale, të ndihmuara shpesh edhe nga subjekte të licensuara të cilat ua blejnë këto materiale minerale, ka bërë që të ardhurat të ndikojnë direkt në bilancin e buxhetit. Ky është një fenomen që ka qenë dhe është problematik, ne po e luftojmë por do të dojë kohën e vet, do të dojë edhe bashkëpunimin e sektorit, do të dojë mbi të gjitha bashkëpunimin e atyre aktorëve që janë legjitim. Nuk ka më mirë sesa një aktor minerar, pra një operator i licensuar që të bashkëpunojë me organet shtetërore dhe të mos bëhet ndihmës i këtyre fenomeneve ilegale, duke u blerë mallin atyre. Ndryshe, masat do të bien edhe mbi operatorët seriozë dhe ndikimi do të jetë shumë i rëndë. Minierat në Shqipëri kanë të ardhme. Në vend kanë filluar të vijnë edhe kompani serioze shumë të mëdha, por ajo që e ka penguar rritjen e këtij sektori në ato nivele që të gjithë e presim, përveç faktit që është një sektor që është vulnerabël nga bursa dhe nga çmimet ndërkombëtare të mineraleve, janë pikërisht fenomenet e korrupsionit. Ne prandaj, po bëjmë edhe një regjistër transparent koncesionesh në mënyrë që të dihet saktësisht çfarë përfaqësojnë lejet, cilat janë ato. E kemi filluar dhe shumë shpejt do të përfundojmë programimin e regjistrit për koncesionet e hidrocentralet këtë vit, e më pas për ta shtrirë tek lejet minerare, të cilat janë më të shumta, shpeshherë problematike, me mbivendosje, me shumë fenomene të tilla.

Është shumë e nevojshme që këto gjëra të jenë transparente në mënyrë që çdo lloj investitori t'i dijë sepse këtu kanë ndodhur fenomene të çuditshme. Leja i përkiste dikujt dhe mbi atë leje është dhënë një tjetër, apo fenomene të tjera që pastaj kthehen në konflikte ligjore, konflikte shpeshherë sociale. Këto gjëra nuk duhet të ndodhin më dhe ne për herë të parë po garantojmë transparencën. Do të jetë një punë voluminoze, kemi gjetur edhe mbështetje financiare nga partnerët ndërkombëtarë. BERZH-i ka qenë i gatshëm, shpresojmë që ta vazhdojmë në vitet në vijim, në mënyrë që ky regjistër të jetë transparent, të jetë i konsultueshëm për këdo. Kjo patjetër sjell siguri edhe për investitorin.

Interesi për minierat është i lartë, kompani serioze kanë ardhur nga shumë vende të botës, por ajo që duan është siguria e investimit, mbi të gjitha duan një transparencë se çfarë bëhet me lejet, kush i ka, të mos jenë pre e veprimeve nganjëherë arbitrare, apo fenomeneve të tjera që dalin që lejet janë me mbivendosje apo probleme të tilla si këto.

Është në fokus të politikës sonë, them se ky ligj është një bazë e mirë për t'i përmirësuar disa gjëra në sektor, por njëkohësisht i takon organeve përgjegjëse shtetërore, RISHM-it përsa i përket sigurisë së punës, drejtorisë në Ministri me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore që të vazhdojnë monitorimin në terren për të parandaluar të gjithë ato fenomene negative që thamë.

Ky është një diskutim i hapur, ky është një diskutim që ja vlen ta bëni ju mbi të gjitha nga ana teknike, me të gjithë përfaqësuesit që kemi këtu. Ju siguroj që të gjitha mendimet tuaja do të vlerësohen. Është tamam një tavolinë pune ku do të marrim mendimin e aktorëve për të gjetur atë që është më e mirë, që i vlen zhvillimit të sektorit, interesave publikë, por edhe interesave private tuajat që ushtroni aktivitet në këtë fushë. Ligji do të shoqërohet më pas me aktet nënligjore e që patjetër edhe ju do të jeni pjesë e konsultimit.

"Shtëpia muze kushtuar Ataturkut është e ndërtuar në bashkëpunim mes Ministrisë së Kulturës dhe Agjencisë turke për bashkëpunim dhe koordinim - TIKA.

Rama ,Thaçi dhe Ahmeti qëndruan në **Dibër të Madhe**

Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë, Hashim Thaçi, kryeministri i Kosovës dhe Ali Ahmet kryetar i BDI-së të shtunën, më datë 10 maj qëndruan në Dibër të Madhe.

Edi Rama në faqen oficiale e tij të Fejzbukut dhe Tëiter thekson se, " vizita e tyre në qytetin e Dibrës së Madhe ka qenë me rastin e përvjetorit të themelimit të Ordinancës për diagnostifikimin e kancerit në gji te femrat që funksionon në kuadër të Fondacionit ,,Florina Rusi – Marke,, e themeluar nga familja Rusi.

Detaje të tjera nuk bëhen të ditur nga takimi i Ramës, Thaçit dhe Ahmetit, me që edhe vizita ka kaluar pa pjesëmarjen e mediave.

Merret vesh se mysafirët në Dibër ishin të ftuar nga Turhan Rusi, kryefamiljari i familjes Rusi, që janë biznesmenë të dalluar dibrano-amerikanë në SHBA.

Kjo familje për nder të vajzës së tyre të ndjerë Florina ka hapur në Dibër të Madhe ordinancën për diagnostifikimin e kancerit në gji te femrat, ku bëhen kontrolle falas me aparate te sofistikuara.

Rexhep TORTE

Në Koxhaxhik afër Dibrës së Madhe u përurua shtëpia muze e familjes të ataturkut

Në fshatin Koxhaxhik që ndodhet në komunën Qendër Zhupë që ndodhet përbri Dibrës së Madhe më 18 maj 2014 në mënyrë solemne u hap shtëpia përmendore e Ali Riza Efendiut, babait të Mustafa Kemal Ataturkut. Shiritin e përurimit të kësaj shtëpie e prenë zëvendëskryeministri i Turqisë Emrullah Ishler dhe kryetari i Maqedonisë Gjorgje Ivanov. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm edhe funksionarë tjerë nga Turqia dhe Maqedonia.

Gjorgje Ivanov, kryetar i Maqedonisë me këtë rast tha se," Maqedonia dhe Turqia gjithmonë kanë patur bashkëpunim ndërshtetëror dhe marrdhënie të mira diplomatik. Tani shumë turistë të huaj dhe nga vendi do ta vizitojnë këtë shtëpi muze. Jam i bindur se banorët e Maqedonisë nuk do ta harojnë mbështetjen dhe solidaritetin që Republika e Turqisë e tregoi për ne që në ditët e parë të pavarsisë së shtetit tonë. Kjo dëshmon traditën e bashkëpunimit tonë në të gjitha sferat. Në ekonomi, kulturë dhe në fusha të tjera.Bashkësia etnike turke në Maqedoni dhe mërgimtarët nga Maqedonia në Turqi paraqesin një urë të fuqishme lidhëse mes dy shteteve tona që kanë marrdhënie shumë të mira", theksoi Ivanov. Emrullah Ishler,zëvendës kryeministri i Turqisë, theksoi se," Kjo ditë është ditë e madhe dhe historike. Hapja e shtëpisë muze të familjes të kreatorit të turqis moderne Mustafa Kemal Atataurk ka një vlerë të madhe. Ai shtoi se agjensioni turk TIKA ka luajtur rol të madh në ndërtimin të këtij muzeu që u realizua së bashku me përfaqësuesit e Qeverisë të Maqedonisë. Turqit në Maqedoni janë shtetas lojal të Maqedonisë dhe ashtu duhet të jenë gjithmonë. Turqia dhe Maqedonia kanë marrdhënie shumë të mira", theksoi Ishler.

Elizabeta Mileva- Kamçeva, ministre e kulturës, tha se "Shtëpia muze kushtuar Ataturkut është e ndërtuar në bashkëpunim mes Ministrisë së Kulturës dhe Agjencisë turke për bashkëpunim dhe koordinim - TIKA. Projekti i përbashkët përfshin edhe konservim dhe restaurim të mureve të vjetra ekzistuese në përdhesën e shtëpisë, si dhe ndërtimin e rrugës nga qendra në fshat deri në Shtëpinë muze. Në muze janë prezentuar tërë elementet karakteristike të shtëpisë ku ka lindur babai i Ataturkut, Ali Riza.

Vlladimir Peshevski, Zv/kryeministri i Maqedonisë, u shpreh se, "Maqedonia dhe Turqia gjithmonë kanë patur marrdhënie të shkëlqyeshme. Ndërtimi i një muzeu kushtuar Ataturkut të madh është edhe një dëshmi për mardhëniet shumë të mira mes dy shteteve. Përndyshe familja e Mustafa Kemal Ataturkut, sipas njohurive të historianëve dhe arkeologëve nga Maqedonia dhe Turqia, ka jetuar në Koxhaxhik në gjysmën e dytë të shekullit XIX", tha Peshevski.

Foto: Atli Dema

Në fshatin Koxhaxhik që ndodhet në komunën Qendër Zhupë që ndodhet përbri Dibrës së Madhe më 18 maj 2014 në mënyrë solemne u hap shtëpia përmendore e Ali Riza Efendiut, babait të Mustafa Kemal Ataturkut.

Kjo shtëpi muze ka shumë eksponate të familjes së Ataturkut nga ajo periudhë.

Ky manifestim u ndoq nga një numër i madh i banorëve të kësaj ane dhe nga një program i pasur kulturor.

Rexhep TORTE

Znj. Nikolla u shpreh se: “Përvoja jetësore i ka bindur gollobordasit brez pas brezi se puna dhe dija janë binom i pandarë që sjell sukses dhe siguri për jetën.

100 Vjetori *i themelimit të shkollës së Trebishtit*

Ditën e shtunë, datë 17.05.2014, Ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Lindita Nikolla, ishte e pranishme në festimin e 100 vjetorit të themelimit të shkollës 9-vjeçare “10 Dëshmorët” të Trebishtit, Gollobordë.

Nga **Lindita NIKOLLA**
Ministre e Arsimit dhe Sportit

Të dashur mësues dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare “10 Dëshmorët”, Trebisht!

Të dashur të pranishëm dhe të ftuar të tjerë! Ndihem e lumtur sot, në këtë ditë të madhe feste për qytetarët e Trebishtit, por edhe për krahinën e Gollobordës dhe më gjerë, që jam bashkë me ju për të kujtuar dhe përjetuar bashkëristë një ngjarje me rëndësi historike për zhvillimin e arsimit në qarkun e Dibrës, hapjen e shkollës shqipe në prill 1914 në Trebisht, në të njëjtën kohë me simotrën e saj, shkollën shqipe në Peshkopi.

Vendimi i Qeverisë së Vlorës për hapjen e këtyrë dy shkollave nuk ishte i rastësishëm. Duke qenë dy nga kryqendrat më të populluara në qarkun e Dibrës, prej kohësh kishin filluar të shquheshin në gjallërimin e lëvizjes patriotike, në kuadër të shpërbërjes së perandorisë Osmane. Ndërkaq, ndikim të posaçëm pati organizimi i Kongresit të njohur të Dibrës, mbajtur më 23 korrik 1909, dhe sidomos shpallja e pavarësisë së Shqipërisë më 1912, ngjarje madhore këto, të cilët vunë në rend të ditës zgjimin e vetëdijes kombëtare, ndër të tjera edhe me përhapjen e ideve iluministe të Rilindjes, sipas devizës Naimiane “Dhe drita e diturisë përpara do të na shpjerë”.

Prej shumë kohësh, populli i Trebishtit e ka bërë traditë që të përkujtojë këtë datë të shënuar në çdo përvjetor, duke e bërë atë pjesë të pandarë të ndërgjegjes historike, kulturore dhe arsimore.

Këtë vit, që kjo ngjarje përkon me 100-vjetorin e hapjes së kësaj shkolle, na jep rastin që, nga lartësia njëshekullore, të zgjatim vështrimin 10 dekada më parë, në mugëtirën e fillimit të shekullit XX, kur nisi rrugëtimin shkolla e parë shqipe në Trebishtin e Gollobordës.

Kjo shkollë, përmes sakrificash e pengesash të shumta, u rrit dhe u zhvillua me mbështetjen e pakursyer të brezave të mësuesve të përkushtuar, nxënësve shembullorë të etur për dije dhe kulturë dhe të prindërve të devotshëm.

Të shumtë janë protagonistët që meritojnë nderim të veçantë për atë që ditën dhe arritën të bëjnë. Mes tyre nuk janë të paktë edhe mësuesit e spikatur, që me kontributin e tyre u bënë përfaqësues të brezit të mësuesve, të kohës së tyre.

Të tillë janë: Ramiz Qatja, mësuesi i parë i shkollës së Trebishtit, mësuesit e tjerë dibranë: Ramadan Sefedini, Aqif e Nazmije Pasholli, Xhevat Sadiku, Selim Alliu “Mësues i Popullit”, Islam Hoxha etj.

Histori të veçantë përbën kontributi i normalistëve nga qytete të ndryshme të vendit, përfshirë këtu dy normalistët nga fshati Trebisht, Mehmet Çadri dhe Mustafa Shahinaj, të cilët pjesën më të madhe të veprimtarisë së tyre arsimore ia kushtuan zhvillimit dhe konsolidimit të shkollës së Trebishtit.

Me njohuritë e gjera që fituan si në fushën e mësimdhënës dhe drejtimit në shkollat e qarkut të Dibrës, ata e shndërruan shkollën e Trebishtit në një qendër të shkëmbimit të përvojës pedagogjike për mësuesit e rinj që patën rastin të shërbejnë në këtë shkollë.

Prandaj mësuesit, komuniteti dhe ishnxënësit e shkollës së Trebishtit nuk kanë kursyer mirënjohjen e tyre për përkushtimin e këtyre mësuesve shembullorë.

Qëndrimi që ka mbajtur populli i Trebishtit në vite dhe dekada ndaj shkollës dhe gjuhës shqipe, me betejat e fituara për zhdukjen e analfabetizmit, zgjerimin e rrjetit të shkollave, zbatimin e arsimit të detyruar, masivizimin e arsimit 8 e 9-vjeçar, si dhe rritjen e cilësisë në shkolla, e ka konfirmuar gjithnjë e më shumë Trebishtin dhe Gollobordën si një nga zonat më arsimdashëse.

Përvoja jetësore i ka bindur gollobordasit brez pas brezi se puna dhe dija janë binom i pandarë që sjell sukses dhe siguri në jetë.

Shkolla mbetet tempulli më i lakmuar dhe më i frekuentuar, ku fëmijët prekin ëndrrat e tyre për të ardhmen. Për më tepër, këto ëndrra bëhen akoma më të bukura, kur zenë fill në një shkollë të re, plot dritë e jetë, që po inagurohet për nxënësit e Trebishtit në këtë 100-vjetor.

Progresi për një të ardhme më të sigurtë ka nevojë për idetë dhe energjitë e të rinjve dhe të rejave. Ne presim shumë edhe nga të rinjtë e të rejat e zonës së Gollobordës. Këto energji që shkolla gjeneron do të jenë fokusi i gjithë punës sonë në arsimimin e brezave të rinj.

Sot ne vetëm sa dëshirojmë të shprehim urimin e zemrës për festimin e përvjetoreve të tjerë më të bukur dhe më të gëzuar, për këtë shkollë njëshekullore, vatër drite, burim diturie dhe prosperiteti.

Aty ku u ndez **flaka e diturisë** *120 vjet më parë*

Nga **Shaqir SKARRA**

Udhëtimet në pranverë janë gjithmonë të bukura e sidomos në maj, ku pemët e lulet kanë çelur e gjelbërimi është i pranishëm kudo, por këto udhëtime domosdo që janë më të bukura, më mbresëlënëse, kur nisesh drejt viseve të Dibrës, pasi të gjithëve na zgjohen kujtesat e fjetura të atyre grimcave që rrinë strukur mbuluar nën hirin e kohës, për t’u ndezur sërish sa herë fryn lehtë era e mallit për vendlindjen.

E këtë mëngjes të freskët maji udhëtojmë drejt Homeshit, një fshat ky nën hijen e maleve, që duket sikur pi ujë nga horizonti i ulët gati njësh me tokën.

E ky është një takim brezash me vetë kohën që ka rrjedhur në gjurmët e shkollës shqipe, hapur në këtë fshat njëqind e njëzet vjet më parë, në gjurmët dhe me shembullin e sakrificës së vetë rilindësve dibranë, që në kohëra janë djegur si qirinj për t’u bërë dritë brezave.

Këto realitete shpalosen përgjatë kësaj rruge e, për më tepër, sa të kalosh Urën e Çerenecit e të futesh në Shupenzë, ku përmes bukurive të rralla që shpalos ky mëngjes maji, çdo gjë këtu ka atmosferën e festës. Dhe ja tek po vijmë këtu edhe sot, në kërthizën e Shqipërisë, në Shupenzën e trimërive e të lavdisë.

S’ka më bukur që pikërisht në këtë peizazh kaq madhështor e festiv, midis qindra

historive e majë malesh, të ndezësh në përkujtim pas njëqind e njëzet vitesh pishtarin e dritës së diturisë. E në këtë nëntë maj të vitit 2014 ndodhemi në mes të katundit të Grykës së Vogël, Homeshit ku do të përkujtohet një nga ngjarjet më të shënuara të këtyre anëve,hapja e shkollës shqipe 120 vjet ma parë që ndezi ndër të parët flakën e diturisë, vepër kjo e patriotëve tanë të nderuar, që bënë realitet ëndrrën e rilindësve tanë.

Homeshi këtë mëngjes të bukur maji u gdhi në festë. Festë kishte dhe Shupenza, Boçeva, Zogje, Bllaca, Okshatina, Gjorica e Maqellara. Përmasat e kësaj feste i kaluan kufijtë e komunës Shupenzë se e një rëndësie të madhe ishte kjo festë.

Homeshi festonte 120 vjetorin e shkollës së parë shqipe, e hapur në vitin 1894, nën kujdesin direkt të Shaqir Dacit, mik i ngushtë i Said Najdenit, i cili, duke bashkëpunuar me patriotin e atdhetarin Mersim Dema, vendosën të hapnin një shkollë shqipe në Homesh, ku Mersimi do të kthente shtëpinë e tij në mjedise shkolle për fëmijët e Grykës së Vogël.

Homeshi, pra, këtë ditë të bukur të pranverës priti mes atmosferës së kësaj feste madhështore bijtë dhe bijat e saj që punojnë dhe jetojnë në gjithë Shqipërinë, nga Dibra në Gjirokastër e nga Shkodra në Vlorë, të cilët kishin ardhur për të festuar së bashku përvjetorin e 120-të të hapjes së shkollës së parë shqipe në Grykën e Vogël. Njëqind e njëzet vjet, nuk i thonë pak shkollë shqipe në një fshat si Homeshi.

Në Dibër kishte kohë që ishte përhapur flaka e dijes për arsim shqip dhe kjo falë atdhetarëve Josif Bageri e Said Najdeni. Miku e shoku i ngushtë i Said Najdenit ishte Shaqir Daci, i cili bëri të mundur të realizojë këtë ëndërr të kahershme, bëri Homeshin me shkollë shqipe.

Për të përjetuar dhe festuar këtë përvjetor jubilar ishin organizuar shumë veta individ por dhe institucione si: Drejtoria e Zyrës Arsimore Bulqizë, Komuna Shupenzë dhe Shoqata e Historianëve të Dibrës.

Dhe komuna Shupenzë e ka bërë traditë të bukur tashmë, duke përkujtuar përvjetorët e shkollave shqipe në zonë. Kështu u festua dhe 100 vjetori i shkollës shqipe në Bllacë, kështu edhe 120 vjetori i shkollës shqipe në Homesh. Por ai që është promotori i gjithë këtyre veprimtarive të mëdha historike pa dyshim që mbetet Zabit Lleshi.

(Vijon në faqen 10)

Një ditë e bukur, e pasur me veprimtari të shumta, mbylli me sukses festën e shkollës së Homeshit, e cila do të mbetet një kujtim i paharruar për banorët dhe vizitorët e shumtë të ardhur enkas...

Aty ku u ndez **flaka e diturisë** 120 vjet më parë

(Vijon nga faqja 9)

Me 9 maj 2014-të është festuar në fshatin Homesh të komunës Shupenzë, 120 vjetori i hapjes së shkollës së parë shqipe në këtë fshat me histori të pasur atdhetare të bijve të tij...

Pa nismën dhe iniciativën e tij nuk do të ishte përkujtuar as 100 vjetori i shkollës së Bllacës as dhe 120 vjetori i shkollës së Homeshit. Zabiti ka më shumë se një vit që përgatitet për këtë ditë e nga dita në ditë, nga muaji në muaj. Ai ka mbledhur fakte, dokumente, ngjarje, personazhe për këtë ditë të shënuar, duke i botuar në numrat e kaluar të gazetës "Rruga e Arbërit.

Nga grupi organizativ i kësaj feste, i përbërë nga drejtori i shkollës nëntëvjeçare Shupenzë zoti Arjan Kaja, mësueset Dhilhixhe Jella, Lavdie Manjani, Fisnik Manjani, Qausere Beqiri,Tahir Daci e Avni Mera ishte planifikuar, që pas sesionit jubilar kushtuar 120 vjetorit të shkollës së Homeshit, në qendër të Komunës Shupenzë të organizohej edhe një manifestim popullor dhe pikërisht në Homesh, aty ku 120 vjet më parë u hap e para shkollë shqipe.

Sesionin Jubilar, ku morën pjesë veteranë, mësues dhe mjaft të rinj e të reja, e hapi drejtoresha e Zyrës Arsimore , znj. Bedrie Manjani, e cila falenderoi për pjesëmarjen: Prefektin e Dibrës, z. Melaim Damzi, n/kKryetarin e Komunës Shupenzë, z. Gani Tomja, përfaqësuesin e Komunës Gjoricë, z.Kujtim Alla. Punimet vazhduan me ligjërimin e zotërinjve: Moisi Murra, Zabit Lleshi, Mehdi Dema, Mendu Dema, Baftjar Rusi, Shemsi Manjani, Bajram Xhafa (Doktor i Shkencave) dhe Osman Patria. Kumtesat evokonin historinë patriotike të fshatit Homesh, historinë 120 vjeçare të shkollës, përgatitjen e kuadrove në ndihmë të ekonomisë, gjallërimin e jetës kulturore e sportive. U fol edhe për klerikun Shaqir Tomja , si dhe për heroizmin e popullit të Homeshit në folklorin e Grykës së Vogël. Të pranishmit ndoqën me mjaft interes e vëmendje punimet e sesionit Jubilar për afro dy orë. Në këtë jubile të shkollës së Homeshit ishin ftuar shumë veta, njerëz që kishin kontribuar për arsimin dhe kulturën në Grykën e Vogël, por dhe personalitete të tjera qeveritare si nga Ministria e Arsimit, ashtu dhe deputetët e Qarkut Dibër, por të cilët nuk ishin të pranishëm.

Nga Shupenza, mësuesit dhe të ftuarit erdhën në Homesh. Atje u pritën nga një numër i konsiderueshëm i madh banorësh të fshatit që kishin ardhur qysh më parë, duke ndjekur disa aktivitete sportive e artistike, të organizuara nga shkolla 9-vjeçare Shupenzë me drejtor Arjan Kaja dhe mësuesi i Edukimit fizik Fatos Xh.Manjani. Mësuesi i shkollës "Qazim Turdiu" në Tiranë i dhuroi kësaj shkolle 12 komplete sportive dhe 12 topa për lojërat me dorë. Kapiteni i skuadrës së volejbollit të shkollës, Albert Kaci, mori kupën e fituesit në volejboll.

Nënkryetari i Komunës, pas përshëndetjes së tij në emër të komunës Shupenzë, i dhuroi përgjegjëses së shkollës, Lavdie Manjani, një kupë simbolike për këtë Jubile, pastaj i dha fjalën Prefektit të Qarkut Dibër, Melaim Damzi. Ai përshëndeti në emrin e deputetit të zonës zotit Përparim Spahiu, i cili për arsye pune nuk mundi të vinte në këtë aktivitet historik. Më poshtë prefekti foli për patriotizmin e Homeshit brez pas brezi, të cilët në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, asnjëherë nuk e ndanë luftën për çlirim, me kërkesat për shkollë e gjuhë shqipe. Nga Homeshi, - vazhdoi ai, kanë dalë 82 mësues, 32 oficerë karriere, 5 juristë, 9 agronomë, 8 inxhinierë, 8 mjekë, 2 gazetarë, etj. Bilanci i shkollës së Homeshit është i pasur me arritje e suksese. Uroj fitore të reja edhe më të mëdha!

Në fund u dha një koncert artistik mjaft i pasur, nga nxënësit e shkollës 9-vjeçare, përgatitur me shije e profesionalizëm nga mësueset Dhilhixhe Jella, Suzana Patria e Qausere Beqiri, të cilat meritoan falenderimet, përshëndetjet dhe duartrokitjet e të gjithë të pranishmëve.

Në bisedat e kësaj dite nuk munguan edhe falenderimet nga ana e autoriteteve vendore e arsimore për zotërinjtë: Luan Turja, me banim në Tiranë, Luan Manjani, me banim në Bulqizë, Genc Turja, me banim në Itali. Luan Turja realizoi rrethimin ndarës të shkollës nga rruga. Luan Manjani ngriti një fushë volejbolli, lyerjen nga jashtë të shkollës, si dhe disa punime të nevojshme për territorin e shkollës. Genc Turja shtroi me pllaka 120 metra katrorë para hyrjes së shkollës. Si mbyllje, Baftjar Rusi, ish nxënës i kësaj shkolle, sot avokat i njohur në Tiranë, për mësuesit dhe gjithë të ftuarit, shtroi një drekë në lokalin buzë Drinit, në Portgocë, Rrahman Manjani ishte mjaft i përkushtuar si profesionist duke mos lënë asnjë rast pa filmuar me aparatin e tij dhe duke na pasqyruar të gjithë aktivitetin Këta bijë të fshatit Homesh, madje edhe të tjerë , premtuan gatishmëri edhe për të tjera kontribute për shkollën, duke u shprehur me mjaft modesti se nuk donin t'u përmendej kontributi, sepse e ndienin që vetëm po kryenin një detyrim. Edhe biznesmeni i njohur nga Homeshi Demir Rusi premtoi se do të bëhej pjesë e kësaj nisme të bukur, duke ndihmuar dhe investuar për vendlindjen, sidomos për artin, kulturën dhe arsimin.

Kjo tregon se nuk ka humbur tradita e njerëzve humane, për të dhënë për shkollën kontributin modest të tyre. Dreka u shoqërua me përshëndetje dhe kujtime nga zotërinjtë Shemsi Manjani, Reme Hoxha, Latif Manjani,Skënder Zeneli, Mehdi Dema, Xhevat Jella, Bajram Hoxha, Latif Dema, etj.

Një ditë e bukur, e pasur me veprimtari të shumta, mbylli me sukses festën e shkollës së Homeshit, e cila do të mbetet një kujtim i paharruar për banorët dhe vizitorët e shumtë të ardhur enkas pranë familjeve të tyre për t'u çmallur dhe gëzuar në këto ditë pranvere, ku gjelbërimi, freskia e ujit dhe luleve, i jepte një gjallëri të admirueshme kësaj atmosfere festive. Me siguri, kujtimet e asaj dite do të pasurojnë historinë e shkollës dhe të këtij fshati historik e arsimdashës të Homeshit. Mirupafshim në festa të tjera ishte urimi për të gjithë!

- Do të kthehemi përsëri, - u thotë Zabiti njerëzve, kur po largoheshin, do të kthehemi vitin tjetër, por në Gjoricë, do të festojmë 90 vjetorin e shkollës së Gjoricës. E kështu, dalëngadalë Gryka e Vogël po bën historikun e arsimit në këtë zonë kaq të njohur, për dije, kulturë, histori, besë, trimëri, bujari e patriotizëm.

Sh.Skarra

Arni dhe Arnorët – një libër enciklopedik

Promovohet libri "Arni dhe Arnorët" nga Petrit Dunga



Gjatë muajit të kaluar në sallën e Muzeut Historik Kombëtar, historianë, poetë e gazetarë, botues dhe dashamirës të librit u mblodhën në promovimin e librit "Arni dhe arnorët" të studiuesit petrit Dunga.

Libri "Arni dhe arnorët", i pari për këtë zonë në një histori, traditë dhe figura të shquara në vite, është një studim "një enciklopedi për zonën" siç u quajt në diskutimet e pjesëmarrësve. Me mjaft interes u prit diskutimi i profesor Shefqet Hoxha, Isa Haliti, poeti Hysen Shehu, historiani dhe studiuesi Fatos Daci e të tjerë. Nga të gjithë diskutimet u fol për librin për një punë të vlefshme për berza, për të sotmen dhe për të ardhmen, për të vjelur traditën, kulturën, zonat dhe figurat e njohura në këtë zonë, por edhe një rëndësi të veçantë i është kushtuar studimit gjeo-fizik, pyjor, nëntokësor, toponimet, emërtimet dhe gjuha sipas dialektit të zonës së Arbrit.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte me fjalën e tij kryetari i Komunës Ilir Doçi që jo vetëm e vlerësoi librin, por falenderoi dhe autorin Petrit Dunga për iniciativën për të shkruar këtë libër, punën e madhe studiuese dhe kualifikuese për t'u treguar brezave që do vijnë gjithçka nga vendlindja jonë.

Edhe Albert Doçi, Misim Peca, Lutfi Coka dhe studiuesi Fejzulla Gjabi vunë në dukje pika kulmore në libër, dhe në vërtetësi, me fakte dhe dokumente, ngjarje, data, njerëz, deri dhe për vizitën e Edit Durham në zonën e Arnit, për bisedat e pritjen e saj nga vendasit, si dhe shpjegime të cilat Edit Durham i ka shkruar në librin e saj "Brenga e Ballkanit".

Libri "Arni dhe arnorët" i studiuesit Petrit Dunga, është një libër me vlera jo vetëm për zonën, por edhe në shkallë kombëtare, një studim i një treve në histori. Lexuesi i specializuar do gjejë vërtetë vlerësime, konkluzione e prezantim të të gjitha fushave, në arsim, histori, bujqësi dhe një shpjegim teologjik të fjalëve të përdorua në zonë.

Ilmi Dervishi

arsim

Shkolla e Trebishtit do të mbetet një gurë i çmuar kilometrik i historisë dhe kulturës së krahinës sonë, Gollobordës, që do tu ndrijë brezave që do të vijnë.

Edukata popullore shqiptare – **filozofia** mbizotëruese e shkollës në Gollobordë

Nga Docent **Agim GJINI**
Msc. **Kadri DAUTI**, *historian*

Shkolla shqiptare ka ekzistuar gjithmonë në trevën e Gollobordës, siç kanë qenë ato të ngritura nga Klemendi i Ohrit. Ata janë trashëgimi e vyer e kulturës arsimore të gollobordasve. Në këto shkolla ka mbizotëruar sistemi i edukatës popullore shqiptare. Historikisht, pushtimet e huaja e kanë penguar seriozisht procesin e zhvillimit normal të kulturës ilire dhe arbërore në këtë trevë më shumë se kudo tjetër. Si shqiptarë, gollobordasit e kanë ruajtur psikozën e kombësisë dhe përherë janë treguar vigjilent ndaj përpjekjeve të pashtershme e të pandershme të fqinjëve sllavë për shkombëtarizimin e tyre. Kjo vigjilencë i ka çuar gollobordasit në mbajtjen gjallë dhe konsolidimin e njësisë kulturore shqiptare.

Pavarësisht nga ekzistenca e një zhargoni të gjuhës sllave të folur, edukata shqiptare në këtë trevë është transmetuar kryesisht në gjuhën shqipe. Padyshim, në shkolla arsimi ka qenë organizuar në gjuhën amtare shqipe gjatë shekullit 20-të, e cila ka qenë dhe është baza e transmetimit të kulturës shkencore, shpirtërore dhe materiale kombëtare. Kjo ka ndikuar shumë në riparimin e dëmeve që kanë sjellë pushtuesit e huaj ndaj kulturës kombëtare të gollobordasve. Ajo ka ndikuar fuqishëm në edukimin atdhetar të gollobordasve duke i motivuar më shumë në mbrojtjen kombëtare të tyre.

Gollobordasit kanë qenë gjithnjë arsimdashës. Terroret ushtarake të pushtuesve të huaj nuk i kanë shuar dot përpjekjet e tyre për të përqafuar idetë e rilindësve shqiptarë dhe ecur në rrugën e shkollës kombëtare.

Të orientuar nga interesa të pastra kombëtare, të bazuar në idealet e lirisë e pavarësisë kombëtare, me formimin e tyre të lartë shkencor, kërkesat e intelektualëve gollobordas u rreshtuan në krahun e rrymës radikale të lëvizjes së gjerë masive e patriotike shqiptare të fillim shekullit 20-të. Ngritja e shkollës së parë shqipe në Trebisht vetëm në më pak se gjashtë vjet pas Kongresit të Manastirit, dhe vetëm në më pak se pesë vjet pas Kongresit të Dibrës (23 korrik 1909), më 15 mars 1914, pasqyron qartë dashurinë e gollobordasve për dije e kulturë. Sipas vendimit të Kongresit të Dibrës që alfabeti të zgjidhej nga populli, në kundërshtim me vendimin e Kongresit të Manastirit, (për aq sa kemi hulumtuar), në shkollën e Trebishtit u përdor alfabeti latin dhe gjuha amtare shqipe.

Hapja e shkollës shqipe në Trebisht, në ato vite kritike për fatet e Shqipërisë, në atë skamje të rëndë të popullsisë së vendit, është një tregues i qartë i mbizotërimit të dëshirës së zjarrtë që ushqenin gollobordasit për gjuhën e kulturën e tyre kombëtare. Si shkollë me tipare të plota kombëtare, demokratike, popullore dhe laike ka qenë guri i themelit për konsolidimin e kulturës kombëtare te gollobordasit. Ajo ishte një goditje e rëndë ndaj synimeve historike antikombëtare të shteteve fqinje për aneksimin e trevës së Gollobordës. Edhe në vitet e mëvonshme shkollat në këtë trevë i rezistuan tendencave për futjen e edukatës fashiste, duke ndikuar fuqishëm për ruajtjen e identitetit e kulturës kombëtare te popullsia e Gollobordës. Në saj të "njerëzve që kanë lindur për vatan", po aq edhe për të mësuesve patriotë që shërbyen me devotshmëri në këto shkolla të zonës, shkolla në Gollobordë ruajti fizionominë e saj kombëtare.

DISA TIPARE TË SHKOLLËS NË VITET 1920-1940

Në gjithë historinë e saj, shkolla në Gollobordë ka pasur e zhvilluar më tej tipare të qarta të një shkolle moderne. Që në krijimin e saj, ajo ka pasur në themel fizionominë kombëtare dhe ka ecur në frymën e rilindjes kombëtare, një domosdoshmëri jetësore kjo për veçoritë etno-kulturore të popullsisë së sonës por edhe të vetë historisë së saj. Mbi bazën e vendimeve të Kongresit Arsimor të vitit 1924, në Tiranë, u forcua fryma kombëtare e shkollës. Ajo ishte në tërë komponentët e saj gjithë shqiptare dhe në punën e saj mësimore e jashtë mësimore edukonte atdhetarë. Në procesin e reformimit të saj, u zhvilluan më tej parimet demokratike të shkollës. Kështu, ajo dha një kontribut të çmuar në formimin e një brezi të shëndosh të rinjsh nga shumë fshatra të Gollobordës, të domosdoshëm për afirmimin kombëtar të popullsisë dhe shtetin shqiptar në këtë trevë. Ajo i përgatiti me një shpirt, me një ndjesi, me një mendim, me një moral të vetëm qytetarët e ardhshëm të shtetit shqiptar.

Me reformën arsimore të pas vitit 1930, shkolla u modifikua më tej, në përgjigje të kërkesave të kohës dhe shkallës së qytetërimit shoqëror e familjar të vendit. Mësimi zhvillohej "mbi baza shkencore dhe demokratike". Ishte shkollë e njënjëshme në çdo pikëpamje me shkollat e tjera të vendit. I bazuar tërësisht në programin shtetëror, programi mësimor ishte shkencor-laik, i njësuar dhe i përparuar, me përmbajtje të pastër ko mbëtare, që synonte kultivimin e shpirtit të pastër, me moral njerëzor dhe moral laik. Në të nuk kishte më arsimim fetar dhe as gjuhë të huaj. Ndërkohë që në Shqipëri ekzistonin 30 shkolla (për kohën një sasi e konsiderueshme) fillore e private "grekofone, rumunofone, serbofone, italiane dhe të komiteteve të ndryshme fetare", ku një sasi e madhe fëmijësh shqiptar rriteshin "me kulturë e me ndjenja të ndryshme prej atyre" që jepeshin në shkollat shtetërore.

Gjuha e shkollës së parë të trevës së Gollobordës, asaj të Trebishtit, ishte gjuha shqipe si gjuhë amtare. Edhe ato pak përpjekje antikombëtare të rrymës estatiste që u dukën në fillim të shkollës u shuan shpejt nën pathosin patriotik të popullsisë dhe të burrave të shquar të Trebishtit e të zonës. Shkolla ishte plotësisht në rrugën kombëtare. Ajo synonte tu jepte dije shkencore e kulturë të përgjithshme popullore shqiptare. Mësuesit e shkollës, të kualifikuar me arsimin e duhur pedagogjik, (normalen), ndikuan fuqishëm për konsolidimin e frymës patriotike te nxënësit e popullsia e zonës, pjesa e madhe e së cilës, për shkak të rrethanave historike të kohës, nuk dinin shqip. Ata mbajtën gjallë ndërgjegjen kombëtare të gollobordasve të penës, të besës, të punës e të pushkës.

NJË DOKUMENT ORIGJINAL ME VLERA HISTORIKE

Për të pasqyruar më qartë cilësinë e shkollës të zonës së gollobordës në vitet 30-të të shek. XX sjellim para lexuesit një dokument origjinal dorëshkrim i mësuesit të shkollës së Trebishtit, Qamil Skuqi, normalist, nga Elbasani.

Dokumentin na e ofroi djali i këtij mësuesi patriot, Uran Skuqi, në shenjë respekti për banorët ku punoi si i ati me zell të madh. Ai pasqyron notat e provimit të fundit (Dëftesës) të nxënësve të klasës së katërt të djemve, në vitin 1932-1933, në vitet kur shkolla kishte marrë fizionomi të plotë si rezultat i reformave që vijonin të ndërmerreshin. Shkolla në këtë vit ishte me katër klasa. Nga 21 nxënës të klasës, kaluan 16 dhe mbetën 5 nxënës, një tregues që flet për disiplinën, seriozitetin e kërkesat e larta pedagogjike të shkollës.

Në shkollë zhvilloheshin 19 lëndë mësimore. Plani mësimor përfshinte këto lëndë: *sjellje, zelli, këndim, shkrim-ortografi, ushtrime gramatikore, hartim, artimetikë-gjeometri, histori natyre, dituri natyre, gjeografi, mësim shteti, kaligrafi, vizatim, këngë, gjimnastikë, punë dore, bujqësi dhe trajtë e përjashtme*. Qëllimi i grupit të lëndëve këndim, shkrim-ortografi, ushtrime gramatikore, hartim, kaligrafi, ishte që nxënësit të aftësoheshin për të lexuar shpejt e me ndjesi të plotë çfarëdo lloj shkrimi dore e shtypi, të ishin të "aftë të shprehnin mendimet e veta kthjellët, qartë, si me gojë ashtu dhe me shkrim" siç thuhej në udhëzimet asaj kohe për arsimin. Kujdes i veçantë i kushtohej historisë dhe gjeografisë së Shqipërisë, por edhe eposit patriotik.

Dokumenti na jep një panoramë më të plotë për gjendjen e shkollës së Trebishtit, por edhe të gjithë trevës: statusin e konsoliduar të programit mësimor dhe për një proces të mirë organizuar mësimor-edukativ.



Pasqyra e notave të provimit (dëftesës) së nxënësve të klasës së katërt, djem, të Shkollës Trebisht, viti mësimor 1932-1933. Dorëshkrim i mësuesit Qamil Skuqi.

> Mirënjohja u takon të gjithë mësuesve patriotë që kanë shërbyer në këtë zonë, që i janë përkushtuar tërësisht profesionit të tyre të nderuar, që me sakrifica të panumërta kanë punuar për edukimin e brezave të të rinjve, që kanë armatosur me dije mijëra intelektualë gollobordas për të shërbyer në të gjitha fushat e jetës në shoqërinë shqiptare.

* * *

Në këtë 100-vjetor të shkollës së parë të zonës, shfaqet madhështor roli i pazëvendësueshëm që ka pasur ajo për ruajtjen e identitetit kombëtar të popullsisë së Gollobordës, për kultivimin e kulturës popullore shqiptare, për përhapjen e dijes e të qytetërimit te brezat e kësaj treve liridashëse e patriote shqiptare. Shkolla e Trebishtit do të mbetet një gurë i çmuar kilometrik i historisë dhe kulturës së krahinës sonë, Gollobordës, që do tu ndrijë brezave që do të vijnë.

Mirënjohja u takon në radhë të parë gjithë mësuesve patriot që kanë shërbyer në këtë zonë, që i janë përkushtuar tërësisht profesionit të tyre të nderuar, që me sakrifica të panumërta kanë punuar për edukimin e brezave të të rinjve, që kanë armatosur me dije mijëra intelektualë gollobordas për të shërbyer në të gjitha fushat e jetës në shoqërinë shqiptare. Por po aq mirënjohje edhe për të gjithë prindërit arsimdashës, që kanë pasur etje dhe sakrifikuar për ti edukuar fëmijët e tyre me kulturën kombëtare dhe dijet shkencore.

Rruga e Arbërit nr. 97

Radika

Parku është habitat për më shumë se 1000 lloje të ndryshme të bimëve. Ai është pjesë e seksionitjugor të Brezit të Gjelbër Evropian - një rrjet unik ekologjik që shtrihet në mënyrë të vazhdueshme përgjatë ish Perdes së hekurt.

Parku nacional Mavrovë Maqedoni

Ndërtimi i Pendave e rrezikon parkun nacional!

Parku kombëtar Mavrovë në Maqedoni është njëri ndër më vjetrit në Evropë. I njohur për pyjet e tij të mëdha të ahut,livadhet alpine, lumenjtë dhe përrenjtë e paprekur.

Parku është habitati i një larmie të madhe të llojevetë ndryshme, të tilla si specieve të rralla të troftës, ujq, arinj dhe lundërza.

Por një lloj është i veçantë - Rrëqebulli i Ballkanit (Lynxlynxbalcanicus). Parku kombëtar i Mavrovës është qendra e fundit e mbetur, në të cilën kjo nën specie e rrëqebullit të Euroazisë, e rrezikuarnë mënyrë kritike, ka gjetur strehë.

Parku është habitat për më shumë se 1000 lloje të ndryshme të bimëve. Ai është pjesë e seksionitjugor të Brezit të Gjelbër Evropian - një rrjet unik ekologjik që shtrihet në mënyrë të vazhdueshme përgjatë ish Perdes së hekurt.

Lokacioni i parkut nacional "Mavrovë" në Maqedoni (KerstinSauer)

Kërcënimet



Lokacionet e parapara për hidrocentralet "Fusha e Llukovës" dhe "Ura e Boshkut"në parkun kombëtar.
(Burimi i hartës kryesore: Plani për involvim të të gjitha palëve të interesuara, projekti HC "Ura e Boshkut", i përgaditur nga GEING KuKShkup)

Në park janë planifikuar dy hidrocentrale të mëdha -"Ura Boshkut" dhe "Fusha e Llukovës".

Të dy projektet varen nga mjetet einstitucioneve financiare ndërkombëtare, duke minuar idenë themelore të një parku kombëtar.

Nëse këto dy projekte - ose vetëm njëri prej tyre - realizohen ashtu siç është parashikuar, si pasojë do të ndodhë një ndikim negativ mjaft i rëndë në biodiversitetin e parkut kombëtar të Mavrovës.

Dhe jo vetëm kaq, këto projekte sjellin rrezikun e humbjes së statusit të parkut nacional në këtë zonë!

HC "URA E BOSHKUT"

HC "Ura e Boshkut": lumenjtë të cilët do të jenë të ndikuar nga kullimi dhe përmbytjet: "Lumi i vogël" (lart) dhe "Radika"(poshtë).

Projekti për të ndërtuar akumulimin "Ura e Boshkut" është i vendosur në pjesën e sipërme të Lumit të vogël (MalaReka) në pjesën jugore të parkut.

Burimi kryesor i financimit për këtë projekt është një kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim –BERZH. Ky HC është projektuar për të prodhuar energji gjatë periudhës së kërkesës maksimale ditore.

Për këtë qëllim, rrjedha e "Lumit të vogël" dhe dy degët e saja kryesore do të nderojnë drejtimin për ti çuar në akumulim nëpërmjet tubacioneve dhe kanaleve.

Sipas nevojës, uji do të shkarkohet njëherë në ditë. Kjo do të thotë përmbytje të përditshme me ndikim enorm negativ në biodiversitetin nën rrjedhën e centralit elektrik –e gjithë kjo në parkun nacional. Për më tepër,ekologjia e lumenjve në tërë luginën seriozisht do të dëmtohet nga devijimi i pjesës më të madhe të ujëravenga rrjedhat e tyre natyrore.

Fakte dhe numra:

Lartësia e pendës:	33 m
Fuqia e instaluar:	68 MW
Shkarkimi maksimal ditor:	22 m³/s gjatë 5 orëve në ditë
(rrjedha mesatare e Lumit të vogël:	5.75 m³/s)
Ndërtimi/zgjerimi i rrugëve:	16.4 km
Kanale të reja prurëse:	19.70 km
Zona e cenuar drejtë për së drejti në PN "Mavrovë":	935 ha
Investimi:	84 mil. euro, 65 mil.euro të siguruara përmes kredisë nga EBRD

Vlerësimi përfundimtar për harmonizim të HE "Ura e Boshkut" me kriteret për financim të EBRD nuk është përfunduar ende.

Në kundërshtim me përfundimet zyrtare të studimit të biodiversitetit të përgatitur nën drejtimin e kompanisë maqedonase energjike ELEM, HC "Ura e Boshkut" do të rezultojë me dëmtim të rëndë të llojshmërisë biologjike dhe zvogëlimin e habitateve të specieve në fjalë. Ekspertë të njohur ndërkombëtarë kanë analizuar studimin dhe kanë arrit në përfundime te mëposhtme:

Sistemi i propozuar i kullimit, i paraqitur në mënyrë të detajuar në këtë raport, do të ketë ndikim momental negativ të habitateve dhe peshqve në këta rrjedha ujërash.

Jemi të mendimit se hulumtimi i llojllojshmërisë biologjikë është shumë sipërfaqësor, jo komplet dhe të çon në përfundime të gabuara lidhur me lundërzat, qartë, duke trajtuar në mënyrë joserioze rrezikun për këtë specie të rrezikuar."

Dr. NicoleDuplaix, Kryesues evropian i IUCN-SSC grupi i specializuar për lundërza

fushata

Gadishulli i Ballkanit është i vetmi vend në Evropë ku ka ende një shumëllojshmëri e lumenjve të paprekur, përrenj kristal të pastërt, lugina të gjera të lumenjve, pyjeve të paprekura pranë lumenjve dhe ujëvara spektakolare.

"Aktivitet e propozuara në Parkun nacional do të kenë ndikim të ngjashëm negativ në troftën autoktone, e cila në masë të madhe do të zhduket nga zona e akumulimit dhe pjesët e rrjedhës së poshtme të lumit, pas pendës..."

Dr. JörgFreyhof, Instituti për ekologji të ujërave të ëmbël dhe pellgje kontinentale të peshqve – Berlin dhe Kryesues Evropian i IUCN SSC/WI Grupi i specializuar për peshq të ujërave të ëmbël.

Lundërza e Euro Azisë (Lutra lutra) është specie e mbrojtur ndërkombëtarisht. (WolfgangA.Bajohr)

Rrëqebulli i Ballkanit i rrezikuar(Lynxlynxbalcanicus), i kërcënuar nga HC "Ura e Boshkut" (MS Scopes)

„Kryesisht, duket se mbizotëron qëndrimi se ... efektet negative mund të zbuten lehtësisht. Kjo nuk është një pikëpamje që unë e ndaj dhe ndjej fuqishëm se është në kundërshtim të fortë me qëllimet kryesore të menaxhimit të kategorisë së Dytë të mbrojtjes, parku nacional, i IUCN."

Dr. StevenWeiss IUCN Grupi i specializuar për troftat (SSG) dhe Autoritetpër listën e kuqe (RLA) për pellgjet peshkuese të troftave në Euroazi.

"Mavrova mbështet [...] habitatin e fundit riprodhues të Rrëqebulli të Ballkanit [...]. Çdo presion shtesë ndaj këtij habitati të përshtatshëm për riprodhimin e tyre mund të çojë në zhdukjen e njërës nga speciet më të rrezikuara të gjitarëve në Evropë."

Dr. UrsBreitenmoser, bashkë-Kryesues, IUCN-SSC Grupi i specializuar për mace.

Sipas dokumentacionit fillestar të projektit, mes zonave të prekura ishte dhe lugina e Lumit të thellë (Proi i thellë) – një lum malor i virgjër dhe i paprekur, me shpate të cilat karakterizohenme pyje shekullore të ahut. Kjo pjesë e PK Mavrovë, kohëvetë fundit është identifikuar si një nga trashëgimisë botërore potenciale në mbrojtje të UNESCO-s nga delegacioni ndërkombëtar i ekspertëve, dhe me kërkesë të Bankës Botërore u përjashtua nga projekti -suksesi i parë. Megjithatë, akumulimi do të ndërtohet në një nga pjesët më të pasura dhe më të bukura të parkut në aspektin e shumëllojshmërisë bimore. Këto livadhe alpine tëgjera janë një nga habitatet e pakta të rëndësishme për speciet bimore karakteristike nga Evropa veriore. Sipas Plantlife, realizimi i projektit"Fusha e Llukovës"do të ketë ndikim negativ në mbi 17 llojeve të rrezikuara të bimëve,siç janë speciet endemike: macedonicaFritillaria dhe Nartheciumscardicum. Përveç kësaj, zona mbështet disa prej 13 llojeve të habitateve të prekura në PK Mavrovë, të tilla si zonat alpine dhe veriore me torfe (Aneksi I, i Direktivës së Habitatit) dhe pyjet halore ballkanike të cilat karakterizohen me nivele të larta të endemitetit.

HC"FUSHA E LLUKOVËS"

Majtas: Lokacioni ku planifikohet të ndërtohet penda dhe zona e përmbytur. (Ulrich Eichelmann)

Ky projekt është planifikuar në afërsi të kufirit Maqedoni-Kosovë. Burimi kryesor i financimit pritet të jetë një kredi nga Banka Botërore. Projekti "Fusha e Llukovës" ka shumë ngjashmëri me atë të "Ura e Boshkut". Uji nga disa degë të Radikës, përmes kanaleve dhe të sistemit të gypave do të devijohet/ dërgohet deri në akumulim.

"Fritillariamacedonica"në pullën postare (2008) si pjesë e trashëgimisë natyrore të Maqedonisë. (Burimi: http://www.wnsstamps.ch)

Fakte dhe numra:

Lartësia e pendës:	71m
Fuqia e instaluar:	6MW,vlerësuar në 159GWh në vit duke pas parasysh shfrytëzimin e shumëfishtë përmes hidrosistemit ekzistues të "Mavrovë"
Shkarkimi maksimal ditor:	6m³/s
Ndërtimi/zgjerimi i rrugëve:	>20kmzgjerim dhe asfaltim
Kanale të reja për rrjedhje të ujit:	19.95km
Zona e cenuar drejtë për së drejti në PN "Mavrovë:	3,546ha
Investimi:	83 mil. Euro, 70 mil. Euro pritet të sigurohen përmes kredisë nga Banka Botërore.

PËRFUNDIME

Hyrja në Parkun Kombëtar Mavrovë në afërsi të zonës së projektuara "Ura e Boshkut" RomyDurst

- **Më shumë se 4,400 ha sipërfaqe nën banime natyrore do të jetë direkt të ndikuara nga të dyja ndërhyrjet për ndërtim të pendave.**
- **Të dy projektet janë në kundërshtim me udhëzimet dhe rekomandimet për udhëheqje me parqet nacionale**
- **Me fjalë të tjera, investimi në këto projekte nga BERZH dhe Banka Botërore mund të çojë në revokimin e statusit të "Parkut Kombëtar" të Mavrovës!**

KËRKOJMË

BANKA BOTËRORE DHE BERZH TË BËJNË REVOKIMIN E FINANSIMIT TË KËTYRE DY PROJEKTEVE!

QEVERIA E MAQEDONISË TË BRAKTISË IDENË PËR REALIZIM TË KËTYRE DY PROJEKTEVE

PARQET NACIONALE JANË PËR MBROJTJE TË NATYRËS, TË BIODIVERSITETIT DHE PËR REKREACION – E JO PËR TË NDËRTUAR PENDA!

Fushata "Të ruajmë zemrën e kaltër të Evropës"

Gadishulli i Ballkanit është i vetmi vend në Evropë ku ka ende një shumëllojshmëri e lumenjve të paprekur, përrenj kristal të pastërt, lugina të gjera të lumenjve, pyjeve të paprekura pranë lumenjve dhe ujëvara spektakolare. Vlerësimi hidromorfologjik e ekosistemeve të lumenjve në rajon tregon se më shumë se 60 % e rrjedhave ujore janë në gjendje natyrore ose gjysmë - natyrore. Përveç kësaj, këto ekosisteme lumore janë "pika të nxehta" të biodiversitetit: 69 specie endemike të peshkut dhe më shumë se 50 % e diversitetit të përgjithshëm të specieve të ujërave të ëmbla të grupit të molusqeve, jetojnë në Ballkan .

Megjithatë, "Zemra e kaltër e Evropës" është nën kërcënim. Nën maskën "burime të energjisë së gjelbër" nga Sllovenia e deri në Maqedoni planifikohet ndërtimii më shumë se 570 centrale hidroelektrike më të mëdha se > 1 MW. Parqet nacionale nuk janë kursyer.

Me qëllim për të parandaluar shkatërrimin e zemrës së kaltër të Evropës, Euronatur dhe Riverwatch në bashkëpunim me disa organizata kombëtare partnere, kanë nisur fushatën "Të rruajmë zemrën e kaltër të Evropës". Qëllimi i fushatës është parandalimi i projektimit të pakontrolluar të projekteve hidroenergjetike dhe për të ruajtur ekosistemet më të vlefshme dhe më të rrezikuara të lumenjve në Evropën Juglindore.

Më shumëinformata në:

www.balkanrivers.net

www.riverwatch.eu/balkan-rivers www.euronatur.org/Blaues-Herz-Europas http://ppnea.org/albanian_rivers.html

Më 19 maj, në Peshkopi, në mjediset e shkollës që mban emrin e mësuesit Myslim Shehu, u përurua busti i tij.

Përurohet busti i mësuesit Myslim Shehu

Më 19 maj, në Peshkopi, në mjediset e shkollës që mban emrin e mësuesit Myslim Shehu, u përurua busti i tij. Në këtë ceremoni, përvec mësuesve të shkollës, prindërve de nxënësve, merrnin pjesë edhe përfaqësues të Prefekturës, Drejtorisë Rajonale Arsimore dhe miq dhe familjarë të mësuesit të njohur.

Drejtoresha e shkollës, Albana Xhaka, në fjalën e saj përshëndetëse tha se "figurave të shquara të kulturës gjithmonë u ngrihen përmendore për të përjetuar veprën e tyre në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Mësuesit, edhe kur shuhen, janë përmendore të gjalla, të cilët me punën, pasionin, edukimin dhe arsimimin e mijëra nxënësve skalitin pavdekshmërinë e tyre në breza. Rëndësia e kësaj shkolle është e madhe dhe bëhet pjesë e kutlurës qytetare të Peshkopisë ku qindra nxënës janë shkolluar dhe janë afirmuar në fusha të ndryshme të jetës".

Mësuesi Sabedin Xhelili bëri një historik të shkollës. Ai tha se shkolla 9-vjeçare "Myslim Shehu" u hap më 13 nëntor 2003. Me një staf mësimor edukativ prej 24 mësuesish. Drejtori i parë ishte Zabit Trupja, zv/drejtor uzri Zyberi, mësues Fahri Piperku, Gafur Markeçi, Beqir Osmani, Afrim Tomja, Idriz Bulku, Violeta Neziri, Njazi Dani etj.

Në vitin shkollor 2003-2004, sipas tij, shkolla 9-vjeçare "Myslim Shehu" e filloi punën me 502 nxënës, nga ku 224 janë nxënës të ciklit fillor dhe 278 janë nxënës të ciklit të lartë.

Drejtues të shkollës "Myslim Shehu" në vite përmendin mësuesit Zabit Trupja, Neki Iskurti, Mensur Lela, Jonida Hajrullaj dhe Albana Xhaka.

"Falenderojmë mësuesit që kanë punuar me përkushtim e profesionalizëm dhe kanë lënë gjurmë të paharruara në shkollën tonë si: Z. Trupja, M. Xhembulla, F. Piperku, G. Markeçi, H. Shehi, Sh. Skara, S. Torpa, B. Osmani, N. Iskurti etj. Falenderojmë nxënësit që kanë përfaqësuar denjësisht shkollën në olimpiadat e organizuara nga DAR, MASH si: Renard Plaku, Besa Delishi, Ertigena Shehu, Malbora Poka, Malvina Elezi etj.", tha ai

Në vitin shkollor 2013-2014 shkolla 9-vjeçare "Myslim Shehu" e filloi punën me 362 nxënës, nga ku 172 janë nxënës të ciklit fillor dhe 190 janë nxënës të arsimit e mesme e ulët. Me një staf mësimor edukativ prej 24 mësuesish nga të cilët 10 mësues janë të ciklit fillor 13 mësues të arsimit të mesëm e të ulët dhe 1 mësuesit e arsimit parashkollor.

Ish-mësuesi Skënder Torba theksoi në fjalën e tij se "dëshiroj nga zemra në emër të gjithë mësuesve që kanë kontribuar në këtë shkollë dhe që sot janë pensionistë si: Shuip Skara, Mahmut Xhembulla, Beqir Osmani, Hasan Shehu. "Ruani dhe mirëmbani shkollën, orenditë, kulturën, dijet ku ju kaloni një pjeë të jetës suaj.

Mësoni dhe gjithmonë për të shijuar më mirë të nesërmen e jetës suaj. Respektoni mësuesit e edukatorët ashtu si respektoni prindërit tuaj. Mbani me nder emrin e shkollës suaj ku është vënë dhe emri i mësuesit të nderuar Myslim Baftjar Shehu".

Dylber Shehu, vajza e mësuesit Myslim Shehu, duke marrë fjalën tha se "Nderi dhe nderimi i të parëve, i jetës së tyre të përkushtuar dhe i veprës atdhetare, është detyrim madhor për secilin brez pasardhës pasi, kushdo që nuk di ç'ka qenë dhe nga vjen, nuk mund ta dijë as ku shkon dhe as kush është".

"Babai dhe mësuesi ynë Myslim Shehu, ishte njëri nga ata, luftëtarët e shumtë të Dibrës dhe të gjithë Shqipërisë, që luftuan për shkollën dhe shkrimin shqip në kohën kur shkollimi në gjuhën shqipe nuk ishte vetëm punë mësuesie por së pari ishte patriotizëm, ishte dashuri dhe sakrificë për gjuhën he shkronjat shqipe. Ai kishte dimensionet e një dijedashësi me përmasa të plota intelektuale e atdhetare aq të nevojshme asokohe, për shkollimin e brezit të ri. Mësuesi Myslim Shehu është nga të parët mësues dibranë i cili, hapi shkollat që në

> Myslim Shehu, falë gjuhëve të huaja që fliste dhe kulturës që kishte marrë në shkollat amerikane të kohës, shërbeu edhe si përkthyes mes komandave partizane dhe misionarëve anglezë që ndihmonin luftën çlirimtare të popullit shqiptar.

dekadat e para të shekullit që shkoi si në qytetin e Peshkopisë dhe në fshatrat e Klosit, Bellovës, Limjanit, Herbelit, Muhurrit, Dohoshtit, Staravecit etj. Në vitin 1941 ishte mësues edhe në shkollat e Dibrës së Madhe ku gjithashtu ka një kontribut të admirueshëm dhe një emër të nderuar që vazhdon t'ju përcillet brezave. Testamenti i gjithë jetës së mësuesit veteran Myslim Shehut ishte dhe mbeti edukimi, mësimdhënia dhe shkollimi i brezit të ri si nevoja e dorës së parë për zhvillimin e shoqërisë jnerëzore. Pikërisht ky testament u përcoll nga gjithë brezat që u njohën dhe bashkëpunuan me këtë mësues të përkushtuar, ashtu siç ia plotësuan këtë testament edhe katër nga fëmijët e tij, të cilët pasuan shembullin e babait duke ia kushtuar gjithë jetën profesionale, mësuesisë dhe edukimit të brezit të ri", tha vajza e mësuesit Myslim Shehu.

"I përfshirë tërësisht me forcat çlirimtare që gjatë viteve të Luftës, tha ajo, Myslim Shehu, falë gjuhëve të huaja që fliste dhe kulturës që kishte marrë në shkollat amerikane të kohës, shërbeu edhe si përkthyes mes komandave partizane dhe misionarëve anglezë që ndihmonin luftën çlirimtare të popullit shqiptar. Atdhetari dhe mësuesi pasionant Myslim Shehu, shkoi shpejt pasi sëmundja e shtriu ende pa bërë 60 vjeç, ndërsa drejtonte arsimin e rrethit të Dibrës si inspektor pranë Komitetit Ekzekutiv të rrethit." "Por, siç dihet, jeta e njeriut nuk matet me vite, por me gjurmë dhe ngjarje. Gjurmët e veprimtarisë pedagogjike të babait dhe mësuesit tonë Myslim Shehu janë të shumta dhe tashmë të njohura e të vlerësuara nga të gjithë ju, që me shkollën dhe shkollimin tuaj, me prindërit, mësuesit e nderuar dhe drejtorinë e kësaj shkolle, me pushtetin vendor të Dibrës tonë, nderoni edhe emrin dhe veprën arsimore të babait tonë, Myslim Shehut", mbylli përshëndetje e saj vajza e mësuesit që mban emrin shkolla 9 vjeçare në Peshkopi.

Bedri Hoxha, aktori dibran në teatrin e Selanikut

Bedri Hoxha, nga Deshati, Peshkopi, autor i disa librave me poezi dhe prozë, emigrant në Selanik të Greqisë për disa vite, prezantohet në trupën teatrore të Selanikut për disa vite me radhë dhe si aktor duke u vlerësuar dhe me çmime në festivalin e Monodramës në Vana- Bullgari, Manastir-Maqedoni, në Vlorë gusht 2010, në Korçë etj.

Në korrik të vitit 2013 në festivalin Ndërkombëtar të Prespës, Maqedoni, Bedri Hoxha u vlerësua sërish me çmim. Së fundi në maj 2014 në Festivalin Ndërkombëtar "Mono dielli" në Podijevë-Kosovë u prit me duartrokitje dhe pati vlerësime.

Juria e festivalit e përbërë nga prof. dr. Nebi Islami, Ilber Nuredini, regjisor dhe drejtori i Festivalit të Dibrës dhe dramaturgu Naser Shatolli vlerësuan me çmim Ollga Kasterina, që përfaqësonte Moskën, si aktorja më e mirë e festivalit, Selman Lokja si aktori më i mirë, ndërsa Bedri Hoxha u nderua me çmimin special të jurisë.

Ndërsa Jani Përdhiki, regjisor nga Greqia, u vlerësua me çmimin e medias.

Bedri Hoxha në personazhin e tij të një burri shqiptar të burgosur, të cilin e detyrojnë të numërojë nën mendje. Ka frikë se do të harronte numrat "Unë jam kapiten i shpirtit". Lëviz nëpër skenë, kërkon cigare në mes të burgosurve, në disa gjuhë dhe në fund të shfaqjes regjisori i jep një cigare. Aktori Bedri Hoxha sjell një tendencë të re e të mirë artistike në skenë thotë regjisori grek, Jani Përkidhi.

Përgatit: **Ilmi Dervishi**



botime

Ky libër i shtohet bibliotekës së arsimit në gjuhën shqipe të fëmijëve të emigrantëve. Ai jo vetëm mbulon punën e mësuesve në Selanik por edhe sjell vlera historike dhe artistike.

"Shkolla shqipe e Selanikut", një libër me vlera historike dhe artistike

Nga **Dashmir ZAÇE** *

Abdurahimi na ka quajtur Rilindës, çudi! Po ku qëndron çudia?....

Në veprat "Rilindësit e rinj", kryeristrukturim i të gjitha veprave me këtë tematikë të Abdurahim Ashikut vërehet një stil karakteristik gazetaresk qenë veprën e fundit "Shkolla shqipe e Selanikut" ka marrë formë artistike nëpërmjet pjesëmarrjes së mësuesve dhe pasqyrimit të krijimtarisë si ese, rrëfime e forma të tjera. Ndryshe nga librat e tjerë të Abdurahim Ashikut këtu ka edhe krijimtari letrare dhe artistike të mësuesve të shkollës sonë.

Pa marrë përsipër t'i bëj një analizë të gjithë veprës po paraqes disa nga veçoritë e librit që mbase në punimet e tjera nuk mund të jenë kaq të theksuara.

Në librin "Shkolla shqipe e Selanikut" jepet historiku dhe përpjekjet e një grupi mësuesish të Selanikut dhe rrethinave të tij përmirësimin plotësues të gjuhës shqipe që hodhi hapin e parë më 7 mars 2001.

Si lindi mendimi dhe si u realizua kjo dëshirë që në themel kishte dashurinë për gjuhën, dheun e mëmës, këtë e tregon Mimoza Dako e cila i ka përjetuar emocionet e dilemës "Do fillojë apo jo kjo punë?" në luftë me realitetin i cili nuk ishte shumë mikpritës, në luftë me veten "A do të jemi në gjendje të gjejmë mësues?", "Po nxënësit a do të vijnë?"...

Këto dilema morën fund më 7 mars 2001 kur salla ku u mblodhëm ishte plot me mësues, fëmijë dhe me prindër.

Hapi i parë ishte i suksesshëm. Që këtej do të nisë rruga që filloi në Selanik, për të vazhduar në tërë Greqinë.

Emocione, gëzime dhe pika loti...

Një 7 mars në shekuj të ndryshëm e në vite të ndryshme, një ripërtritje në kohë.

Një kohë kur Shqipëria po rilindte nga sklavëria otomane, në kohë kur diktatura e egër ra dhe shqiptarët e shpërndarë nëpër botë kushtoi thirrja:

"Të ruajmë fëmijët nga asimilimi! Të ruajmë identitetin e fëmijëve tanë!"

Abdurahimi na ka quajtur Rilindës çudi!

Po ku qëndron çudia?

Së pari: Në sakrificën që bënë mësuesit e Selanikut që morën përsipër një detyrë të vështirë në një mjedis jo shumë miqësor.

Së dyti: Morën përsipër që mësimin ta bëjnë si vullnetarë nën shembullin e gruas së madhe Nënë Tereza.

Së treti: Të realizojnë orët mësimore vetëm me tri libra duke fotokopjuar temat e mësimit.

Së katërti: U punua në gjysmë ilegalitet, gjithmonë me shqetësimin "A po më vjen policia?"

Së pesti: Librat nuk i sillnin nga Alemania si Dhaskal Todri por nga Përmeti, Korça e Tirana të mbledhura nga mësuesit pasi mbaronin vitin shkollor në Shqipëri dhe i fusnin në Greqi si literaturë artistike.

Së gjashti: Shteti, si sulltanati nuk na përkrahu fare, bile ministri i jashtëm kur vajtëm t'i qanim hallet na deklaroi: "Vetë keni vajtur në mërgim, vetë zgjidhini hallet tuaja", a thua se hallet tona nuk ishin halle të një të tretës së Shqipërisë në mërgim...

Së shtati: Kemi një ndryshim të vogël nga rilindësit. Asnjeri nga ne nuk u helmua dhe nuk u persekutua.

Libri hodhi shtat nga faqja në faqe me shkrime të mençura e gjithë emocion të Valbonës, Irisit nga garda e vjetër për të vazhduar me Mimoza Demollarin, Julia Gogën e të tjera, e të tjera mësuese të fillimit dhe në vitet e më vonshme kur vinte gjaku i ri që me aq mjeshtri e ka futur në rrjedhë Durua, siç i thërres unë Abdurahim Ashikut.

Nuk po i përmend me emër sepse i keni në kopertinën e librit dhe në shkrimet e tyre aq emocionante. Në kopertinë janë 21 mësues që kanë punuar në Selanik dhe në rrethinat e tij...

Një vlerë tjetër e librit të Abdurahim Ashikut është komunikimi direkt me mësuesit nëpërmjet fjalës, duke e bërë atë njëkohësisht autor edhe personazh. Kjo është bukuria e librit, një risi që s'e kanë librat e tjerë të Duros.

Duke lënë vend për ta diskutuar edhe të tjerët dua të theksoj se libri ka vlera që autori ka ditur t'i sjellë aq natyrshëm si shqetësimin tonë si mësues dhe mërgimtarë dhe moskokçarjen e shtetit dhe Ministrisë së Arsimit ndër vite. I lë pak mënjanë vitet e fundit kur u detyruan të impenjohen pasi Ministria e Arsimit dhe e Teknologjisë e Kosovës qe më përpara dhe më e organizuar.

Pas kësaj filluan të na vijnë libra dhe fletore. Vetëm kaq...

Këtu dua të jap një falenderim për krijuesit e Selanikut të organizuar në lidhjen e shkrimtarëve dhe artistëve "Dega e blertë", të cilët na kanë mbështetur vazhdimisht me letërsinë artistike dhe librat që kanë botuar.

Libri është i ilustruar me fotot e mësuesve dhe nxënësve nga veprimtaria mësimore dhe jashtë mësimore.

Impresionuese është kopertina e librit ku janë mësuesit e Selanikut, kompozicion me të vërtet artistik, realizuar me mjeshtri nga mësuesja e shkollës sonë Iris Bali Hajdinaj.

Po kështu vazhdon ana figurative nëpërmjet fotove të ndryshme që vetë Durua ka treguar mjeshtërinë e tij si fotograf.

Ky libër i shtohet bibliotekës së arsimit në gjuhën shqipe të fëmijëve të emigrantëve. Ai jo vetëm mbulon punën e mësuesve në Selanik por edhe sjell vlera historike dhe artistike.

Në këtë festë të shkollës dua t'i uroj Abdurahim Ashikut 73 Vjetorin e Lindjes.

Edhe njëqind vite jetë dhe krijimtari i dashur Duro në shërbim të mërgimtarëve dhe veçanërisht të dashurisë tënde të pakufi për gjuhën shqipe në emigracionin shqiptar.

** Mësuesi i parë i Shkollës shqipe të Selanikut*

Selanik, festohet 10 vjetori i shoqatës "Nënë Tereza"

Më 11 maj, në Selanik, me rastin e 10-vjetorit të shoqatës së emigrantëve shqiptarë "Nënë Tereza" u përurua libri i Abdurahim Ashikut "Shkolla Shqipe e Selanikut". Prezantimi u zhvillua në mjediset e Universitetit "Aristoteli" të Selanikut, ku kryhet edhe mësimi i gjuhës shqipe nga mësueset vullnetare të kësaj shoqate. Kjo festë i dedikohet të gjithë atyre që kontribuan dhe përkrahën këtë shoqatë në këta 10 vjetë histori.

Rreth saj u gjendën përfaqësuesë të diplomacisë shqiptare, intelektualë dhe veprimtarë, prindër dhe fëmijë, një komunitet që vlerëson ata të cilët u përpoqën në vite ti përfaqësojnë denjësisht dhe të hapin udhën për të lehtësuar dhe ndihmuar secilin që e ndien veten të përfaqësuar prej tyre.

Aktivitetin e prezantoi Jorida Demba, mësuese vullnetare pranë Shoqatës "Nënë Tereza" Selanik. Në vazhdim folën; gazetari Abdurrahim Ashiku- autori i librit "Shkolla Shqipe e Selanikut", një nga mësuesit e parë të gjuhës shqipe në Selanik z. Dashmir Zaçe dhe kryetari i shoqatës z. Arjan Cara, i cili i prezantoi të pranishmit me historikun e kësaj shoqate.

Mësuesja vullnetare pranë Shoqatës "Nënë Tereza", Iris Hajdinaj, kishte përgatitur një dokumentar me fotografi nga aktiviteti i shoqatës ndër vite, dhe të gjithë së bashku mësuesë dhe nxënës shfaqën një program artistik me vjersha edhe këngë. Aktivitetin e përshëndetën të ftuar e bashkëpunëtorë të shoqatës, për të cilët u ndanë vlerësime dhe mirënjohje me rastin e festimit të 10 vjetorit të kësaj shoqate për të cilën ata dhanë ndihmën dhe kontributin e tyre. Festa vazhdoi me tryezën bujare të amvisave shqiptare që kishin përgatitur për këtë rast gatime të ndryshme tradicionale, muzikë e zgjedhur nga repertori i gurrës popullore shqiptare si dhe shorti që bënë organizatorët e shoqatës "Nënë Tereza"

Shoqatë është themeluar më 19 Prill 2004, me qëllim aktivizimin e emigrantëvë në veprimtari të ndryshme artistike e sportive, për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës dhe traditave shqiptare, ruajtjen e gjuhës shqipe dhe forcimit të marrëdhënieve miqësore të emigrantëve me shoqërinë greke. Kryetari i parë i saj u zgjodh z. Aleksandër Gjoni, ndërsa tani shoqatën e drejton bulqizaku Arjan Cara. Mbi veprimtarinë e kësaj shoqate në vite dhe planet në të ardhmen do ju informojmë në numrat e ardhshëm, ndërsa më poshtë po paraqesim fjalën e mbajtur nga mësuesi i kësaj Shkolle Dashmir Zaçe, mbi librin "Shkolla shqipe e Selanikut", i Abdurahim Ashikut, botuar nga Botimet M&B, Tiranë, 2014.

- Libri ka vlera, të cilat autori ka ditur t'i sjellë aq natyrshëm si shqetësimin tonë si mësues dhe mërgimtarë dhe moskokçarjen e shtetit dhe Ministrisë së Arsimit ndër vite.
- Një vlerë tjetër e librit të Abdurahim Ashikut është komunikimi direkt me mësuesit nëpërmjet fjalës, duke e bërë atë njëkohësisht autor edhe personazh.

Mbi librin "KRAHINA E ÇIDHNËS"
të Haki Përnezhës

"KRAHINA E ÇIDHNËS", libër me gjuhë të kuptueshme, ku fjala vlerësohet në maksimum

Nga **Xhafer MARTINI**

Sapo filluan proceset demokratike përgatita një libër me titull "Çidhna", por ai nuk u botua në kohën kur mund të botohej dhe librat e tjerë e shtynë jashtë sferës sime të interesave krijuese. Kur po shkruaja atë libër, takova në shtëpinë e tij Haki Përnezhën, që më priti me dashuri e bujari, dhe më vuri në dispozicion një material që e kishte hartuar vetë për dëmet e mëdha që iu shkaktuan popullit të Fushë Alies në vitin 1944 kur fshati u dogj nga shtëpia e parë deri tek e fundit nga partizanët. Ishin të dhëna të hollësishme, të llogaritura mirë dhe, pothuaj të njejta me ato të ekspertëve që u dërguan mbas çlirimit nga shteti, gjoja sikur populli do të zhdëmtohej, por kjo nuk ndodhi kurrë. Jo vetëm nga ato të dhëna , por edhe nga biseda që pata me Hakiun për probleme të ndryshme të historisë dhe të kulturës së Çidhnës, kuptova që ishte djalë me interesa dhe dallohej nga mjedisi rrethues. Tani që Hakiu ka botuar disa libra, nuk më vjen çudi që më bie në dorë libri i tij më i mirë i deritanishëm, titulluar "Krahina e Çidhnës", botimet M&B, Tiranë 2013.

Përmbajtja e librit është mjaft e pasur. Lënda e mbledhur fillon nga lashtësia dhe vjen deri në ditët tona. Kështu, si shembull, përmendim kapitujt "Histori", "Fise dhe figura", "Lufta Ballkanike", "Kuvendi i Arrasit", "Paria e Çidhnës dhe serbi", "Udha e një shkolle", "Etnologji, "Sociologji", "Urbanistikë", "Konakët", lindja dhe formimi i tyre; "E drejta zakonore", "Beja", "Disa njohuri praktike", "Lojëra popullore" etj. Libri është voluminoz, por ai nuk është ndërtuar sipas parimit: shto ujë e shto miell; nuk ka zgjatje dhe stërhollime të panevojshme. Përkundarzi, moria e temave dhe e problemeve është shprehur sa më shkurt që ka qenë e mundur, prandaj lexuesi nuk mërzitet duke e lexuar. Përkundrazi, libri është shkruar saktë, me gjuhë të kuptueshme dhe me një stil ku fjala vlerësohet në maksimum. Në shumë kapituj ka prurje të reja, siç ka edhe ndonjë përsëritje.

Një meritë tjetër e Haki Përnezhës qëndron në faktin se ai librin e ka shkruar mbi bazën e një dokumentacioni shumë të pasur, u është referuar shumë autorëve.Pasuria dokumentare, edhe kur nuk shoqërohet kurdoherë me kontribute origjinale, të reja, dëshmon për një përkushtim ndaj asaj që merr përsipër të shkruash. Numri i referencave të Hakiut është 614 , si tek rrallë libra edhe të autoriteteve të shkencës. Megjithëse jo të gjitha burimet janë me rëndësi të veçantë, çdo pohim ka një burim, qoftë edhe prej kujtimeve të njerëzve të ndryshëm që Hakiu, si i pasionuar që është, i ka mbledhur me kohë. Vetëm për dy kapitujt e parë të librit Hakiu ka 248 referenca. Hakiu ua di rëndësinë dhe peshën burimeve. A e di se vlerën kryesore dhe më të madhe e kanë burimet arkivore. Por, në mungesë të tyre, ai shfrytëzon edhe kujtimet e pleqve. Hakiu e di se kujtimet janë një gozhdë e dobët për të varur pallton e historisë, siç ka thënë një dijetar, prandaj këto lloj referencash i mbështet edhe me dokumente të tjera.

Me pak fjalë, çdo pohim që bën Hakiu vërtetohet të paktën nga dy burime. Kjo është gjë e mirë, se ne kemi parë të botohen libra ku jepen gjërat si absolutisht të vërteta vetëm duke u mbështetur në thënien e ndonjë plaku. Por Hakiu duhet të ketë kujdes në përdorimin e burimeve. Më mirë për një kapitull të keshë pesë-gjashtë burime të ndryshme se sa të keshë 50 burime nga i njejti autor. Për shembull, një libri të I. Kacës, Hakiu i është referuar 38 herë në bllok, pa futur midis tyre asnjë referencë tjetër; H. Purullakut i është referuar 84 herë. Mund të jepnim edhe shembuj të tjerë, por Hakiu me kaq e kupton se kjo nuk është gjë e mirë.



Libri i Haki Përnezhës "Krahina e Çidhnës", mbetet një nga librat më të mirë jo vetëm të këtij autori, por edhe krahasuar me librat e tjerë të shkruar për Dibrën. Stili i të shkruarit është mjaft tërheqës, i saktë dhe i figurshëm. Hakiu, si zotërues i mirë i gjuhës shqipe, i mënyrës së të shkruarit shqip, e ka bërë librin të lexueshëm në saj të saktësisë së shprehjes dhe vlerësimit të fjalës.

Meritë tjetër e librit të Haki Përnezhës është se begatia e materialeve kthethet në cilësi prej faktit se shumë materiale janë prurje të reja, ose kontribuojnë me këndin e ri të shikimit të dukurive të ndryshme. E kemi fjalën për mjaft materiale që nuk janë përdorur nga autorë të tjerë, por, edhe kur janë trajtuar, nuk kanë pasë këtë kënd shikimi që ka Hakiu ndaj tyre. Të kësaj natyre janë kapitujt për shkollën e Kastriotit , për prejardhjen e fiseve, për mënyrën e jetesës, për udhët e hershme, konakët, veshjen e burrave dhe të grave, disa njohuri praktike, lojërat popullore, bestytnitë etj. Nga këto kapituj mësojmë se qëllimi i Hakiut nuk ka qenë vetëm të japë thjesht historinë e krahinës së Çidhnës, por edhe kulturën e saj materiale dhe shpirtërore, çka e nxjerr Çidhnën si një krahinë me veçori individuale dhe me kontribut të madh në historinë e kulturës popullore dibrane dhe atë shqiptare.

Libri "Krahina e Çidhnës" e këtij autori mund të shfrytëzohet si burim referimi nga shumë autorë të tjerë që do të merren në të ardhmen me historinë e Çidhnës. Ai ka shumë fakte, data, emra. Për shembull, vetëm të lexosh nënkapitullin "Sulmi në Fushë Alie", që u bë nga forcat partizane më 8 korrik 1944, mëson shumë gjëra përsa i përket kronikës luftarake, sepse vetëm për të shkruar katër-pesë faqe, autori u është referuar rreth njëzet burimeve. Me kaq hollësi kjo betejë mund të jepej vetëm nga një kronikan i kohës që do të kishte ndjekur nga afër zhvillimin e betejës, pra, do të ishte një dëshmitar okular. Kjo e bën librin e Hakiut të vërtetë, të besueshëm, bindës. Autori din t\i alternojë në mënyrë mjeshtërore llojet e ndryshme të burimeve. Kështu, si shembull, krahas materialit dokumentar për kronikën luftarake, ai e gjen me vend të japë edhe kujtimet Vesel Bushit, që i japin betejës jo vetëm vërtetësi të mëtejshme, por e pasurojnë me detaje që karakterizojnë sjelljen dhe qëndrimin e partizanëve, të cilët *hanin bukën dhe përmbysnin kupën*, si thuhet. Të mundur dhe të përgjysmuar, me moral të thyer, të pangrënë dhe të raskapitur, shkojnë në stanet e Gramës ku u kërkojnë stanarëve t\u therin disa berra, po atyre stanarëve me njerëzit e të cilëve kishin luftuar disa orë më parë. Si hëngrën dhe u ngopën, ranë të flinin. Si u ngopën edhe me gjumë, u kërkuan stanarëve të dorëzonin armët. Ata kundërshtuan duke thënë se në mal pa armë nuk mund t'i ruajsh bagëtinë. Njeri prej tyre kundërshton dhe, nëse ai nuk do të ishte hedhur në një greminë, do ta kishin vrarë. Megjithatë, ata i shkaktojnë pesë plagë. E dhashë këtë detaj për të treguar që Hakiu di të zgjedhë për të individulizuar dhe tipizuar karaktere të ndryshme. Pra i ve rëndësi edhe aspektit të paraqitjes emocionale të çdo ngjarjeje. Por edhe këtu duhet të ketë kujdes nga citimet, që ato të jenë shumë të pakta në krahasim me fjalën e autorit. Nuk mund të shkruhet një libër me citime se dobësohet origjinaliteti. Tek kapitulli "Masakra e Çidhnës" Hakiu ka 53 radhë citime dhe 53 radhë janë fjalë të autorit; Tek kapitulli "Çidhna në vitet 1600" -118 radhë janë citime, 92 radhë janë të autorit. Po kështu edhe po ta shikosh librin faqe për faqe, ky problem nuk qëndron më mirë. Kështu, si shembull, në faqen 137- 31 radhë janë citime- 4 radhë janë fjalë të autorit.

Së fundi, stili i të shkruarit është mjaft tërheqës, i saktë dhe i figurshëm. Hakiu, si zotërues i mirë i gjuhës shqipe, i mënyrës së të shkruarit shqip, e ka bërë librin të lexueshëm në saj të saktësisë së shprehjes dhe vlerësimit të fjalës. Ai përgjithësisht shkruan me një frazë të shkurtër dhe të ngjeshur, por ka raste edhe kur "ia lëshon frerët frymëzimit" dhe bën përshkrime më piktoreske, por gjthsesi me masë dhe me vend.

Libri i Haki Përnezhës do të kishte përfituar më shumë sikur të ishin shmangur disa pasaktësi. Redaktori i librit, Fejzulla Gjabri, është burrë me kulturë dhe ndërgjegjje, por, duke mos qenë vendas, shumë gjëra nuk i ka ditur ashtu siç kanë ndodhur. Me një rilexim më të vëmendshëm të metat mund t'i kishte shmangur vetë autori, ose recenzentët. Prandaj librat, sidomos librat shkencorë, e kanë të domosdoshëm që ta kenë të plotë stafin e botimit. Në faqen 201-205 në nënkapitullin "Vrasja e Hamit Kukelit", vetëm emri është i Hamitit, kurse gjatë shtjellimit të materialit, bëhet fjalë për vrasjen e Halim Kukelit. Të dy këta ishin bashkëfshatarë, fis, dhe shtëpitë i kishin afër. E vërteta është se u vra Hamit Kukeli, kurse Halim Kukeli ka vdekur nga mortja e vet, shumë vite më vonë. Në tregimin e jetuar të Destan Përnezhës, në faqen 200, ka edhe këtë fjali: Në Qafë të Agrit "...na dolën para forcat partizane të B. Currit dhe u detyruam të ngjitemi përpjetë Majës së Hekurave". Kjo fjali, që unë po e japë siç është shkruar në libër, është çoroditëse sepse lexuesi kujton se Bajram Curri ka qenë komandant i partizanëve dhe ka sulmuar Halil Alinë dhe pasuesit e tij. Bajram Curri është vrarë nga forcat e Zogut në Shpellën e Dragobisë më 1925. Po të ishte futur emri Bajram Curri në thonjëza, do të kuptohej se ishte fjala për një toponim dhe jo për një njeri. Por edhe kjo nuk e zgjidh problemin mbasi në atë kohë qendra rurale e Tropojës quhej Kolgecaj dhe jo "Bajram Curri". Këtë emër e ka marrë pas çlirimit. Në faqen 90 flitet edhe për ndëshkimin që i dhanë Sllovës, posaçërisht Nderve, gjermanët dhe Halil Alia në nëntor të vitit 1943. Për këtë ngjarje autori citon edhe Ismail Strazimirin që, sipas tij, shkruan: *" forca të mëdha gjermanësh dhe mercenarësh , të primë prej tradhtarit Halil Alia, e rrethuan dhe e sulmuan Sllovën."* Por çdo gjë mund të ketë shkruar Ismail Strazimiri, vetëm atë që citohet nuk mund ta ketë shkruar, se ai u vra me atë sulm. Ja si e kujton këtë ngjarje i biri i Ismail Strazimirit, Rushit Strazimiri, që ka qenë edhe vetë pjesëmarrës: Mbasi ishte i sëmurë dhe i plakur shumë, 75 vjeç, Ismail Strazimiri nuk iku me të tjerët, por mbetë i vetëm në konakun e Ndreut. "Gjermanët u turrën të hyjnë në dhomë, - shkruan Rushiti,- por aty baba përsëri i priti me plumb ballit. I pari nga ata që kaloi derën, mbeti i vrarë nga plumbat e nagantit. Atëherë ata, të inatosur, hynë nga penxheret dhe ja zbrazën gjithë karikatorin e mitralozit në kokë babës. ...E morëm dhe e varrosëm pranë varrit të Elez Isufit" (*Ismail Strazimiri "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", f. 86, Tiranë 2010*) Në faqen 177 ka edhe një fjali të tillë, të cituar nga Xh. Domi: "Me rastin e mbylljes së vitit shkollor 1928-1929...200 djem dhe vajza të Internatit "Dibra" të Kastriotit..." Shkolla e Kastriotit nuk ka pas vajza, ajo ka qenë shkollë mashkullore. Në faqen 73 ka edhe një fjali të tillë: *"Në këto vite (1863 e në vazhdim, kur Dibra ishte pa mytesarif)*. Kështu si është shkruar, kjo fjali është pa kuptim. Asaj do t\i vinte kuptimi po të hiqeshin kllapat dhe lidhëza *kur*. "Në këto vite, 1863 e në vazhdim, Dibra ishte pa mytesarif".

Me gjithë këto të meta, libri i Haki Përnezhës "Krahina e Çidhnës", mbetet një nga librat më të mirë jo vetëm të këtij autori por edhe krahasuar me librat e tjerë të shkruar për Dibrën. Ndjenja e mirë dhe e sinqertë, përkushtimi atdhetar, dashuria për vendlindjen, e kanë bërë Hakiun të sjellë një kontribut të madh për studimin e krahinës së vendlindjes në bazë të një dokumentacioni shumë të gjerë dhe të larmishëm, pavarësisht nga ndonjë dobësi në shfrytëzimin e tij. Libri i Hakiut do të jetë një pikë referimi, sidomos për ato të dhëna dhe dukuri të reja që gjatë këtij shkrimi u përpoqëm t'i vinim në dukje. Haki Përnezha është i prirur për t'u marrë me studime historike dhe në fushën e etnokulturës, për më tepër është i aftë t'i organizojë dhe t'i integrojë ato me njeratjetrën duke dhënë kulturën e një populli të një krahine të tërë. Me siguri në të ardhmen do të kemi në duar libra të tjerë nga Hakiu dhe ky do të jetë një gëzim i madh jo vetëm për studiuesit dibranë, që do të gjejnë pika të shumta referimi, por për të gjithë lexuesit mbarë. I uroj Hakiu suksesese të mëtejshme dhe libra të tjerë.

blog

Disa rrjete sociale po botojnë komente dhe opinione te ndryshme për mjedisin dibran, dhe redaksia herë pas herë do t'i botojë disa prej tyre, ku spikasin idetë, mendimi, origjinaliteti, vëzhgimi, mprehtësia.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Mik i dashur,

Mjaft m'u ankove për mungesën e muajit të kaluar. Nuk është se doja, por sepse duhej të respektoja një shkencëtar dibran. Se, po të mos e respektonim ne, kush do ta bënte? Shteti? Shtetarët nxitojnë të dalin me lot krokodili në edicionet qendrore të lajmeve, kur ikën nga kjo botë ndonjë gaztor dhe, kur ndahet nga ne një shkencëtar, jo vetëm që nuk gjejnë një vend publik për homazhe, por fshihen zyrave...

Në fillim të këtij muaji, kryeministri Rama vizitoi Dibrën e Madhe. Nuk u mor vesh nga shkoi, nga Miloti, nga Kukësi, Prishtina, Pogradeci apo me helikopter, por me siguri para apo pas selfies me Thaçin dhe Ahmetin, duhet ta ketë kujtuar se nuk është Dibra periferi e Tiranës, por se Tirana është shumë larg Dibrës. Dhe sigurisht, duhet të jetë kujtuar për premtimet për Rrugën e Arbërit...

Dibra ia arriti ta kthente çështjen e Rrugës së Arbërit në temë të ditës në Tiranë, madje arriti t'i mblidhte bashkë pesë deputetë dibranë, nga 13 në parlament, por akoma s'ia ka arritur ta bëjë solide mendimin: "Pa rrugë, nuk ka Dibër dhe pa Dibër nuk ka Shqipëri..."

Radika ia ka dalë ta kalojë pranverën si temë kryesore debateve dhe mediumeve, por, gjithashtu, ia doli të mos çonte asnjë deputet dibran në Parlamentin e Maqedonisë...

Një faqe sociale në Facebook i bëri 10 mijë miq dhe me këtë rast u bëri thirrje atyre të përdorin më pak like dhe më shumë fjalë... Por dibranëve duket se u pëlqen të përdorin gishtin në publik, ndërsa fjalët i kanë për pas shpine...

Në Trebisht dhe Homesh u kujtuan shkollat e para shqipe. Morën pjesë deputetët, ministra, komunarë, qytetarë. Është mirë që kujtohen shkollat e para, por që të kujtohet edhe në vitet në vazhdim, duhet të kujdesemi më shumë për shkollën tani...

Në Peshkopi është pëlqyer shumë lajmi për finalizimin e ujësjellësit. I harxhuam dy milionë dollarë për të sjellë ujin nga Drini, do Zoti me katër na vjen uji nga mali.

Në një festival filmi të financuar nga BE, me pjesëmarrje nga Kanadaja, SHBA, Gjermania, Kroacia, Bosnja, Italia, Franca, Brazili, kronika nga pyjet e Lurës fitoi çmim si reportazhi më i mirë. O Lura, o filmi, njëra del fituese me dhimbjen e tjetrës...

Ambasadorët e huaj vizituan Dibrën e Madhe me 9 maj, me autobus. Kujtohen ndonjëherë europianët për periferitë e Europës dhe i vizitojnë si zona të pazhvilluara, për kuriozitet. Dhe me këtë rast presin edhe ndonjë shirit për ndonjë rrugë këmbësorësh malit për turistët ...

Top Channel realizoi një dokumentar për Dibrën e Madhe, shumë i mirë, shumë realist dhe shumë kritik. Në Dibër u prit si gjithmonë, gjysma me kritika, gjysma me lavdërime. Sa mirë që jemi të përçarë ne dibranët, se të jemi të bashkuar, marrim edhe qeverinë e Tiranës, edhe të Shkupit...

Ky muaj ishte tragjik për vajzat e motrat tona. Një vajzë 23 vjeçare u gjet e vetëvarur në një fshat të Dibrës, një 17-vjeçar u vethelmua, por për fat të mirë shpëtoi, ndërsa një maturante humbi jetën në një aksident automobilistik. Dhe, sikur të mos mjaftonin këto, një baba qëlloi vajzën 21 vjeç dhe deshi ta varrosë pa lënë gjurmë... Pas këtyre ngjarjeve tragjike, më vjen turp të krenohem me Dibrën...

Muajin e kaluar, një pedagog u arrestua në Peshkopi se u merrte ryshfet studentëve. Ndërsa këtë muaj media është marrë me emërimet e pedagogëve në filialin e Peshkopisë, pa arsimin dhe kualifikimin e duhur. E imagjinon dot, se çfarë vlere ka dhjeta e studentëve, kur profesorët nuk kapin dot shtatën?!

Ka lezet ndonjëherë kur bën autostop: të qëllon të hipësh në një furgon që vjen aromë duhani. Shoferi ndez llullën dhe një re tymi mbush makinën. "Shofer, mbaje pak, të lutem, se dua të zbres!". Ai kthen kokën, makina duke ecur, dhe ngre zërin: A s'do shkojsh në Peshkopaj? "Në Peshkopaj do shkoj, por due me shkues shnosh, jo i drogue prej tajmi tand t'duhanit". Me këtë rast mësova duke pritur në rrethrrotullim se "Wireless" e ka emrin "Cafe rrotullacka". Se rrethrrotullim është fjalë e madhe për çfarë është në realitet. Në tre cepe ka nga një lokal, ndërsa cepit të katërt, ose s'i ka dalë pronari, ose i ka qëlluar i varfër dhe s'ka mundësi të ndërtojë... Mësova, gjithashtu, se nga Maqellara në Peshkopi kushton 100 lekë të shkosh me taksi...

Në Peshkopi janë pjekur qershitë? A e do një degë?

Familja, shtëpia, toka, atdheu!

Përzumë gjyshin nga fshati duke i premtuar jetë më të bukur në qytet.

I lam shtëpitë, i lam tokat që me mijëra vite kemi jetuar. Pastaj me pensionin e gjyshit në qytet blejmë dru, speca, mollë, dardhë nga Maqedonia; qumësht, mish nga Serbia; pula të kalbura nga Sllovenia, e keshtu me radhë...

Pastaj ankohemi se nuk na ngelen para as për cigare.

Me fal pak: gjyshi edhe duhanin e bënte vetë!

Pra, ne jemi gjenerata e kafeve, bareve, pubeve, si të duash i quaj.

Kjo është matematika më e thjeshtë që mund të bëjë në këto momente, kur shikoj këtu në Amerikë, se ai që merret me bujqësi dhe blegroti është njeriu më i respektuar, më i shëndetshëm dhe më i pasur!

Gjyshi jetoji afër 90 vjet bashkë me gjyshen. Kishte të gjithë fëmijët pranë, kishte kopshtin pranë, vëllain pranë, mikun pranë.

Ndërsa unë do jem shumë i lumtur nëse i kaloj të 50-tat me këto kimikate që ushqehem, dhe shpresoj që fëmijët e mi të vijnë të më shikojnë ndonjëherë...

Ndaj, tani gjej rastin t'i përshëndes të gjithë ata që e punojnë tokën! Puna është nder!

Ndiq linkun e mëposhtëm në Facebook për më shumë foto dhe komente nga Dibra...
https://www.facebook.com/dibra.debar.9

DITARI I NJË VAJZE...

"Mëjr"



I dashur ditar, ..si shkove? Hahaha.. bëj shaka, po kështu pyetet këtej nga ne. Kur i thanë një shoqes sime jabanxhie "si shkove?", ajo e shkreta tha: "Jo, në shpi ndejtëm sot gjithë ditën, nuk shkuam askund!"

Se meqë jemi këtu, s'e kam kuptuar asnjëherë se pse duhen pyetur nga dy herë njerëzit kur vijnë miq?! Futesh në dhomën e miqve, që për raste mbushen divanet plot me njerëz cep më cep, dhe duhet të bësh një skanim në të qindën e sekondës për të bërë klasifikimin sipas moshës dhe "rëndësisë". Pasi e ke bërë, duhet të shkosh plot entuziazëm t'u japësh dorën nga te më i vjetri:

-"Si shkove, a je mëjr?"
-"Mëjr me xhishin. Tëj mëjr?"
-"Mëjr."
Tjetrit në radhë:
-"Rabije mëjr?"
-"Mëjr. Tëj mëjr?"
-"Mëjr."
Tjetrit:
-"Si ia çove, mëjr?"
-"Mëjr. Vetë mëjr?
-"Mëjr."

...E kështu deri sa mbërrin te i fundit, që sipas rregullit i bie të jetë edhe më i parëndësishmi -më vjen keq ndonjëherë për të fundit, kur e mendoj. Por s'ka mbaruar aty! Pasi i re dhomës rrotull e rroke nja 20 e ca duar duhet të bësh pak mbrapa, që t'i inkuadrosh krejt miqtë në rrezen e vështrimit, dhe sipas rradhës së paracaktuar fillon prapë t'i pyesësh:

-"Mixha Dën, si shkove? A je mëjr? Ka shpëja?"
-"Mëjr me mixhën. Krejt mëjr shiçir. Tëj mëjr?"
-"Mëjr."
...
-"Lule si je tëj? Ka shpëja mëjr? Ata cull?"
-"Mëjr tibe. Pë tëj, mamin, babin, vllain... krejt mëjr?"
-"Mëjr jemi krejt."

Ndonjëherë gjithë këto mbivendosen, flasim njëherësh, se s'ka kohë! Është një dhomë plot që pret të pyetet e të përgjigjet.. "mëjr, mëjr". Kur mbërrin te ai i fundit, më pak i rëndësishmi.. të ka ik fryma krejt dhe fjala "mëjr" të bëhet psikozë kronike për 60 minutat e ardhshme.

Kështu ti ditar. Kaq për sot, se po fillova të të tregoj rradhët me rradhë të zakoneve tona duhen 1001 netë.

Ndiq linqet e mëposhtme në Web dhe Facebook për më shumë foto dhe komente nga Peshkopia e Dibra...
http://peshkopidiberalbania.wix.com
https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbania

Të jesh Derë e Parë, "Shtëpi e Parë" në Lurë është nder i madh, përgjegjësi e lartë, vështirësi sakrifikuese, pasi aty ka gjithato fise (degë fisesh) rrënjase e të ardhuna ndër shekuj.

Kurora e dytë e Lurës

Pamje nga Lura - Foto Ermal Lushi

Nga **Ramiz LUSHAJ**

1.

Zogu, Mbreti i Shqiptarëve, në një takim të thirrun në Tiranë në vitet '30 të shek. XX me krerë nga "Malet e Dibrës" e krejt Veriut iu drejtue atyne zyrtarisht me fjalët emblematike: "0 Male...!" E, Lura, qyshse nga Mesjeta, kryesisht në Principatën e Kastriotëve, siç theksohet edhe në veprën shkencore "Llesh Zef Doçi i Lurës..." (Nikollë Loka, ShB Emal. Tiranë, 2014) ishte një nga Nëntë Malet e Gegënisë, sikurse Dibra, Mati, Martaneshi, Kurbini, Fusha e Arbërit, Benda (Malësia e Krujës), Tomadhea (Malësia e Tiranës), Çermenika (f. 10) Lura përmendet si vend i lashtë i historisë iliro-shqiptare edhe nga autorë antik grekë e romakë si Polibi, Stefan Bizantini, Tit Livi dhe është i provuar si i tillë nga gjetje arkeologjike të derisotme. Në kit' vend u ngritën kala të kohës ilire e bizantine, si ajo "Illuri" e ndërtuar nga perandori romak me origjinë ilire Justiniani i Madh, e përshkruar nga Prokopi i Çezaresë, etj.

Dera e Doçit, si Derë e Parë e Kreu i "malit", "dheut" e "bajrakut" të Lurës, qyshse nga Epoka Skënderbegiane germëton e lartnon në histori, në istikame e anale të saj. Gojëdhana ligjëron e ujëvaron se kreu luras Prengë Nikollë Doçi ishte një ndër pjesëmarrësit e Kuvendit të Beslidhjes së Lezhës të 2 marsit 1444 (f. 64). Kjo edhe për faktin se Lura ishte e lidhun shumëfish me kryeheroin shqiptar, Skënderbeun, pasi nëpër trollin e saj etnik e epik rrugëtoi me ushtri të vet nga Dibra për në Bregdet. Në hulme legjendash i besohet rrëfimit e vizionit sikur kali i Skënderbeut i ka lanë ngultas në Qafë Lurë gjurmët e tij. Lura shihej si vend mjaft strategjik e fort bestar nga Skënderbeu, ndaj dimnave pa luftë e linte në Lurë një pjesë të madhe të ushtrisë së tij. E, përpos këtyne, aty, në livadhin e Xharrit, i farkëtonin armët. Lurasit ishin pjesë e historisë shumplanëshe të Skënderbeut, u rritën në vargbrezni me lavdinë e saj. Në etno-kulturën e Lurës ka ba vend Kanuni i Lekë Dukagjinit po nxenë vend edhe Kanuni i Skënderbeut.

Historiani mirditor e meritor, mrs. Nikollë Loka, në monografinë e tij historike, filozofike e kulturore "Llesh Zef Doçi i Lurës, forca e mendjes, pesha e fjalës" e skalit me penën e tij edhe një tjetër "varg/mal" të Lurës, atë të Derës të Doçit. Derë e Parë e Lurës. Përndryshe, nëpër shekuj, edhe kreu i Lurës.

Ky varg/mal lisnajë niston me Prengë Nikollë Doçin e epokës Skënderbegiane, me Llesh Nikollë Doçin, me Dodë Llesh Doçin, me Kolë Bush Doçin, me Bibë Kolë Doçin, me Doç Gjergj Doçin, me Llesh Preng Doçin, me Kolë Bibë Doçin...e dekteri tek Zef Llesh Doçi, që ndrroi jetë në fundshekullin XX, në dhjetor 1999, i përcjell me ritin e vajit: "... vet ke qënë një shqipe mali / t'pat rrit nana sokol djali / djalë i mençëm i shpisë Doçit / nip i mirë në derë t'Oroshit" (f.165). Dinastia lurase Doçi po ecë mirë, fort, shpejt edhe në shekullin e ri, XXI.

2.

Lura, si "Mal", "Dhe" apo "Bajrak" kishte Vetëqeverisje me inde e damarë ilir. Përngjashëm me aristokracinë ilire. Në truallin e saj kryesor e lartësor ishte "Kuvendi i Dheut të Lurës". Në periudhën e tretë osmane ishte Bajraktari, Menajt e Lurës. Institucion më vete. Nga ky trung genetik e kam njoft në vitet '90 të sojshmin Ramiz Mena, mbretnor i devotshëm. Ishin krerët. Kreu i Parë ishte Dera e Parë e Doçit, ndërkohë e ligjëruar edhe si "Derë Zabiti" tue marrë edhe fuqi ushtarake prej nga koha e Dodë Llesh Doçit dhe "Derë Vojvode" prej nga koha e Kolë Bibë Doçit. Lura kishte Pleqtë, plot dymbëdhjetë, një numër biblik, simbolik. Këta ishin "Parlamenti i Lurës", të cilët kishin çekiçët, mbështetës, këshilltarë. "Pleqtë me vulë" mbanin peshë të madhe. Pastaj ishin Dhetarët. Gjashtë gjithsej. Ishin "Senati i Lurës", me vendimmarrje të parevokueshme. Zgjidheshin rast pas rasti. Thirreshin edhe "Raja", "Shkopi i Dheut", etj. Një institucion tejet demokratik. Rradha vinin edhe esnafët e dorëzanët, etj.

Dera e Parë e Doçit, Kreu i Parë i Lurës, lyp/te jo veç me kanë në krye të vendit, po edhe me iu dalë në krye punëve të Lurës. Lypte me e përfaqësue në rolin e vet e me forcën e vet krahinën autonome etno-historike të Lurës jo vetëm në vendet për rreth si në Dibër e në Mirditë, në Lumë e në Mat, po edhe në evente (ndër)kombëtare.

Nga Dera e Doçit morën pjesë në kuvende ndërkrahinore, rajonale e kombëtare: Preng Nikollë Doçi mori pjesë në Beslidhjen e Lezhës (1444). Kolë Bush Doçi ishte një nga krerët firmëtarë në projektin politik të përbashkët për një Principatë të Veriut (sëbashku me Ali Menën, Dedë Vladin, Hasan Ajazin–daja i Preng Bibë Dodës të Mirditës, Ali Limanin). Bibë Kolë Doçi ishte një nga krerët lokal në kuvende e luftime në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), si dhe përfaqësues i Lurës në Kuvendin e Dibrës të vitit 1899. Major Gjon Bibë Doçi mori pjesë në Kuvendin e Lurës, të organizuar nga nacionalistët më 1-3 gusht 1943.

Veçojmë edhe Llesh Zef Doçin, misionar i Misionit të Pajtimit Mbarëkombëtar "Nënë Tereza", pjesmarrës në Kuvende të saj, i dekoruar me Urdhërin e Artë të Misionarit të Pajtimit. Ky ishte një përfaqësues dinjitar i Lurës e i Shqiptarisë. "Avokati i Lurës" e cilëson lurasi Osman Vladi (f.230). "E ndjente shumë sedrën e fisit", do të pohonte kusherini i tij, Skënder Doçi (f.225). "Ishte luras fisnik", e përcakton Mentor Muça, ish sekretar i Komitetit të Partisë të Dibrës (f.215). "Po e përseris se nga Llesh Doçi nuk i ka ardhë askujt ndonjë e keqe në Dibër, as sa një qime floku"- deklaron Hajri Hoxha, n'gjithato vite ish sekretar i Parë i Komitetit të Partisë të rrethit e kryetar i Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit, i cili, mes tjerash (f. 214) nënvizon prapë për lurasit: "Kam njohur gjatë viteve shumë kuadro nga Lura. Nuk mund të harroj Ahmet Përlekën, Llesh (Zef) Doçin, Murat dhe Halit Vladin, Lekë Rajtën dhe Nezir Bucin. Ata ishin të përkushtuar dhe gëzonin virtytet më të mira të malësorit".

3.

Të jesh Derë e Parë, "Shtëpi e Parë" në Lurë është nder i madh, përgjegjësi e lartë, vështirësi sakrifikuese, pasi aty ka gjithato fise (degë fisesh) rrënjase e të ardhuna ndër shekuj. Hysen Dervishi i Cerenit i etnon si "konaqe të Lurës" (disa grupime fisesh). Është konaku Doçi-Ajazi, Prija (e drejta e Kreut) - Haldeda, Bushkola, Markola, Nikolli, Bibëçupi, Gjikola e Duka-i mbështetur si vlla trojesh. Konaku Tollja – Mena (Bajraktari), Përleka, Kaçorri, Buci, Cuku, Batalli. Konaku i Vladit – Peka, Marlleshi, Gjoçi, Rajta, Skana, Koçeku. Konaku i Gjurrës – Nezha, Gjegja, Murati, Deda, Kalia, Kallaba. Konaku i Burijes: Kaçi, Hoti (të ardhun, edhe njëri nga liqenet e Lurës thirret liqeni i Hotit), Loka, Bruçi, Dodgjini.

Dera zamadhe e Doçit, paraardhësit e Llesh Zef Doçit të Lurës, ishin në krye të kryengritjeve, në ballë të betejave, i dhanë Lurës lavdi dhe gjakun e vet. Disa përfaqësues historik të kësaj Dere të shquar morën përmasa legjendare. Iu qëndruan në kambë kohnave nga ma të vështirat. Edhe në luftë me otomanët, edhe me sllavët, edhe në vitet e pushtimit fashist e komunizmit, edhe në kohën e sotme të demokracisë.

Kreu i Parë i Lurës, Dodë Llesh Doçi udhëhoqi kryengritjet lurase antiosmane në vitet 1707-1708 dhe 1712-1713 e Sulltani deshti me e burgos në Nish po e mbajtën e mbrojtën malet e veta, të cilat kanë lidhnajë toke të pandame vrri e bjeshkë, me njerëz fisnik e besnik. Kreu tjetër i Lurës, Kolë Bush Doçi udhëhoqi forcat luftarake të Lurës kundër ekspeditës turke të Hajredin Pashës në vitin 1843, etj.

Nga dera lavdiplote e Doçit të Lurës ka disa martirë të krahinës e kombit. Kreut luras Llesh Nikollë Doçit në luftën e "300 duvakëve" iu vranë në përpjekje me serbët dy vëllezërit: Deda e Gjoka. Një tjetër luftëtar i Derës së Parë të Doçit ishte Doç Gjergj Doçi, që u vra në luftë me serbët e varri i tij gjendet në shtetin e sotëm të Malit të Zi. Akti i tij u përjetua edhe në kangët historike: Ndal' kadalë o biri i shkinës / se këta janë djemtë e Shqipnisë" (f.76).Kreu i Lurës, Llesh Preng Doçi, stërgjyshi i Llesh Zef Gjetë Lleshit, u vra barbarisht nga serbët sëbashku me disa luras. Këta lisa luras i trupalidhën në lisa natyror, i torturuan, pas vrasjes i shpuan me bajoneta. Kreu vojvodë i Lurës, Kolë Bibë Doçi, luftoi si prijtar në luftën kundër serbëve në Kolesjan. Ma mbrapa, u vranë ma i pari ndër 108 malësorë të pafajshëm nga Lura, Reçi e Dardha. Kanga popullore ligjëron: Kush u vra për herë të parë / Çaj' Kolë Biba (Doçi) me të vëllanë" (f. 78).

Një luftëtar i shquar i Derës së Parë të Doçit ishte edhe Nikollë Keq Doçi u vra në mbrotje të Plavë-Gucisë në kohën e LSHP, në Luftën e Ultinës së Epërme të Limit (dhjetor 1879-janar 1880). Zyber Doçi me 30 bashkëluftëtarë luras u internuan nga austro-hungarezët në Kotorr (Mali i Zi), ku vdiq atje nga kushtet e randa të punës e të jetesës. Dera e madhe e Doçit të Lurës kishte edhe zyrtarin ushtarak e civil, martirin, Zef Bibë Doçi, Major në rezervë i kohës së Zogut, Krahinar i Lurës (1924-1939), arrestohet me luras të tjerë si Hakik Mena, Ibrahim Gjoçi, Dalip Kaçi, si edhe matjanë e dibranë,të cilët i lirojnë pas gjashtë muajsh, kurse Zefi vdiq i helmuar në spitalin e burgut më 20 korrik 1940.

Emblemë e engjëll mbrojtës i Derës së Parë të Doçit në kohën e komunizmit ishte Heroi i Popullit, Gjok Preng Doçi, i rritur jetim në sofrën e kullën e kushërinit Zef Bibë Doçi e Patër Zef Simonit, i shkolluar në Shkodër, ku bie në kontakt me idetë komuniste, lider të saj, e sakrifikon jetën për idealet e lirisë. Dha kontribute në Shkodër e Elbasan. Doli partizan në Çetën e Dumresë (1942) e u zgjodh për meritat e tij zv/komisar i saj (1943). Me 73 partizanë të Batalionit të Çermenikës inkuadrohet në Brigadën e Parë Sulmuese e në korrik 1943 caktohet komandant i Batalionit të Katërt të saj. Më 20 nëntor 1943 vritet në ballë të luftës në Mallakastër (f. 80-81).

4.

Llesh Zef Doçi i Lurës (1927-1999) ka një emër ripërtëritës të Derës së Doçit, një emër mbajenderës të fisit të vet. Si të thuash, është "Lleshi IV", që tanë jetën pati Paqe me Zotin, Pakt me Tokën, Besë me Njerëzit. Në gjallje të vet e pati përpara, ballas, lart emrin e vet, ndërsa në jetën e përtejme të tij na e la pas emrin e vet të mirë, të 'dritshëm, të ndjekshëm.

Në germafjalë të kësaj monografie 300 faqëshe veneroj se kah fillshekulli XVIII, ndoshta dhe ma herët, hyn e vjen në histori Llesh Nikollë Doçi (Lleshi I) i të rrallës "Luftë të 300 duvakëve" me jehonë deri në Stamboll e Rusi. Tjetri, "Lleshi II", Llesh Preng Doçi, stërgjyshi i tij, u vra nga serbët në vitin 1913 në Qafë të Mërkurthit, sëbashku me luras të tjerë: Isuf Ajazin, Isuf, Osman e Rrahman Bucin, Marku Ndue Markolën. "Lleshi III", nacionalisti Llesh Bibë Doçi (1905-1946) ka dek qëndrestarë në dy javë tortura të randa në burgjet komuniste e u rivarros me nderimet e kohës së re e fisit të vet të moçëm në ma të parin vit të demokracisë.

Në faqet e kësaj monografie të historianit Nikollë Loka gjejmë gjithato vlerësime nga bashkëkohës për figurën dijetare, qëndrestare e veprimtare të Llesh Zef Doçit. Ish kryetari lokalitetit të Sllovës, Halil Robi, jep një opinion përcaktor: "Llesh Zef Doçi ishte njeri dinamik, i aftë dhe i gatshëm të përballej me detyra e vështirësi" (f. 242). "Burrë dhe kuadër me personalitet", e portretizon Bardhok Gjikola, "Qytetar Nderi" i Rrëshenit.(f. 252). "Ishte burrë i drejtë" – thotë Halil Karahasani nga Kastrioti i Dibrës (f. 217). Bashkvendasi Bardhok Lekë Rajta, ing. elektro-energjitik, ish kuadër drejtues në Dibër, na flet (f. 259) për katër tipare të qytetarit Llesh Zef Doçi "i denjë, fisnik, burrëror e zemërgjërë".

5.

Kreu i Derës së Doçit me dy djemë të Vladit në kryeshekullin XVIII shkoi në Stamboll për "Dekën e Sulltanit", me marrë pjesë në ceremonitë përcjellore të tij. Aty, oborrtarët otomanë të sulltanit të vjetër e të riut në fron vnun re se Kreu i Lurës me të vetët nuk e uli flamurin në gjysmë shtizë sikur të tjerët në homazhet e atyshme. E dvetën ma mbrapa.

→

Dera e Parë e Doçit, kulla e tyre historike, ka nxjerrë mendtarë të shquar, që i kapërcejnë kufijtë e Lurës e krahinave për rreth, hyjnë në visare e vlera kombëtare shqiptare.



Pleqnari e Misionari Llesh Zef Doçi "ishte filozof popullor", sipas Mentor Muçës, "burrë humanist i një dere fisnike" sipas Nikollë Lokës, "Rilindas nga mendimet", sipas Pjetër Markut, kryetar i degës së Lidhjes të Shkrimtarëve e Artistëve të Mirditës, "ishte njeri shumë human", sipas Abdulla Zenelhasanit nga Dohoshishti i Dibrës, "njohës i mirë i Kanunit dhe i Traditës", sipas Sherif Pekës, kuadër drejtues në Lurë...

Llesh Zef Doçi - "burrë që i pat hije edhe vdekja".

Doçi i Lurës iu tha: Pse ka vdek Mbreti nuk ka vdek Kombi. Ne nuk e ulim flamurin" (f. 65-66). Fjala mori dhenë prej Shkupi në Shkodër, e dheu i tokës amësore arbnore tue ua pa edhe paritë e kreut e trimnitë e breznive iu dha kurorën simbolike "Sulltani i Lurës", ndryshe: "Doç Sulltana". Ky fakt burimon në gurra dokumentare edhe nga Nikollë Loka, Moisi Murra, Xheladin Ali Tollja, Ahmet Përleka, Ali Koçeku, Halit Doçi, etj.

Kjo simbolikë në çdo kohë ishte emblematike, reale, me domethanien e vet, me forcën, magjinë e madhështinë e vet. Jo veç kreu Llesh Nikollë Doçi i "Luftës së 300 bajrakëve" apo djali i tij pasardhës, Dodë Llesh Doçi, ishin "Sulltan i Lurës" po dekteri edhe Llesh Zef Doçi e pesë djemtë e tij: Gjeta, Prenga, Doda, Gjoni, Deda, po edhe Mark Zef Doçi me djemtë Zef e Ndue e vajzat: Pashkë, Rutë, Prenë e Mrikë janë të tillë. Edhe sot, janë një "Sulltan" apo"Sulltanat" modern, pasunar, kulturor, qytetar. Llesh Zef Doçi ishte një "Sulltan", jo në kuptimin otoman e konceptimin komunist, po në realitete e akte të pavarësisë së tij dhe në qëndrime e veprime përballë Kohës, Antivlerave, Antinjeriut. Ai erdhi e iku nga kjo botë i tillë: "Sulltan" i kullës së vet, i trollit të vet luras, i qëndresave kundër klaneve oktapode e (ri)ngritjeve të madhërishme. Si gjithmonë. Dje. Sot. Nesër.

Kulla e kreut Llesh Zef Doçi i ka në mbajemendje për mirë Nikollë Ndue Vorfin, nipin e gjyshes së vet nanëmadhe, përkushtuese e sakrifikuese; familjet e Xhemë Dullë Vladit apo ato të Tahir Abaz Vladit e Ali Han Vladit; shtëpitë e Dodës në Tejmollë e të Çokut në Lajthizë; kusherinjtë e vet si Bibë Kolës, Can Doçit, Ahmet Doçit, etj. Me thanë të drejtën historiani i penës dimensionale e veprave kombëtare, Nikollë Loka, ka ba mirë që ia përmend shoqërinë e afërt brenda krahinës Llesh Zef Doçit, ku veçojmë: Ahmet Pekën, Çup Ali Çupin, Zenel Musën në Armallë; Abaz Zyber Bucin në Vlashaj, Ali Hamid Vladin e Mehmet Xhetan Ajazin në Sumaj. Shoqërinë jashtë Lurës si Ramadan Can Pogën prej Tejmolle, Zenel Dodën nga lagjja Dodaj, Gjon Çokun prej Lajthize, etj. Shoqërinë në qendrën e rrethit si Jashar Menzelxhiun, Mentor Muçën, Selim Alliun, Lekë Rajtën, etj. Ai, ndër Doçët e vet, kishte ma afri edhe shoqërore me Halitin e Gjon Doçit, me Skënder Doçin, Can Doçin, Dedë Doçin, etj.

Autobiografi e Llesh Zef Doçit janë edhe gjithato fjalë vlerësuese për kontributet e atributet e tij, që aq me vend e rend na i përcjell Nikollë Loka në kit' monografi të vyer. Prof.dr. Bashkim Lleshi tek gazeta "Rruga e Arbërit" (Tiranë, nr. 4, 12 prill 2007) mirë gdhend portretin e tij: "Llesh Zefi (Doçi), kryetar i lokalitetit në Zallë-Dardhë, si malësor i drejtë dhe i ndershëm që ishte në sistemin e kaluar ka pasur dhe përplasje e peripeci të shumta, po malësorët e atune anëve ma kishin përshkruar portretin e tij ashtu siç ishte, një burrë i gjatë, me trup të fuqishëm, trim, tëzgjuar dhe mikpritës". "Lleshi ruante tiparet e të parëve tanë", thotë Dedë Doçi (f. 238)."Përballonte situata të vështira", thotë Eshref Visha i Cerenit (f.241). "Llesh Zef Doçi ishte dalluar për zgjuarësi natyrore"thotë Ali Koçeku në monografinë e tij për Lurën. Hajri Hoxha, kuadër i lartë e i shumëkohshëm në Dibër për aktin ekstrem klanor të përjashtimit të tij nga PPSH dokumenton se "Llesh Doçi u ndëshkua padrejtësisht, një dukuri që ka ndodhur edhe me shokë të tjerë" (f. 191), kurse Mentor Muça, ish sekretar i Parë i Dibrës thekson: "Jemi takuar shpesh se na lidhte puna, kemi pirë kafe së bashku, madje e bëra mik dhe e ftova në shtëpi, duke e vlerësuar për burrërinë dhe fisnikërinë që kishte" (f. 191) dhe vijon ma tej: "Llesh Zef Doçi është ngritur në detyrë për meritat e tij. Na folën që ishte burrë i zoti dhe i zgjuar. Nuk ishte e lehtë të gjendeshin drejtues të aftë në atë periudhë. Lleshi ishte provuar në aktivitete dhe shokët e rrethit nxorën përfundimin se kishte aftësi të mira drejtuese... Për mendimin tim Lleshi u ndëshkua nga sinqeriteti i madh, vetëm për burrëri e karakter... Një nga vërejtjet tona ishte kjo: të gjitha gjërat kërkonte t'i zgjidhte me mirëkuptim. Lleshi kishte një parim: ta gjejë nga ndonjë tjetër..."f. 215-216).

Personalitetit Llesh Zef Doçi i hijeshon vepra si pleqnar e misionar, pasi është rrit në një trevë me tolerancë mes fiseve të shumta të atyshme, në mes hormonisë të feve katolike e muslimane, ku ngultojnë edhe breza shehlerësh. Shembulli ma domethanës është ajo e figurës emblematike të Shpalljes së Pavarësisë, zv/kryeministrit të parë të saj, Don Nikollë Kaçorri, i luras, që e kishte babën katolik e nanën muslimane. Kapedani i shquar i Mirditës, Bibë Dodë Pasha, i krishterë, u martue në Lurë me çikën mulimane, Hiden e Hasan Ajazit nga Arrmalla. Brezat e Doçit të Lurës, të rritun në mes muslimanëve, ky i sotmi, i kanë dy halla të martueme në shtëpi muslimane, etj. Tradita shqiptare vazhdon nga para koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit deri tek epoka e antarësimit të Shqipërisë në NATO e në Bashkimin Europian.

6.

Pak ditë pas Pavarësisë së Shqipërisë, më 23 dhjetor 1912, u hap në mjedise të kishës shkolla e parë shqipe në Lurë e mësues i parë i saj ishte martiri i kombit, Kolë Bibë Doçi, veprimtaria patriotike arsimdashëse e të cilit kishte marrë jehonë deri në Vjenë, Bullgari, Stamboll, etj. Gazeta "Drita" në Sofje (Bullgari) shkruante se "shpërndaheshin libra shqip edhe në Lurë" (30 nëntor 1901). Ippen, Konsulli Austro-Hungarez në Shkodër e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë se në mars 1902 ndër krerët e Dibrës që morën pjesë në një mbledhje për arsimin në Shehër ishte edhe Kolë Bibë Doçi nga Lura dhe aty u vendos "të ngrejnë shkolla shqipe në vatrat e tyre" (f. 77).

Bash në trungun e Llesh Zef Gjet Llesh Preng Doçit është edhe Lekë Gjet Llesh Preng Doçi, (Lekë Margjini) i shkolluar në Orosh, të cilin me kërkesë të Car Ferdinandit etj. Abati i Mirditës, Prend Doçi, e çoi në Sofje të Bullgarisë. Atje, në Pallatin Mbretëror, i mësoi Shqipen princit Boris të Bullgarisë, tevona Mbreti Boris III i Bullgarisë. Asokohe i ndoqi studimet ushtarake e mori graden kapiten dhe në kit' cilësi ishte një nga oficerët mbrojtës të Kongresit të Lushnjës, emigroi në Itali bashkë me Bahri Omarin, u martue me çikën e atdhetarit korçar, Sotir Pecit, shërbeu si Nënprefekt i Strugës (1941), u burgos nga gjermanët në Kampin e prishtinës (1943), e jetën e mbylli si cigareshitës pranë kinema "Majestikut".

Historia përseritet në Derën e Doçit të Lurës, pasi një nga trashëgimtarët ma të shquar të saj, Llesh Zef Doçi në vitet e pas çlirimit do të ishte ndër mësuesit e parë të Lurës. Mbasandejna në shkollën e Lajthizës, në Arrëmallë (Sheshdoçe), në Fushë Lurë, e drejtor shkolle në Brezhdan. Ai kishte marrë arsimim të mirë në shkollën e Oroshit, pasi aty kishte mësues si Prenk Jakova, viheshin në sekën drama të Molierit, etj. Vazhdoi Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë (1953-1955), ku nuk ia mundësuan as shkuarjen me studime në Bashkimin Sovjetik. Ndër vite ishte zyrtar i shtetit si kryetar lokaliteti në Lurë, Kastriot, Sllovë, Zallë-Dardhë, si edhe në seksionit e financës të Komitetit Ekzekutiv të Dibrës, etj. Ky intelektual shumëdimensional punoi edhe punëtor krahu e kreu edhe sipërmarrje pune për të mbajt lart emnin e begatinë e kullës së tij e të Derës së Doçit, me u mbrojt nga mbyllja e shtigjeve nga hjekësi e ligësi klanore të kohës, me iu dhanë rrugë fëmijëve të vet e të vllait, Markut, që të dy sëbashku ishin nji, si model i vllaut për vlla. Fisniku dinjitar e përballës, Llesh Zef Doçi gjithë jetën e tij u ndie krenar për zonjën e vet, Dilën e Gjokë Ndoit të Mërkurthit e të Marës të Marcerajve në Bisakë të Fanit, fis i parë i këtij bajraku të njohur. Jo rastësisht të dy kishin një datëlindje, veçse Lleshi dy vite ma i madh. Edhe Dila në moshën 89 vjeçare ndihet e privilegjuar, e rinuar, e lumturuar nga emri i Derës së Doçit, nga atributet e të shoqit, Llesh Zef Doçi, nga përkujdesjet e fëmijëve e të nipave e mbesave të saj.

Llesh Zef Doçi ishte "ndër nxënësit më të mirë të shkollës së Oroshit", kujton shoku i tij i kësaj shkolle, Gjergj Bibë Lala (f. 212). "Mësuesi i përjetshëm", e çertifikon avokati Nikoll Kola (f. 247), ndërsa Mal Cani, kreu i Misionit të Pajtimit Mbarëkombëtar "Nënë Tereza", përcakton se "do të përmendet gjatë në dardhë" (f.244). Gazetari e telekronisti i Mirditës, Xhelal Marku, jep detaje e tipare të tij: "Lleshi e ruajti me fanatizëm të madh mënyrën estetike të veshjes, me një stil të veçantë, që i shkonte shumë me atë fizik që kishte. Atëherë kur pardesytë e bardha ishin të rralla në treg, Llesh Zefi do të gjente patjetër pardesynë e tij sepse ishte i fiksuar në estetikën e veshjes... Shtatëlartë si lisat e atij vendi (Lurës), estetik në veshje, i fjalës e muhabetit, i matur, i mençur, i arsimuar, por edhe me një zgjuarësi natyrale për t'u admiruar nga të gjithë"(f. 253).

7.

Dera e Parë e Doçit, kulla e tyre historike, ka nxjerrë mendtarë të shquar, që i kapërcejnë kufijtë e Lurës e krahinave për rreth, hyjnë në visare e vlera kombëtare shqiptare.

Në Dibër të Epërme përmendet "Kanuni i Bibë Kolë Doçit", na dijenon Nikollë Loka në veprën e tij tue na e dhanë portretin e tij si "shumë i zgjuar dhe dallohej për ndarje pleqësishë jo vetëm në Lurë, por edhe në Dibër, Mat, Lumë dhe Mirditë.Shumë krahina për për çdo konflikt të vështirë për t'u zgjidhur merrnin Bibë Kolën" (f. 75). Studiuesi Ali Koçeku në monografinë e tij për Lurën thotë se në atë kohë se "S'ka lind burrë në këto zona që të jetë i zgjuar si Bibë Kola". Xheladin Ali Tollia në monografinë e tij për Lurën dokumenton se "T'u bëftë goja si Bibë Kolë Doçi, thuhet edhe sot në Dibër".

Nikollë Loka i ka pjek dy (krye)fjalë në ballinën e veprës për Llesh Zef Doçin teksa e medaliaon mrekullisht e hyjnisht si "forca e mendjes, pesha e fjalës". Në kit' amë, përgjatë kësaj rrjedhe, ecën me penën si daltë e artë në tana ato faqe e kapituj të këtij libri kushtim meritor. Ai na e mirë paraqet si Llesh Zef Doçin si "Pleqnar" e "Misionar". Na jep shembuj konkret. Na sjell urtësi prej tij. Ai na ka lanë mjaft fjalë të arta, apo si jemi mësue t'i quajmë "fjalë të urta". Të gjitha këto, të mbledha nga Nikollë Loka, të rrëfyera nga Osman Vladi, Zef Mark Doçi, Bardhok Rajta, Nikoll Kola, Gjokë Beci, Ruta Legisi (Doçi), etj. kanë vendin e rolin e vet në fondin kombëtar shqiptar. Nikollë Loka e të tjerët na e dëshmojnë edhe një tipar të përhershëm të Llesh Zef Doçit: humanizmin e tij, që e manifestoi deri në ditët e fundit të jetës së tij.

Pleqnari e Misionari Llesh Zef Doçi "ishte filozof popullor", sipas Mentor Muçës (f. 95), "burrë humanist i një dere fisnike" sipas Nikollë Lokës (f. 95), "Rilindas nga mendimet", sipas Pjetër Markut, kryetar i degës së Lidhjes të Shkrimtarëve e Artistëve të Mirditës (f. 219), "ishte njeri shumë human", sipas Abdulla Zenelhasanit nga dehoshishti i Dibrës (f. 240), "njohës i mirë i Kanunit dhe i Traditës", sipas Sherif Pekës, kuadër drejtues në Lurë (f.257), etj.

Kaherë i kisha thanë historianit Nikollë Loka se kam me shkrue për librat e tu, shumë sish të nivelit kombëtar. Para disa ditësh ma dhuroi dorazi monografinë shkencore "Llesh Zef Doçi i Lurës, forca e mendjes, pesha e fjalës", me redaktore Ruta Doçi (Legisi) e recensent Ramiz Lushaj. I thashë se sot ma ke pru prapë të gjallë para syve e përballë kohës atdhetarin Llesh Zef Doçi i Lurës, një lis i madh edhe në kohë të vështira, një pleqnar i fortë e misionar i lartë, tek i cili flinte mendja e ndritte mirësia...E pata njoft qyshse në vitet '70 në Fierzën e dritës, kur kish ardhë me i pa njerëzit e vet e veprën. Asokohe punoja zyrtarisht me rinënë e tropojës e Fierzës e vullnetarisht me shtypin e Tiranës. I pata folë mirë për djalin e tij, Dodën, fisnik e gjallnik, i përkushtuar ndaj punës, shkollimit, veprimtarive. Zemra iu ba sa 12 liqenet e Lurës. Ai ishte njeri që mbante forcë, i vnonte bisedës skaj e majë, ishte njeri tek i cili mund të peshoje me besë e shpresë. I qëndroi kohës në kambë edhe kur ajo i ndejti jo rrallë mbi krye. Ai, Llesh Zef Doçi i Lurës, si e germagrand Nikollë Loka, ishte "burrë që i pat hije edhe vdekja" (f. 164), pasi në varrimin e tij mortor madhështor kishin ardhë malet e Malësive, lisa e lisnaja të kohënave, nga metropoli i Tiranës e shtete e treva shqiptare në Ballkan, aq sa i tërhjeki edhe disa danesë të merrnin pjesë në homazhe. Ata kujtonin se ceremonia në Kodër Kamëz ishte për ndonjë personalitet të lartë shtetëror e jo për një pensionist, për një lis dinast të Derës të Doçit të Lurës, ndaj në një gazetë daneze botuan shkrimin "Vdekja e një njeriu të pushtetshëm pa pushtet". (Rrëfim nga Ruta Doçi-Legisi, f. 165).

Dera e Parë e Doçit të Lurës është dinasti kreu, parie, misionare e mendjes, pushkës, penës, me lisa të mëdhenj në mbi gjashtë shekuj, në kohë të vështira, me rrënjë e degë të fisme nga Prengë Nikollë Doçi deri tek Llesh Zef Doçi me pasardhësit e tij dinjitar. Janë lisnajë. Këta, sëbashku me lisat epope e epokal nga luftëtarët luras të Skënderbeut e të Lekë Dukagjinit, të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e të Pejës, të kryengritjeve e luftërave kundërosmane e kundërsllave, nga Sheh Murati i Parë i Lurës deri tek Don Nikollë Kaçorri i Pavarësisë, e dhjetra të tjerë, më përngjasojnë me lisa, me lisnajë të një "Kurore të Dytë të Lurës", që ma të lartit mal natyror të Lurës (mbi 2.100 metra lartësi mbidetare), malit "Kurora e Lurës", ia shton bukurinë, fisnikërinë e madhështinë.

Tiranë, 28 maj 2014

Në prag të 75-vjetorit të lindjes më 18.05.1939 – 18.05.2014

Dëshmi pune... dëshmi drite...

Aviatori i parë dibran – Allaman Isaku, njeriu me medalje për punën dhe fisnikërinë

Nga **Melvud BUCI**

Ethjeshtë dhe gjurmëlënëse jeta e njeriut bëhet kur ajo ka brenda saj mirësitë, përkushtimin, shpirtin e bardhë, bulat e djersës e të diturisë. Çdo kohë e çdo brez, çdo njeri i çdo moshe qoftë, sikur i rrezaton më fort jetës, kur lartëson vlerat, gjurmët e punës e të dritës, gjurmët e vështirësive e të sakrificave njerëzore. Muaj më parë tek po bisedonim në një mjedis shokësh, miku im i nderuar Demir Osmani më tha: "Mundësisht shkruani pak radhë për Allaman Isakun! Unë heshta dhe nëpërmjet përkuljes së kokës i dhashë të kuptojë se do të përpiqesha. Fjala e shokut m'u ngul thellë në mendësinë time, sepse pasqyrimi i punës dhe udhëve të jetës të një aviatori veteran sikurse Allaman Destan Isaku i Dovolanit nuk është e lehtë. Për të, sigurisht nuk mund të thuhen të gjitha në caqet e një shkrimi të thjeshtë si ky yni, por ia vlejnë faqe të tëra librash dhe ndoshta janë pak.

* * *

Babai, Destani, nëna Shyqyrie Isaku (Skarra) si dhe kultura e traditat e trashëguara nga gjyshi Allamani (emrin e të cilit mban Allamani i ri), kultura e dajave: Skarrës së Shpukthit bën që Allamani të edukohej me virtyte e tipare të larta si respekti maturia, urtësia, nderimi për të afërt e shokët, bujaria e zelli për dituri.

Ngaqë babai Destani punonte tokat tek miku i tij Dalip Skarra dhe përkohësisht ndihmonte bashkë me gruan Shyqyrien qe larguar nga Dovolani kështu që Allamani lindi në Shpukth (më 18.05.1939). shkollën fillore, Allamani e fillon në Dovolan, klasën e V e përfundoi në Shupenzë, kurse në klasën e 6-të më 1952 vjen në Tiranë.

Të mesmen "Skënderbej" e filloi më 20 gusht 1952 dhe e përfundoi më 1957. Kudo dallohej për zell në mësime, disiplinë dhe urtësi. Edhe sot e kësaj dite kujton mësuest që e mësuan dhe edukuan në fëmijëri si Haki Jahja nga Tirana, Vjollca Çitozi nga Elbasani, Hamit Manjani nga Shupenza, mësuesit nga Shkodra...!

Dhe mbaron shkollën "Skënderbej" më 1957 niset për studime për pilot në Bashkimin Sovjetik në qytetin Borisogleps të rrethit Vorenjezh.U dallua si student, ku shpërfaq shembullin e tij në mësime dhe disiplinë në veprimtari dhe zbatimin e përpiktë të rregullores së shkollës.

Në vitin 1960, në nëntor, sapo mbaroi 10 ditë leje në vendlindje, filloi detyrën e nderuar të pilotit në Kuçovë (aso kohe qyteti "Stalin"), ku për 18 vite rresht do të shërbente me devotshmëri si pulot e deri në komisar skuadrilje.

Me pasionin e kuadrit të specialistit të devotshëm Allaman Isaku u burrërua përkrah shokëve në udhët e qiellit amtar, gjithnjë korrekt, i dashur, virtuoz, njeri i shembullit e i fjalës, pilot i përkushtuar në detyrat e aviacionit. Kudo që mësoi e punoi Allaman Isaku nuk i shqiti nga goja e zemra bashkëfshatërt e nderuar të Dovolanit, dajat Skarret e Shpukthit, kujtimet e dasmës në Selane, urtësitë e odave e bukuritë e fjalëve të mençurisë të të urtëve popullorë, shtigjet e udhët e vendlindjes e tashmë edhe traditat e miqve të tij nga Zleusha e Përmetit. Më 6 gusht 1967 piloti i Kuçovës, biri i Dovolanit, u martua me bijën e Zlushës së Përmetit, mësuesen e nderuar Drita Mustafa Beqiri. Dasmën e bëri në Dovalan. Kujtimet tashmë blerojnë çdo kohë, ata kanë lënë mbresa në shpirtin e tij. Bashkëshortja Drita e cila e ndihmoi dhe shoqëroi kudo është motra e dy dëshmorëve të lirisë Iljaz beqiri që ra më 17 nëntor 1944 dhe Halil që ra në Përmet. Allaman Isaku kurdoherë u dallua si specialsit pilot i vendosur, si mjeshtër i avionit e i papërtuar dhe guximtar. Gjithnjë, siç e thotë edhe vetë – mësoi nga librat, nga shokët, nga jeta e nga vështirësitë.

Allaman Isaku

Pasi përfundoi dy vjet shkollën e lartë të Partisë emërohet në Vlorë, por e refuzoi.

Filloi në Laprakë më 1977 deri më 1989 ku shërbeu si komandant. Janë të shumtë shokët e nderuar të cilët kujton Allamani si Nikë Hoxhën, birin e Tragjasit Gjeneral Alfred Moisiu, Bardhyl Laçi, Sokrat prifti, Hazbi Serani, Fari bubsi, Tomorr Abdia, Bilal Sina, Sefedin Tomçini, Qirako Dhimo, Teli Dedi, Shyqyri Balla e plot të tjerë.

Kujton sot me krenari shokët, aviatorët dëshmorë, ngjarje, episode heroizmi e gramë jete në shërbim të atdheut. Në emisionin "Kështu ka nddohur" tek News 24", në gazetën "Shekulli", "Telegraf" etj., është shkruar edhe për aviatorin e parë dibran, për këtë bir të thjeshtë, i cili vërtet ishte dhe mbeti në kujtesë si pilot i përkushtuar, shokë i palodhur i shqiponjave të qiellit, bir i aviacionit kombëtar. Kujton sot aktin e Bilal Sinës, aktin heroik të Sefedin Tomçinit, Sabri Toçi, Hazbi Seranit, Shyqyri Ballës (heronj të aviacionit kombëtar) e sytë sikur i jnomën nga krenaria. Kur fluturoi Bilal Sina, Allamani ishte komisar skuadrilje, ndihmës i udhëheqësit të fluturimit të regjimentit për elitën. Bilali jep në radio "Mua m'u fik motori. Nuk ndizet". Ishte në 6 mijë metra lartësi. udhëheqësi i fluturimit Bardhyl Laçi i tha: Përgatitu për t'u hedhur. Hidhu! Mjetet nuk komunikonin. Vazhdon një terr për pilotin në ajër, se ku do të vjerë apo ku do të digjet. Mbas manovrash arriti të ulet në brezin jeshil sepse ju hapën vetëm dy rrotat e mbrapmbe. E hundës (përpara) ngeli i fikësuar pa u hapur... Shokët e rrethuan, e uruan e përqafuan. Manovrimi i Bilalit qe jnë guxim heroik, një vetmohim i vërtetë, - përfundon Allamani.

Kurdohetë i vendosur, i përpiktë, parimor e gjithnjë i lidhur me punën, me shokët, me familjen, shoqërinë e miqësinë, dashamir e vullnet fortë. Ngase nuk u vinte mirë korrektësia e tij disa sigurimsave monistë në muajin prill 1989 Allaman Isaku përjashtohet nga PPSH-ja. (Në atë periudhë quhej pushkatim politik, sipas mendësisë ekstremiste të kohës).

Allamani kurdoherë respektoi e nderoi vëllezërit, motrat, fëmijët së bashku me Dritën. Vëllezërit Lutfiu, Basriu (ndjesë pastë), Basriu (i dytë), Ramazani (ndjesë pastë), Avniu e kanë dashur e respektuar. Edhe fëmijët e Allamanit ecin në gjurmët e familjes Isaku si djali Drini edhe vajza Valbona, ata mishërojnë kulturën dibrane dhe përmetare kurdoherë të thjeshtë e të përkushtuar në udhët e emigracionit në Gjermani (Drini) dhe në Amerikë (Valbona)...

Allaman Isaku (majtas) Agim Vodopi (shkodran) Borisogleps Rusi (1957-1960.

- Allaman Isaku u burrërua përkrah shokëve në udhët e qiellit amtar, gjithnjë korrekt, i dashur, virtuoz, njeri i shembullit e i fjalës, pilot i përkushtuar në detyrat e aviacionit.

- Ky aviator i nderuar është kurdoherë aktiv, i respektuar. Kujton me nderim Dovolanin, Maqellarën, Shpukthin, Dibrën e vendet ku fluturoi anekënd atdheut.

Nga viti 1980 deri më 1989, Allamani punoi pilot në aerodromin e Laprakës, në skuadrën e avionëve për spërkatjen e tokave bujqësore. Karriera e tij mban 1900 orë fluturimi. Ka fluturuar, kryesisht me avionë reaktivë MIG-15, MIG-17 dhe MIG-19 në funksionet e komandantit të çiftit, të katërshes dhe komisar skuadrileje.

Rastet dhe aktet humane, fluturimet në ditë të vështira anëkënd atdheut, gadishmëria dhe guximi i këtij piloti veteran flasin për shpirtin e vetmohimit në detyrë.

* * *

Më 18 prill 1989 doli në pension. 34 vjet fluturime (në fakt ka 57 vjet pune në librezë sepse në reaktiv sipas ligjit 1 vit pune quhej dy sepse ka fluturar me reaktiv 20 vjet, në frontin më të vështirë.

Ky aviator i nderuar është kurdoherë aktiv, i respektuar. Kujton me nderim Dovolanin, Maqellarën, Shpukthin, Dibrën e vendet ku fluturoi anëkënd atdheut. Intelektualë të shquar të Isakëve si Munir Isaku, kushëriri i parë ish kryetar kooperative në Dovolan, Maqellarë, Shupenzë, Fadil, Afrim e Lavdërim Isaku e plot të tjerë i ka si idhuj të paharruar.

Banon në rrugën "Shyqyri Bërxolli" pranë rrugës "Çamëria" afër PTT – Qendrore të Tiranës. Gjithnjë i lidhur me njerëzit, i thjeshtë e i respektuar. Ndonëse pensionist, Allamani, është aktiv, i lidhur ngushtë me ngjarjet, lagjen, me traditat e familjes e të fisit. Më 18 maj 2014 mbush plot 75 vjeç. Urime Allaman Isaku, piloti i parë dibran! Koha dhe breznitë do të nderojnë gjurmët e djersës, gjurmët e fisnikërisë njerëzore, kjo do të rrezatojë e do të lumturojë ata që krenohen me brezat e djersës e të sakrificave për detyrat në shërbim të atdheut. E thjeshtë, por e bukur dhe e madhërishme, gjurmëlënëse: Allaman Isaku – aviatori i parë dibran. Dëshmi pune, dëshmi drite...

vendlindje

Komuna Zerqan

Nga **Destan RAMA**

Shtrihet në jugperëndim të Dibrës, e vëndosur mbi një taracë të bukur plot livadhe të gjelbërta,në këmbët e Malit të Vogël.I përket njësisë fiziko-gjeografike te Krahinës Malore Qendrore dhe karakterizohet nga një reliev kodrinor i valëzuar,i cili përshkohet nga ujëra të shumta,veçanerisht ajo që quhet ana e Ftohësinës,dhe që derdhen në basenin ujëmbledhës të Drinit të Zi.

Një pjesë të mirë të territorit të komunës Zerqan e zë lugina e Grykës së Madhe që shtrihet në të dy anët e Zallit të Bulqizës me zgjatimin perëndimlindje.Në shpatet veriore dhe jugore të maleve që e rrethojnë luginën,janë vendosur fshatrat;P eladhi,Godvi,Krajkë,Sofraçan,që përbejnë anen e "Shullanit" dhe Valikardhë,Zerqan,Sopot,Zall-Sopot,Strikçan e Zall-Strikçan që përbëjnë anën e "Ftohësinës".Më në thellësi,në jug,në pjesën malore të komunës,ndodhen fshatrat Tërnovë e Madhe,Tërnovë e Vogël dhe Smollik në lartësinë 1000m mbi nivelin e detit.Të gjithë këto fshatra së bashku përbëjnë territorin administrativ të komunës Zerqan.

Në tërësi komuna shtrihet nga 330 m mbi nivelin e detit,në luginën e zallit,deri në 1000 m mbi nivelin e detit të fshatrave të sipërcituar.Malet më të lartë të komunës Zerqan janë ai i Temlës,Kazjakut dhe Vervjakut,që arrijnë në lartësinë deri në 1800 m.Komuna e Zerqanit shtrihet në një sipërfaqe prej 127.5 km2 ,me një popullsi 5207 banorë,me 1470 familje.Fshatrat me numër më të madh banorësh e familjesh janë Sopoti me 980 banorë e 274 familje,Valikardhë me 932 banorë e 264 familje.

Komuna Zerqan

Qendra e komunës është fshati Zerqan,një fshat me emër të madh.Këtë emër e ka marrë që me 28 nëntor 1912,kur u bë qendër nënprefekturë,e deri në ditët e sotme.Ky fshat ka një largësi rreth 17 km nga qendra e rrethit Bulqize.Degëzimi nga Rruga e Arbrit,(Ura e Qytetit) e deri në Zerqan ka një gjatësi prej 6.3 km,rrugë e asfaltuar.Po kështu qendra e komunës Zerqan ka dalje në lindje të fshatit, me rrugë automobilistike në drejtimin e prefektures Peshkopi nëpërmjet aksit rrugor të vjetër Zerqan-Libaraz-Zall-Sopot-Tre Çezmat,5.1 km, në të cilin vazhdojnë punimet për asfaltimin e tij.Pozicionimi në qendër të rrethit Bulqizë,në të dy anët e luginës ku kalon Rruga e Arbrit e bëjnë këtë komunë nyje të rëndësishme administrative, social-ekonomike dhe etno-kulturore,jo vetëm për rrethin e Bulqizës,por edhe më gjërë,e kthejnë atë në traditë,ku kalonte rruga që lidhte dikur Dibrën e Madhe me Ktrujën e më tej.

Komuna e Zerqanit është e pasur me pyje dhe kullota.Ato zënë një sipërfaqe prej 3763,5 ha.Këta përbëjnë atë që quhet "Mushkërri e natyrës së mrekullueshme të kesaj zone".Plani strategjik i hartuar për menaxhimin e pyjeve dhe të kullotave të komunës Zerqan(2013-2030),do të ndikojë në fuqizimin ekonomik të çdo familjeje zerqanase.

Në një bisedë të bërë me kryetarin e komunës Zerqan,z. Defrim Fiku,mësojmë se kjo komunë ka mjaft resurse ,që me shfrytëzimin e tyre,banorët e zonës nxjerrin të ardhura ekonomike.Përveç sektorëve të blegtorisë,pemëtarisë,bujqësisë,blet arisë janë edhe shfrytezimi i këtyre resurseve të masivit malor.Këtu ka rezerva ujërash të bollshëm e të pashtershëm,që rrjedhin nga lartësitë e maleve,duke krijuar kështu mundësinë e ndërtimit të HC-ve lokale,krijimin e rezervateve të rritjes së peshkut,prodhimit të pijeve freskuese.Në këto male,-vazhdon bisedën kryetari,-ka rezerva bimësh të shumëllojshme etero-vajore e medicinale.Krijohen mundësi të mëdha për turizmin klimaterik veror dhe atë sportiv dimëror.Nëntoka e këtyre maleve është e pasur me rezerva kromi(Valikardhë) e mangani(Godvi),të pashfrytëzuara.Brenda territorit të komunës ka masiv të mëdha guri gëlqeror,veçanërisht në anën e Shullanit,për prodhimin e gëlqeres e deri në atë të çimentos.Në pasurinë hidrike të komunës Zerqan një vënd të rëndësishëm zënë Tre Çezmat e Sofraçanit.Ky burim shte shpallur monument natyre.Uji i tyre është shumë i pastër dhe i mirë, me vlera të larta hidrike. Gjithashtu në qendër të komunës ka burime ujore me tregues bio-kimike që rrallëkund ndeshen.

Po kështu kemi pikën natyrore tek "Zabeli i Madh"me biodiversitet bimor të admirueshëm për çdo vizitor.Kjo krahinë është mjaft e pasur me vende historike të cilat mbajnë vulën e luftës për liri të brezave me pushtuesit e tradhtaret e kombit.Vjen e gjallë në imagjinatën tonë rropama e rrokullisjes së gurëve nga Temla për të zënë poshtë çallmaxhinjtë turq,tek Ura e Qytetit,vjen e gjallë krisma e pushkëve dhe e mitralozëve në betejën tek Shkëmbi i Sofraçanit,tek Shkëmbi i Hoxhëve,tek Shkëmbi i Kullës, tek Gurët e Skenderbeut,në Varret e Vrame,apo besëlidhja me bacë Bajramin,në Shpellën e Dhoksit.

Në fushën e etnografisë, Zerqani bashkë me Bulqizën, përbëjnë një njësi etnografike më vete. Veshja e jashtme karakterizohet nga një shumëllojshmëri ngjyrash të ndezura dhe të harmonizuara bukur.Në to dominuese janë dy ngjyra;kuq e zi.E kuqe me shirita të zi(spajka)dhe e zezë me shirita të kuq,si ngjyrat e flamurit,janë veshja e vajzës dhe e nuses zerqanase e bulqizake.Ndërsa veshja e burrave ruan elementë simbolike që nga koha e Skënderbeut.

Kësaj veshjeje me ylberë në trup,do t'ia kishin zilinë etnografët me profesionistë vendës dhe të huaj. Këtu e perfundon bisedën kryetari.

Këta vite janë karakterizuar,krahas arritjeve të tjera edhe me veprimtari të larmishme social-kulturorë,të cilat kanë gjallëruar jetën e komunitetit të kësaj komune.Si të tilla kujtohen: Festimi madhështor i 117-vjetorit të celjes së shkollës së parë shqipe,si edhe një session shkencor për problemet e historisë te arsimit të kësaj treve.Sponsorizimi dhe promovimi i disa librave të autorëve vendas dhe i veprimtarive për të nderuar figura të intelektualëve të shquar të krahinës.Dhënia tituj nderi dhe mirënjohjeje për personalitete të fushave të ndryshme të krahinës.Mbeshtetje për shkollat e komunës,për vizita në qytetet historike dhe veprimtari të shumta social-kulturore. Por mbi te gjitha mbetet shërbimi komunitar që i ofrohet komunitetit.

Ky shërbim realizohet nëpërmjet një administrate prej 10 vetësh që shërbejnë në zyrat e komunës dhe mbulojnë shërbimet që u takojnë.Defrim Fiku,kryetari i komunës,Naim Xhaferri,sekretari i këshillit të komunës,Mensur Zogu,përgjegjës i zyrës së shërbimeve,Florenc Përvizi,përgjegjës i zyrës së taksave,Kujtime Hidri,përgjegjëse e zyrës së financës,Vasfije Kurti,përgjegjëse e zyrës së ndihmës ekonomike,Arif Hyka,agronom komune,Bujar Balla,inspektor i ndihmës ekonomike,Eduart Pervizi,polic komune,Julian Lika,përgjegjës i zyrës së gjendjes civile.

Ndër objektivat strategjike sektoriale të planifikuar në "Planin strategjik të zhvillimit"do të lexosh:Shtimi në masën 20 % i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.Rritja e të ardhurave nëpërmjet menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore.Përmirësimi i infrastrukturës në masen 85 %.Rritja e cilësisë së shërbimit arsimor dhe shëndetësor.Promovimi i vlerave më të mira kulturore e historike,tradicionale në mënyrë profesionale dhe te strukturuara.

Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve me aftesi profesionale.Menaxhimi me eficencë e transparencë i fondeve publike etj.Mbushesh me shpresë,besim e optimizëm për një të ardhme më të mirë,për një jetë të lumtur e gëzimplotë të banorëve të këtij komuniteti.E ardhmja jonë do të ndryshojë duke qenë në autorë dhe aktore të këtij ndryshimi,-thuhet në mesazhin përmbyllës të planit strategjik të komunës Zerqan.

BULQIZË

Një nënë 55 vjeçare me katër fëmijë jetimë, në përballje me mbijetesën e familjes

20 maji, dita e fëmijëve jetimë, ishte shtysa për të shkruar pak radhë për një nënë 55 vjeçe, që bën gjithçka mundet për të rritur 4 fëmijët e saj të mbetur jetimë.

Zgjodha pikërisht këtë ditë për të bërë një vizitë në familjen e saj, kjo edhe si një detyrim në kuadër të kësaj dite, por edhe si një obligim për të nga ana e bashkëshortes sime që e kishte patur atë shoqe shkolle të fëmijërisë.

Drita Pjetri, nëna 55 vjeçare e katër fëmijëve të mbetur jetimë, banore e fshatit Sopot të komunës Zerqan, në rrethin e Bulqizës, përballet aktualisht me sfidën e mbijetesës të familjes në varfëri ekstreme.

Derën e shtëpisë së saj e gjejmë të mbyllur. –Dritën kërkoni, na thotë komshia e saj. -E keni duke punuar në kopësht.

Veshur krejt në të zeza, pasi para dy vitesh bashkëshorti i saj, Bajrami, kishte humbur jetën gjatë punës në një nga galeritë e minierës së Bulqizës, na fton sipas zakonit të mikpritjes për kafe.

Para dy viteve, nis e tregon ajo, bashkëshorti humbi jetën teksa punonte në një nga galeritë e minierës.

Rroga e burrit ishte e vetmja e ardhur ekonomike për familjen tonë. Mbetur krejt e vetme me katër fëmijë jetimë, Hyseni, Suela, Zuria dhe Klodiani, qe varijojnë nga 15 deri në 21 vjeç, në mungesë pothuajse totale të të ardhurave ekonomike, i është dashur të përballojë me vështirësi të medha, mbijetesen e familjes së saj prej pesë anëtarësh.

Sipas Dritës, e vetmja e ardhur ekonomike për këtë familje prej pesë anëtarësh, është vetëm ndihma ekonomike prej 40 mijë lekësh të vjetër që komuna jep për të, si dhe ndonjë lek që merr djali i madh, Klodiani, kur punon ndonjë ditë për mbledhjen e gurëve të kromit në galerinë e minierës ku humbi jetën i ati. Familja disponon edhe rreth 2 dynim tokë, por prej saj nuk merret prodhim, pasi është në të thatë pa ujë vaditës. Ajo që bën përshtypje mbetet fakti se asnjë nga të paktët 3 fëmijët jetimë edhe pse vazhdojnë shkollën, nuk gëzojn të drejtën e marrjes nga shteti të pensionit të babait të vrarë në galeritë e minierës së kromit në Bulqizë.

Kjo ka bërë që fëmijët të mos vazhdojnë arsimin e mesëm, për mungesë parash për tu blerë libra e fletore si dhe për tu siguruar transport e veshmbathje, si bashkmoshatarët e tyre, thotë me ngashërim Drita.

H.L

Disa të dhëna historike
për teqen bektashianel Bllacë

Teqja bektashiane Bllacë, vatër e patriotizmit dhe atdhedashurisë

Nga **Xhelal ROÇI**

Fshati Bllacë bënë pjesë në Malin e Grykës së Vogël, në njërin nga nëntë Malet e Dibrës, në perëndim të reshjes së lumit Drini i Zi.

Fshati ndodhet në një gropë tektonike e rrethuar me male e kodra të ndërtuar me formacione gëlqerore të formuara në periudhat para historike të triasit. Ai është i ndërtuar rrëzë malit të Bllacës, në pjesën veriore, ndërsa tokat e fshatit ndodhen në pjesën linrore dhe jugore, kryesisht fushë.

Nga lindja dhe juglindja Bllaca kufizohet me fshatin Zogjej, kufiri në mes dy fshatrave kalon nëpër disa kodra që vijnë në zbritje dhe janë të pyllëzuar me drurë lisi të degraduara. Në anën juglindore, rrëzë kodrës së pyllëzuar me dru lisi ndodhet Teqja bektashiane, objektet e ndërtesat ku banojnë personeli i teqes, ndërsa Tylbja është e ndërtuar në majën e kodrës që ndan fshatin Bllacë me Zogjet, ku ndodhen edhe varrezat e fshatit Bllacë.

Bllaca njihet qendër e hershme banimi. Banorët e mëparshëm të këtij fshati ishin të fesë së krishterë, ortodokse. Kjo vërtetohet nga defteri turk i regjistrimit të tokës të vitit 1467 por edhe nga fakti se në një majë kodre në pjesën jugore të fshatit e cila është pika më e lartë se kodrat përreth, ndodhen rrënojat e një kishe, banorët vendas e emërtojnë "Maja e kishës" dhe këtu ndahet fshati Kovoshicë, me fshatin Bllacë. Gjatë shekullit VII dhe deri nga fillimi i shekullit XVIII banorët e fshatrave përreth dhe Bllacës nën ndikimin e pushteusve osmanë u kthyen nga të krishterë në besimin fetar mysliman. Kjo vërtetohet edhe nga kënga popullore:

"Dervish Pasha nëpër Grykë vogël e Luzni Prish kisha e ngre xhami...".

Teqja e Dervish Çaush Çanges.
Foto: Shpetim Cami

- Banorët e Bllacës e përqafuan shpejt fenë islame
- Bllacasit asnjëherë nuk janë bashkuar e nuk kanë bashkëpunuar me okupatorët e pushtuesit e vendit, ata i kanë vënë në grykën e pushkës. Disa prej banorëve të këtij fshati kanë bërë emër të mirë e kanë treguar heroizma e trimëri në luftë kundër pushtuesve në epoka të ndryshme historike.

BANORËT E BLLACËS E PËRQAFUAN SHPEJT FENË ISLAME

Bllaca ka toka të përshtatshme për bujqësi, është e rrethuar nga male e kodra të pyllëzuara, kullotat janë të pasura me bar, këto pasuri natyrore dhe klima kontinentale me verë të freskët dhe me dimër të ftohtë e bëjën të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë, sidomos të bagëtrive të imta. Por periudhën e verës në fshat njihet mungesa e ujit për të vaditur tokat bujqësore.

Ashtu si në fshatrat e tjerë të Malit të Grykës së Vogël edhe në Bllacë kanë ardhur e janë larguar okupatorë të ushtrive pushtuese osmane, serbe dhe deri të pushtuesve të fundit fashistëve italianë e nazistëve gjermanë.

Bllacasit asnjëherë nuk janë bashkuar e nuk kanë bashkëpunuar me okupatorët e pushtuesit e vendit, ata i kanë vënë në grykën e pushkës. Disa prej banorëve të këtij fshati kanë bërë emër të mirë e kanë treguar heroizma e trimëri në luftë kundër pushtuesve në epoka të ndryshme historike.

Në vitin 1913 u vranë nga ushtritë serbe Hysen Tasha, Ismail Krosi e të tjerë. Pushteusit serbë therën me thika burra, gra e fëmijë dhe plaçkitën bagëtitë e çfarë gjetën në fshatin Bllacë e në fshatra të tjerë përreth. Bllacasit kanë qenë atdhetarë e patriotë, ata nuk kanë kursyer asgjë për interesat e kombit. Kjo u konkretizua edhe gjatë luftës antifashsite Nacionalçlirimtare.

Nga ky fshat disa bij të tij u lidhën dhe u hodhën në radhët e ushtrisë partizane nacionalçlirimtare. Disa prej tyre dhanë jetën në lulen e rinisë e sot jnihen dëshmorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Të tillë ishin Man Jolla, Aqif Zeneli e të tjerë.

Në këtë veprimtari patriotike dhe atdhetare në të gjitha epokat por edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare është përfshirë edhe teqja Bektashiane Bllacë. Ajo u bë strehë për partizanët dhe për furnizimin me bukë e ushqime të tyre gjatë gjithë periudhës së luftës. Për këtë përmendet edhe në historikun e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit dibran.

I pari Baba i sektit fetar bektashian ka qenë Baba Sufa i vjetër, banor i këtij fshati. Baba Sufa i parë shkonte me delet e tij, më pas krijoi familjen e tij, u martua. Ai kishte dhunti dhe shenjtëri të lartë. Një ditë i erdhën disa fshatarë dhe po bisedonin me të nën hijen e një peme, ndërsa vëllezërit e tij po prashisnin misrin në arë. Ai u jepte rradhazi kutinë e duhanit miqve, kjo gjë u ra në sy vëllezërev dhe njëri prej tyre tha: Ne blej duhan me para dhe ky jep të tjerëve. Baba Sufa i dëgjoi fjalët e të vëllait por nuk foli. Pasi ikën miqtë erdhën mbas një gjysmë ore fshatarë nga fshati Zogje me një varg duhani në dorë i cili peshonte mbi një kg.

Baba Sufa mund të jetë veshur me petkun e shenjtë në faqen e e Haxhi Bektashit, Veliut. Një ditë ai i hipi kalit dhe shkoi në qytetin e Dibrës së Madhe. Aty diku ul në një kafe, përpara në tavolinë kishte një gotë alkool. Kjo gjë u ra në sy xhandarëve dhe ata e raportuan te komandanti i tyre, i cili ishte në atë kohë komandant i xhandarmërisë Hysen Kukeli. Ai i vajti me disa xhandarë në kafe Babë Sufës dhe i tha: "Përse po pini alkool, a e dini se është i ndaluar nga sheriati?".

Baba Sufa iu përgjigj se s'është alkool, është ujë, provojeni gotën. Ai e provoi dhe vërtet iu duk ujë. Më pas Baba Sufa – i tha – merre këtë shishen dhe mbusheni me ujë në çezëm. Ata mbasi e mbushën shishen ia dhanë përsëri Babë Sufës, merre, i tha komandantit provoje, mbasi e mori shishen komandanti dhe e provoi iu duk alkool.

Me këtë Babë Sufa tergonte shenjtësinë e tij dhe jo se pinte alkoolin. Shenjtorët e njohën njëri-tjetrin. Baba Sufa jetonte me tokat e Hoxhollit i cili ishte sundimtar në qytetin e Dibrës së Madhe. Baba Sufa ishte njeri i ditur, i edukuar, korrekt në marrëdhënie me cilindo, i pajisur me dije fetare islame dhe kishte pirë hyjnor. Ai në disa raste kishte dhënë prova bamirësie por neve në këtë material do të përmendim vetëm dy raste.

Një natë, në atë periudhë kohe, Baba Sufa, shkoi për të bujtur në shtëpinë e Selim Krenës në fshatin Sopot. Ky nuk kishte fëmijë. Gjatë bisedës ku ishin të pranishëm disa njerëz, vetë Selimi dhe të pranishmit ju lutën Baba Sufës të jepte një nefez Selimit, që të kishte një djalë. Aty ishte i pranishëm dhe një baba tjetër. Të gjithë së bashku iu lutën Zotit dhe ia vunë emrin Jashar. Baba Sufa i tha Selimit. – Ty Zoti do të të falë jnë djalë, por nuk do të jetë për ty, por për xhihanin. Për këtë ka edhe një këngë që këndohet në krahinat e Grykës së Madhe dhe të Grykës së Vogël.

Baba Sufa i vjetër dikur kalonte rrugës nëpër fshatin Sofraçan. Ai vinte nga fshati Sopot dhe do të shkonte në vendlindjen e tij, në Bllacë. Në Sofraçan shikon disa burra që ishin mbledhur përpara shtëpisë së Fejzulla Nucit, banor i këtij fshati. Ata po diskutonin se kujt i takonin pronat e Fejzës, mbasi ky nuk kishte fëmijë as të tij por nuk kishte as të afërt për t'i trashëguar, mbasi ishte shtëpi e vetme.

Fejza jetonte bashkë me të shoqen të moshuar dhe kërkonin të mbështeteshin tek ndonjëri për të kaluar ditët e pleqërisë. Ai që do të merrte në pronësi tokat e zabelet e tij do të kujdesej për jetesën e tyre dhe për varrimin. Baba Sufa pyeti se për çfarë po grinden ata burra?

Njëri nga pjesëtarët i dha shpjegimin e nevojshëm. Baba Sufa tha: "U thoni atyre, lëreni atë punë dhe mos u merrni me atë bisedë, ma leni mua se do ta rregulloj unë. Baba Sufa mori një kokërr mollë, mbasi bëri disa veprime fetare, lutje Zotit, ai e ndau mollën përgjysmë dhe jua dha ta hanë Fejzulla Nucit dhe të shoqes. Mbas nëntë muajsh Fejza lindi djalin Bejazitin. Bejaziti u rrit dhe lindi Muharremin, Muharremi Veliun dhe ky i fundit dy djemtë, Mexhitin e Hakiun e në kohët e tanishme ata janë bërë disa shtëpi.

Mbas Babë Sufës së parë erdhi Baba Sufa i dytë, lindur po në fisin Tasha, në fshatin Bllacë, nipi i Baba Sufës së parë. Ky quhej Isuf Veli Tasha, datëlindje ekzakte nuk dihet por duhet të jetë rreth viteve 1858-1860. Mësimet në gjuhën turke i kreu në Stamboll. Në vendlindje erdhi i veshur Dervish, nga Baba Jeshar Krena i Teqes së Martaneshit, pikërisht ai që gjyshi i tij, Bab Sufa i parë i vuri emrin akoma pa lindur. Mbasi shërbeu për disa kohë në teqen Bektashiane të Martaneshit, Baba Jeshari i dha ixhazet, dervish Sufës që të ngrinte një Teqe Bektashiane në fshatin Bllacë duke i dhënë këto porosi:

- Shiko bir, unë po të jap leje që ti të hapësh Teqe në fshatin Bllacë në rrethin Dibër, që ti të ndezësh çirakë Bab Sufës së vjetër. Unë do të gjej dekret, por me këtë konditë: me që ti je afër bahçes time, duhet që të kesh kujdes, ti e pasardhësit e tu që të mos të ndërhyjnë në bahçen time si hak. Ti e ke të drejtë nga Bllaca, Zogje, Shupenza e nga fshatra të tjerë të Grykës së Vogël, kurse nga bahçja ime Sofraçan, Krajkë, Gotvi, Peladhi, Sopot, Strikçan, Zerqan, Valikardhë, do të kesh të drejtë vetëm për ndonjë plak ose plakë që nuk ka mundësi të vijë në Martanesh për t'ia bërë vetëm izmetin. Edhe këto veprime me dijeninë e Teqes në rast se nuk e mban këtë konditë dhe pasardhësit e tu paçin veten në qafë! Kështu edhe ata që do t'ju pasojnë ju, kësaj të fundit mos ia pafshin hajrin. Kështu ia dha dekretin Baba Jeshari, e dërgoi vetë në post dhe i bëri llokum.

Dervish Sufa u bë Baba i Teqes së Bllacës dhe u quajt Baba Sufa i II vend ku ndodhet aktualisht dhe filloi të kryejë aktiitetin ekonomik dhe shërbesat fetare.

Baba Isufi II mori ustallarë dhe filloi që t'i ndërtojë tyrbe Babës Sufë së parë në kodër sipër. Kryeustai i tha: "Edhe ky Babai prish paratë kot, këtu në zabel.

Në këtë kohë filloi të fryjë erë e fortë, si ciklon ku ngre pluhur dhe ashkla. Ustallarët e lanë punën dhe shkuan tek Babai edhe i treguan atij ç'u ndodhi. Ai i këshilloi duke u thënë: "Ç'u duhet juve se ç'bëj unë, unë po ju paguaj sa keni dashur, dhe i dërgoi vetë te puna. Teqja e Bllacës krijoi pronat e saj, ara, livadhe dhe zabele me jnë sipërfaqe afër 10 hektarë e cila shfrytëzohej për nevojat e Teqesë.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

homazh

Me rastin e 35 vjetorit të ndarjes nga jeta

Mbi kontributin e gjeologut **Koço Gushi** në vendburimin e kromit Bulqizë

Nga **Bashkim LLESHI**
Sali BUSHI

Më 22 maj të këtij viti u mbushën 35 vjet që u nda nga jeta inxhinjer gjeologu i Ndërmarjes Gjeologjike të Bulqizës, Koço Gushi. Për këtëpara disa ditësh më vjen në studion time të punës, shoku i tij i vjetër i shkollës së lartë dhe i punës, gjeologu i vjetër matjan Sali Bushi me një letër në dorë ku kishte të shënuara disa nga projektet, raportet dhe studimet e inxhinjerittëvjetër gjirokastrit Koço Gushit.Unë, më thotëSaliu, kam menduar që së bashku të shruajmë diçka për kontributin e kolegut tonë të vjetër të Bulqizës që u nda para kohe nga jeta. E prita me shumë dashamirësi propozimin e kolegut tim të vjetër dhe të dy së bashku u përpoqëm të sistemojmëpunën dhe kontributin e tij të madh si inxhinjer gjeolog zbulues nëvendburimin e kromit Bulqizë.

Koço Gushi ka lindur në Gjirokastër nga një familje qytetare gjirokastrite. Arsimin 7 vjeçar e të mesëm i ka kryer në qytetin e tij të lindjes. Në gjysmën e dytë të viteve pesëdhjetë, pa filluar akoma shkollën e lartë, filloi punën si ekonomist në fillim në gjeologjinë e Rubikut dhe më vonë në Ekspeditën Gjeologjike të Bulqizës me kryetar ekspedite Suat Ishmin. Në vitin 1958 filloi shkollën e lartë për inxhinjer gjeolog të cilën e mbaroi në qershor të vitit 1963. Praktikat mësimore e të prodhimit gjatë shkollës së lartë i kryente nëGjeologjinë e Bulqizës që tani ishte kthyer nga Ekspeditë në Ndërmarje. Edhe gjatë pushimeve të verës ai vinte në Bulqizë dhe punonte me gjeologët sovjetikë. Ai përfitoi nga puna e kujdesëshme sistematike dhe eksperienca e gjeologëve sovjetikë dhe këtë punë sistematike e vazhdoi edhe pasi e emëruan menjëherëpas pas mbarimit tëstudimeve, Inxhinjer gjeolog nëvendburimin e kromit Bulqizë tëNdërmarjes Gjeologjike të Bulqizës.Në gjeologjinë e Bulqizës ishte vetëm një gjeolog dibran, Sefedin Qorlaze i cili ishte emëruar kryegjeolog i ndërmarjes. Me punën e tij të kujdesëshme e sistematike, Koço u njoh me vendburimin e kromit të Bulqizës dhe shumë shpejt u bë një nga gjeologët më të mirë të këtij vendburimi. Që në vitin 1963 e deri në vitin 1979 kur u nda nga jeta,për gati 17 vite rrjesht, ai ka udhëhequr projektet e kërkimzbulimit të vendburimit të kromit Bulqizë, projektin e punimeve të zonës ndërmjetëse Bulqizë Batër, të punimeve të Traverbankut të Klosit e të Zonës veriore të Bulqizës, ka qenë autori kryesor iRaporteve gjeologjike me llogaritje rezervash të vendburimit të kromit Bulqizë të viteve 1961-1968 dhe 1968-1973. Ai ka marrë pjesë në sesione shkencore të Ndërmarjes Gjeologjike të Bulqizës e të Institutit të Gjeologjisë me referate e kumtesa për ligjësitë e përhapjes e të formimit të mineralit të kromit në vendburimin e Bulqizës e shfaqjet e kromit për rreth tij, për vendosjen në hapsirë të këtij mineralizimi, etj. Në vitin 1971 kreu studimin perspektiv mbi kërkimin e fushave të reja të mineralit të kromit në vendburimin ekzistues Bulqizë, sqarimin e thellësisë si fushë xeherore, strukturë e re apo,Lindor i II-të, si dhe vazhdimi i mëtejshëm i zbulimit në vetë vendburimin kromifer Bulqizë. Nëkorrik tëvitit1974 ka përfunduar studimin "Ligjësitë e vendosjes së mineralizimit kromifer në vendburimet Bulqizë-Batër". Mbështetur në këtë studim dhe studimin e gjeologëve të Batrës, Shadan Stërmasi e Simon Duni "Zhvillimi i strukturave të reja dhe perspektive të vendburimit Batër" u përpilua projekti i zonës ndërmjet Bulqizës dhe Batrës si rezultat i të cilit u arrit bashkimi i këtyre dy vendburimeve në një strukturë të vetme të rrudhosur.

Kam patur fatin e mirë që të punoj me gjeologun Koço Gushi në vendburimin e Bulqizës për gati 8 vite rrjesht nga viti 1970 deri në vitin 1977 kur u largova nga Bulqiza, nga të cilat 6 vite kam punuar në një zyrë, në vendburimin e Bulqizës.

Me kontributin e madh të gjelogut Koço Gushi dhe gjeologëve të tjerë që kanë punuar në vendburimin e Bulqizës në vitet gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë e tetëdhjetë si, Virgjil Buda, Ahmet Demi, Sefedin Qorlaze, Xhelil Karkanaqe, Mikel Spiro, Islam Zyka, Bashkim Lleshi, Sali Bushi, Agim Dobi, Irakli Premti, Besnik Balla, Gjyze Myrtezai, Selim Muça, Androkli Lole, Hasan Hajdari, Gani Gurra, Sefedin Shabani, Bashkim Jahja, Nexhat Hysa, Veip Gjoni, Sabri Hoti, Haki Sula, Vesel Hoxha, Ilir Alliu, Miltiadh Prendi (kimist), Adil Alku, Naim Karaj, Mustafa Manjani,

Koço Gushi 1962

Koço Gushi e Nexhat Lami,Bulqizë viti 1970

Saim Keta,Sulejman Alia, Leonard Kazanxhi, Besnik Kola, Fitim Isaku, etj. dhe teknikëve të vjetër e me ekperiencë si, Vangjush Popllo, Sabri Lita, Thoma Laro, Fotaq Lula, Nexhat Lami, Enver Vorfi, Foto Bulo, Theodhor Kolloshi, Qemal Ribaj, Dilaver Miftari, Arif Nesimi, Sheraf Selimi, Hysni Tahiri, Naim Muça, Mihal Qiqi, Nazif Aga, Adli Baholli, Ramazan Paci, Dogjan Dervishi, Aristidh Paguni, Bilal Skapi, Ali Spahiu, Ymer Toluli, Ahmedan Shkurta, Peme Murati, Fatmir Alla, Kalosh Dedja, Skënder Likalla,Isa Mandri,Bashkim Nurçja, Sherife Boduri, Vjollca Snalla etj. vendburimi i kromit Bulqizë u kthye në vendburimet unikale jo vetëm europiane por edhe botërore.Këtu nuk mund të lemë pa përmendur edhe gjeologët që kanë punuar në Shërbimin gjeologjik të Minjerës së Bulqizës ndër vite si, Mitro Zhupa, Gudar Toto, Jorgo Kola, Todi Sema, Namik Myrtezai, Niko Nano, Ymer Tonuzi e të tjerë më të rinj, që me kontributin e tyre kanë ndihmuar në orientimin e drejtë të punimeve të kërkimit të Minierës, në skjarimin e strukturës së rrudhosur të vendburimit, ngritjen në kategori të rezervave dhe shtimin e tyre. Kontribut të madh kanë dhënë edhe drejtuesit e Ndërmarjes, Ekspeditës Bulqizë dhe specialistët e shpimit e brigadjerët, si : Ferit Alla, Tosum Spahiu, Islam Islami, Mexhit Shehu, Ismail Losha,Isuf Latifi, Bajram Puca,Sami Strazimiri,Ali Hida,Selim Isaku, Lutfi Demi, Kiço Karabina, Robert Stoja,Bashkim Duva, Bajram Alla, Ali Allmeta, Rahman Boba, Pal Bilaçi, Hasan Losha, Hysen Hida, Rakip Karaj, Hazis Hoxha,Muharem Hoxha, Selim Baloshi, Mehmet Basha,Rizvan Kozi,Haxhi Guzja,AsllanTruka,Hekuran Mustafaj, Vladimir Murrja, Petrit Jashari,MusaZeneli,Mehmet Alliu,Ndue Lleshi, Maqo

Jakoel, Luan Leka, Rustem Laçi,OsmanLala, etj.

Në sajë të kontributit të Koço Gushit dhe gjithë gjeologëve të tjerë që kanë punuar në vendburimin e kromit Bulqizë u arrit që në vitet shtatëdhjetë e tetëdhjetë të zbuloheshin në vendburimin e Bulqizës, çdo vit mbi 1 miljon ton rezerva kromi dhe Miniera arriti të prodhojë në fund të viteve tetëdhjetë afro 500 000 ton mineral kromi në vit.

Mbështëtur në kontributin e gjeologëve të Bulqizës e të Batrës u arrittë lidhet struktura e të dy vendburimeve duke u kthyer në një strukturëtë madhe tërrudhosur me rëndësi unikale, botërore.

Mbështetur në këto rezerva dhe në perspektivën e hapur për t'i shtuar ato, projektuesit e Minierës së Bulqizës e të Batrës nën drejtimin e projektuesit të vjetër e talentuar Inxhinjer Mark Boriçi, arritën të projektojnë punimet kapitale që lidhin Bulqizën me Batrën, puset që lidhin këtohorizonte deri në travebankun e Klosit dhe punimet në thellësi të Bulqizës, me synim, eliminimin e transportit të mineralit nga sipërfaqja dhe kalimin në transportin nëntokësor nga Batra e thellësia e Bulqizës, nëpërmjet traverbankut të Klosit deri në Impiantin (Fabrikën) e pasurimit të Klosit nga ku do të transportohej me hekurudhë nga Klosi për në Portin e Durrësit e Ferrokromin në Elbasan.

Me forcimin e grupeve të mineraleve dobishme në ISPGJM Tiranë, Koço Gushin e kërkuam për të punuar në grupin e kromit të këtij Instituti. Nëmesin e muajit maj të vitit 1979 me propozim të drejtorisë Gjeologjike tëMIM, Koço Gushi u emërua nga Byroja e Partisë së Rrethit të Dibrës Kryegjeolog i Ndërmarjes Gjeologjike të Bulqizës. Në fillim të muajit maj të vitit 1979 mori pjesë në Sesionin shkencor të ISPGJ i ftuar me

cilësinë e kryegjeologut të ndërmarjes

më të madhe gjeologjike që punonte për mineralin e kromit në vendburimin e Bulqizës.

Së bashku me bashkëshorten e tij Eli Gushi, drejtoreshë e Ndërmarjes së Furnizimit të Punëtorëve Bulqizë, ato rritën dhe edukuan dy vajza të mbrekullueshme,të cilat tani janë rritur dhe kanë krijuar familjet e tyre, Snezhjanën dhe Blerinën. Në kohën kur familja, kishte aq shumë nevojë përbashkëshortin dhe babain e tyre shumë të dashur, kur shokët kishin nevojë

Koço Gushi në rrjeshtin e parë majtas. Në të djathtë, Sefedin Qorlaze. Sesioni shkencor i ISPGJM në Tiranë, maj 1979

> Do të ishte në nderin e Bulqizës që të propozohej e miratohej "Qytetar Nderi" edhe gjeologu gjirokastrit Koço Gushi për kontributin që ka dhënë në Gjeologjinë e Bulqizës, për 17 vite rrjesht deri sa u nda nga jeta. Puna, sakrifica dhe kontributi i tij nuk do të harrohen kurrë nga kolegët...

për kolegun e tyre korekt e punëtor, Koço Gushi u nda nga jeta para kohe nga njëgjendje depresioni, më 22 maj të vitit 1979. Organet e Partisë e të Pushtetit nëRreth e Rajon, duke mos e njohur si duhet punën dhe kontributin e tij, mbështetur në rrethanat e pa qarta nga të cilat u nda nga jeta, kishin dhënë porosi që të mos shkojë asnjë nga kolektivi në varrim. Kështu gjeologu i vjetër dhe i talentuar Koço Gushi u përcoll për në banesën e fundit vetëm nga familja dhe dy shokë të gjeologjisë, Foto Bulo e Sabedin Toluli. Unë duke qenë me punë në ISPGJM në Tiranë, në ditën qëështëndarë nga jeta e është varrosur Koço Gushi, kam qenë me shërbim nëzonën e Kolonjës, me grupin e Hartës Gjeologjike në shkallë 1:200 000. Vetëm kur jam kthyer nga shërbimi në Institut, pas tre ditësh mora vesh për ndarjen e parakohëshme nga jeta të kolegut tim të vjetër të Bulqizës. Duke e njohur mirë nga afër në punë, i bindur se tronditja e tij psikologjike nuk kishte lidhje me punën, pas dy ditësh u nisa me shërbim për në Bulqizë dhe shkova në familjen e tij për ngushëllime. Pas një jave më vijnë në zyrën time në Tiranë, dy operativë të rinj të Degës së Punëve të Brendëshme të Peshkopisë. Si fytyrë i kisha parë por me emra asnjerin nuk e njihja. E kuptova menjëherë se përse kishin ardhur. Pasi u prezantuan më thanë; *"Ne kemi ardhur nga Peshkopia që t'ju pyesim se si e keni njohur në punë Koço Gushin, meqënëse keni punuar gjatë me të në Bulqizë "*

Unë pa e zgjatur shumë u thashë : *"Koço Gushin e kam njohur në punë, kam punuar disa vite në një zyrë dhe kam mësuar e përfituar nga eksperienca e tij. Sikur të kishim edhe një gjeolog tjetër në vendburimin e Bulqizës si Koço Gushi, nuk do të kishim nevojë të mbanim 5-6 gjeologë për të ndjekur punimet e kërkimzbulimit të vendburimit të Bulqizës"*Me këtë përgjigje pasi u dhashë një kafe u ndava me opertivët e ardhur nga Peshkopia.

Pas një jave po këto operativë shkojnë dhe takojnë në Krastëtë Martaneshit,Sali Bushin,ish kryegjelogun që i kishte dorëzuar detyrën Koços. Edhe Saliu pa e ditur përgjigjen që kishin marrë nga unë në Tiranë, pasi e kishin pyetur u kishte dhënë pothuajse po të njëjtën përgjigje të dërguarve të degës. Më vonë organet e shtetit nuk u muarëm më me Koço Gushin.

Vitet e fundit, Bashkia e Bulqizës ka propozuar dhe miratuar për "Qytetar Nderi", disa kuadro që kanë punuar e kontribuar në Minierën dhe qytetin e Bulqizës, por nga kuadrot e Gjeologjisë, deri tani asnjë nuk e ka marrë këtë titull nderi.

Do të ishte në nderin e Bulqizës që të propozohej e miratohej "Qytetar Nderi" edhe gjeologu gjirokastrit Koço Gushi për kontributin që ka dhënë në Gjeologjinë e Bulqizës, për 17 vite rrjesht deri sa u nda nga jeta. Puna, sakrifica dhe kontributi i tij nuk do të harrohen kurrë nga kolegët me të cilët ka punuar dhe nga kolektivi i gjeologëve dhe sondistëve të Gjeologjisë së Bulqizës.

Tiranë më 20 maj 2014



Gjithë dashuria e Ambrës...

Ajo shfaqet në një video të shkurtër. Vetëm 3 minuta. Quhet Ambra Meda. Është vajza që prej muajsh po lufton me sëmundjen në një spital të Mynihut. Këmbëngulja e familjarëve të saj, miqve dhe shokëve, por veçanërisht vullneti i saj për ta mundur sëmundjen, ia arriti të mblidhte që në fillim mijëra shqiptarë në një fushatë për mbledhjen e fondeve për pagesën e operacionit, por tani është qeveria gjermane që ka marrë përsipër gjithë shpenzimet e kurimit.

Ambra iu nënshtrua operacionit më të vështirë më 26 maj dhe katër ditë më parë, ajo gjeti guximin që në një video tre minutëshe të na prekë të gjithëve. Video e saj, e parë nga mijëra vetë në rrjetet sociale, pavarësisht dhimbjes, përcjell mesazhe që na bëjnë të ulim kokën poshtë dhe të mendojmë se sa të varfër jemi ndonjëherë. Sa zemërngushtë tregohemi dhe se, megjithëse rreth nesh ka plot gjëra të bukura për të prekur e shijuar, ne shohim larg me ligësi e smirë.

Por videoja e Ambra Medës na tregon se sado të pasur a të varfër të jemi, sado me pushtet të jesh apo sado të vuash në kërkim të punës e mbijetesës, brenda vetes duhet të gjejmë energjinë e mirë dhe dashurinë për jetën.

Ambra Meda na tregon se sa zemër të madhe ka. Sa e përkushtuar është për ta luftuar sëmundjen dhe se asgjë nuk vlen para jetës.

Ambra në video tregohet guximtare, realiste, ëndërrimtare, njerëzore. Ajo me zërin dhe veprimet e saj na tregon se nuk kemi asgjë për të humbur, veçse të luftojmë për jetën dhe dashurinë!

Mesazhi i saj është prekës, por është një mesazh që na bën jo vetëm të bashkohemi e të lutemi për të dhe për qindra e mijëra të tjerë që kanë nevojë, por edhe se sa ne duhet ta duam njëri-tjetrin! Sado të mos na pëlqejë ai!

Ambra na ndihmon të zbulojmë dashurinë brenda vetes, për t'u bërë më të mirë e më të dashur. Jo vetëm të duam brenda familjes, por edhe shoqërisht!

Ambra në spitalin e Mynihut është e rrethuar nga dashuria që i përcjellin kampionët e botës. Dhe këtë dashuri ajo na e përcjell të gjithëve: "Mbështeteni njëri-tjetrin, duajeni njëri-tjetrin! Jeta është e vështië, por është dhe shumë e bukur"!

Forca Ambra! Të presim fitimtare!

B.Karoshi

cyan magenta yellow black